

**LEGJISLACIONI SHQIPTAR NËN VËSHTRIMIN E  
RREGULLORES NR.1215/2012 “MBI JURIDIKSIONIN,  
NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE NË  
FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE”, ÇËSHTJE TË  
JURIDIKSIONIT.**

Andja Levanaku

Dorëzuar  
Universitetit European të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
Shkenca juridike, me profil e drejtë publike, për marrjen e gradës  
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: PhD. Agron Lamaj

Numri i fjalëve: 51,045

Tiranë, Qershor 2017

## **DEKLARATA E AUTOREËSISË**

Unë deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky punim është krijimtari e imja, origjinale dhe publikohet për herë të parë i plotë si punim doktoral. Punimi nuk përmban materiale të shkruara nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referencave të vendosura.

© **Andja Levanaku**

## **Abstrakti**

Në qëndër të këtij punimi është Rregullorja nr.1215/2012 “Mbi Juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” pasi konsiderohet si një gur themeli në legjislacionin e Bashkimit European, në fushën e juridiksionit dhe njohjes së vendimeve të huaja. I ashtuquajtur “Regjimi i Brukselit” ka provuar vlerat e jashtëzakonshme që ka për 50 vite që ka rregulluar çështjet e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në fushën civile dhe tregtare në Europë. Rregullorja 1bis e Brukselit nr.1215/2012, e cila ka hyrë në fuqi më 10 Janar 2015, është një nga aktet më të rëndësishme dhe më të fundit të Bashkimit European në këtë fushë. Duke marrë në kondiseratë zhvillimet që ka sot ekonomia Shqiptare, në drejtim të ekonomisë europiane dhe asaj botërore, investimet e huaja, kontratat me subjektet e huaja, nevojën për lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore, aksesin në drejtësi, është e një rëndësie vendimtare analiza dhe krahasimi i akteve europiane dhe ballafaqimin me kuadrin ligjor shqiptar, në fushën civile dhe tregtare. Ky punim finalizohet me rekomandimet dhe sugjerimet përkatëse për harmonizimin e legjislacionit dhe krijimin e një kuadri ligjor bashkëkohorë nën dritën e kushteve aktuale. Në këtë kuadër Rregullorja nr.1215/2012 promovon sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e vendimeve duke vendosur rregulla uniforme dhe plotësohet nga një numër i konsiderueshëm çështjesh. Vlerësohet si një instrument shumë i rëndësishëm për të shmangur procedurat paralele dhe shërben si një referencë dhe mjet për instrumenta të tjera.

Rregullorja nr.1215/2012 ka krijuar formën dhe strukturën e duhur të bashkëpunimit juridiksional. Ajo përcakton rregulla uniforme që zgjidhin konflikte juridiksionale,

përmirëson lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore dhe përcakton instrumentat autentik në Bashkimin European dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi jo vetëm të shtetasve european, por duke filluar nga 2015 shtrihet dhe mbi shtetasit jo rezidentë në hapësirën europiane. Ky disertacion përfshin jurisprudencën e pasur të Gjykatës Europiane të Drejtësisë në një vështrim krahasues, përmbledh në të analizën e disa prej profesorëve dhe autorëve më të njohur të Shqipërisë dhe Europës, krahason rregulloret e Brukselit që nga viti 1968 deri te rregullorja më e re në këtë fushë, Rregullorja 1bis e Brukselit që ka hyrë në fuqi në Janar 2015, duke bërë një analizë krahasimore me legjislacionin shqiptar, duke sugjeruar përmirësime dhe harmonizmin e legjislacionit shqiptar me atë European në këtë fushë, duke shpresuar në ofrimin e një guidë të vlefshme për studentët, juristët, dhe akademikët, si një mjet pune në këtë fushë të ligjit.

Fjalë kyçe: rregullorja nr.1215/2012, juridiksion, marrëveshja e juridiksionit, ekzekutim i vendimeve, derogimi i juridiksionit etj.

## **Abstract**

The core subject of this thesis is the regulation no.1215/2012 “On jurisdiction, recognition, and enforcement of judgments in civil and commercial matters”, because it is considered to be a significant base in E.U legislation, in the field of jurisdiction dhe recognition of foreign decisions. The so-called “Brussels Regime” has proved it extraordinary values for 50 years in arranging jurisdiction issues, and the recognition and enforcement of decisions in civil and commercial matters in Europe. Brussels Regulation no.1215/2012 which entered into force in 10 January 2015, is one of the most important juridical acts of European Union in this area of law. Considering the latest economy developments in Albanian towards European and world economy, foreign investments, contracts with foreign subjects, the need to facilitate the circulation of judicial decisions, and to facilitate access to justice, is very important to analyse and compare european acts with albanian legislation in civil and commercial matters. This work is finalized with relevant recommendations and suggestions for the harmonization of albanian legislation.

Brussels regulation promotes the juridical security and the predictability of decisions by establishing uniform rules and complemented by a number of case studies. It is estimated as a very important instrument to avoid parallel proceedings and serves as a reference and a tool for other instruments. The Brussels regulation no.1215/2012 has created the form and structure of judicial cooperation. Defines uniform rules to resolve jurisdictional conflicts, facilitate the circulation of judicial decisions, access to justice not only for european citizens but also for non resident in E.U.

This dissertation include the jurisprudence of the European Court of Justice in a comparative view, the analysis of albanian and european academics, lawyers, judges. It compares Brussels Convention of 1968 with other regulations and albanian legislations, suggesting the harmonization of albanian legislation with european legislation in this field of law, hoping to provide a valuable guide for students, lawyers, and academics, as a working tool in this field of law.

Keywords: regulation no.1215/2012, jurisdiction, jurisdiction agreement, enforcement of decisions, derogation of jurisdiction, etc.

## **DEDIKIM**

*Ky punim i dedikohet familjes time, në veçanti birit tim Leandit, burim  
frymëzimi dhe dashurie të pashtershme.*

## **Falenderime**

Falenderime të përzemërta për familjen time për mbështetjen e gjithanshme gjatë punës për përfundimin e studimeve doktorale.

Falenderime të veçanta për të gjithë stafin e shkëlqyer të profesorëve të shkollës doktorale në UET, profesor Henri Çilin, udhëheqësin doktoral PhD. Agron Lamaj, Prof.Asoc.Dr. Erjona Canaj, që më ndihmuan në realizimin e kësaj teme dhe në formimin tim akademik gjatë tre viteve të studimeve doktorale.

***Mirënjohje***



## **PËRMBAJTJA**

|                                                                                                                                                                                                                |           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>KAPITULLI I – HYRJE .....</b>                                                                                                                                                                               | <b>1</b>  |
| 1.1 Qëllimi i punimit .....                                                                                                                                                                                    | 2         |
| 1.2 Pyetjet kërkimore .....                                                                                                                                                                                    | 4         |
| 1.3 Hipoteza.....                                                                                                                                                                                              | 4         |
| 1.4 Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor .....                                                                                                                                                         | 6         |
| 1.5 Rëndësia e studimit .....                                                                                                                                                                                  | 9         |
| 1.6 Struktura e punimit .....                                                                                                                                                                                  | 9         |
| <br><b>KAPTITULLI II-DEBATI BASHKËKOHORË NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË<br/>MARRËDHËNIEVE JURIDIKE PËR JURIDIKSIONIN, NJOHJEN DHE<br/>EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE DHE<br/>TREGTARE.....</b> | <b>13</b> |
| 2.1 Marrëveshja e Juridiksionit .....                                                                                                                                                                          | 13        |
| 2.1.2 Kriteret e vlefshmërisë së Marrëveshjes së Juridiksionit. ....                                                                                                                                           | 19        |
| 2.1.3 Pasojat e shkeljes së Marrëveshjes së Juriksionit.....                                                                                                                                                   | 22        |
| 2.2 Risitë që solli Rregullorja 1bis e Brukselit.....                                                                                                                                                          | 24        |
| 2.2.1 Shkaqet e miratimit të një Rregulloreje te re për rregullimin e marrëdhënieve juridike<br>në fushën civile dhe tregtare.....                                                                             | 24        |

|                                                                                                                            |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 2.3 Risitë në fushën e zbatimit të Rregullores 1 bis të Brukselit.....                                                     | 27 |
| 2.3.1 Heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve, si një risi e Rregullores 1bis të Brukselit. ....                    | 28 |
| 2.3.2 Arsyet ligjore të refuzimit të ekzekutimit të vendimit .....                                                         | 33 |
| 2.3.3 Zgjerimi i rregullave të juridiksionit edhe për personat që nuk banojnë në vendet anëtare të Bashkimit European..... | 35 |
| 2.3.4 Arbitrazhi, përjashtimisht brenda qëllimit të Rregullores. ....                                                      | 38 |
| 2.3.5 Masat e përkohshme si risi e rregullores .....                                                                       | 42 |

|                                                                                                                                                                                         |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>KAPITULLI III- ZHVILLIMET HISTORIKE TË RREGULLIMIT TË MARRËDHËNIEVE JURIDIKE PËR JURIDIKSIONIN, NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE.....</b> | <b>45</b> |
| 3.1 Kuadri ligjor europian që rregullon marrëdhëniet juridike për juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare. ....                      | 45        |
| 3.1.1 Konventa e Brukselit .....                                                                                                                                                        | 47        |
| 3.1.2 Konventa e Luganos .....                                                                                                                                                          | 50        |
| 3.2 Rregullorja e Këshillit Europian nr.44/2001 mbi “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.” .....                                           | 51        |
| 3.2.1 Fusha e zbatimit të Rregullores nr. 44\2001 të Brukselit. ....                                                                                                                    | 53        |
| 3.2.2 Llojet e juridiksionit sipas rregullores 44\2001. Juridiksioni dytësorë. ....                                                                                                     | 56        |

|                                                                                                                                                                                                                      |           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 3.2.3 Juridiksioni i veçantë dhe zbatimi i tij për kontratat e konsumatorit, të sigurimeve dhe të punës sipas rregullores 44\2001 .....                                                                              | 58        |
| 3.2.4 Juridiksioni i veçantë dhe zbatimi i tij në kontratat e punës.....                                                                                                                                             | 60        |
| 3.2.5 Juridiksioni ekskluziv sipas Rregullores 44\2001 .....                                                                                                                                                         | 61        |
| 3.2.6 Pranimi dhe mohimi i juridiksionit sipas Rregullores 44/2001.....                                                                                                                                              | 63        |
| 3.3 Rregullorja e Këshillit Europian nr. 1215/2012, mbi “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e njohur si Rregullorja 1 bis e Brukselit. ....                          | 66        |
| 3.3.1 Veçoritë e Rregullores 1bis të Brukselit, si burim i së drejtës në Bashkimin Europian .....                                                                                                                    | 69        |
| 3.3.2 Juridiksioni i përgjithshëm në vendet e Bashkimit Europian sipas Rregullores së Këshillit Europian nr. 1215/2012, “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”. .... | 73        |
| 3.3.3 Juridiksioni i veçantë sipas Konventës 1bis të Brukselit. ....                                                                                                                                                 | 77        |
| 3.3.4 Juridiksioni ekskluziv sipas Rregullores 1bis të Brukselit .....                                                                                                                                               | 79        |
| <b>KAPITULLI IV JURIDIKSIONI GJYQËSOR NË SHQIPËRI.....</b>                                                                                                                                                           | <b>81</b> |
| 4.1 Nxerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, shkelje e të drejtës për akses në gjykatë dhe e procesit të rregullt ligjor. ....                                                                              | 81        |
| 4.1.2 Karakteristikat kryesore të juridiksionit gjyqësor në Shqipëri. ....                                                                                                                                           | 88        |
| 4.2 Konfliktet e juridiksionit në lidhje me procesin civil ndërkombëtar.....                                                                                                                                         | 89        |
| 4.2.1 Normat që përcaktojnë kompetencën në të drejtën ndërkombëtare private .....                                                                                                                                    | 93        |

|                                                                                                                                                                                                   |            |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 4.3 Juridiksioni ndërkombëtar i gjykatave shqiptare.....                                                                                                                                          | 99         |
| 4.3.1 Juridiksioni ekskluziv i gjykatave shqiptare në çështje me element të huaj. ....                                                                                                            | 106        |
| 4.3.2 Imuniteti ndaj juridiksionit gjyqësor shqiptar. ....                                                                                                                                        | 109        |
| 4.4 Marrëveshja e juridiksionit sipas legjislacionit shqiptar nën vështtrimin e rregullores 1 bis të Brukselit.....                                                                               | 114        |
| 4.5 Parimi i autonomisë së vullnetit në këndvështrim krahasues me rregulloren 1 bis të Brukselit nr. 1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve civile dhe tregtare” ..... | 122        |
| 4.5.1 Karakteri i rendit publik si kufizim ndaj autonomisë së vullnetit. ....                                                                                                                     | 127        |
| 4.5.2 Dallimet e rendit publik nga institutet e tjera. ....                                                                                                                                       | 132        |
| 4.6 Kërkesat për masat e sigurimit të padisë dhe ngjashmëritë me legjislacionin shqiptar. ....                                                                                                    | 135        |
| 4.7 Bashkëveprimi mes Rregullores dhe juridiksionit të arbitrazhit. Vështtrim krahasues me legjislacionin shqiptar.....                                                                           | 138        |
| 4.7.1 Marrja e masave të sigurimit të padisë në rastet kur themeli i çështjes i përket juridiksionit të arbitrazhit. ....                                                                         | 143        |
| 4.8. Njohja e vendimeve të gjykatave të shteteve të huaja.....                                                                                                                                    | 144        |
| 4.8.1 Llojet e njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore. ....                                                                                                                                      | 154        |
| 4.8.2 Efektet e vendimeve gjyqësore të huaja të cilat nuk kanë marrë“exequaturin.....                                                                                                             | 160        |
| <b>KAPITULLI V KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME .....</b>                                                                                                                                              | <b>163</b> |
| 5.1 Konkluzione .....                                                                                                                                                                             | 163        |

|                      |     |
|----------------------|-----|
| 5.2 Rekomandime..... | 167 |
|----------------------|-----|

|                           |            |
|---------------------------|------------|
| <b>BIBLIOGRAFIA .....</b> | <b>171</b> |
|---------------------------|------------|

## KAPITULLI I – HYRJE

Rregullorja nr.1215/2012 është në qendër të këtij punimi, pasi konsiderohet si një nga pjesët e legjislacionit me të suksesshme të Bashkimit Europian, sepse përcaktoi bazat për një hapësirë Europiane ligjore në çështjet e juridiksionit dhe njohjes së vendimeve. Kjo rregullore solli risi në çështje të tilla si njohja e marrëveshjes së juridiksionit, heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimit të gjykatave, aplikimi dhe ndaj subjekteve që nuk janë shtetas të Bashkimit Europian etj. Për vetë zhvillimet që ka sot ekonomia Shqiptare, në drejtim të ekonomisë europiane dhe asaj botërore, për nevojën e rritjes së investimeve të huaja, është e një rëndësie vendimtare analiza dhe krahasimi i akteve europiane dhe ballafaqimin me kuadrin ligjor shqiptar.

Republika e Shqipërisë nëpërmjet Ligjit Nr.9590, datë 27.07.2006, ka ratifikuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare. Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 6 dhe 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Për këtë arsye, trajtimi i akteve ligjore më të fundit europiane në lidhje me juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, krahasimi i tyre me legjislacionin shqiptar dhe rekomandimet përkatëse për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian, si shtet që tashmë ka marrë statusin e vendit kandidat në B.E, paraqet interes të veçantë jo vetëm në aspektin shkencor dhe doktrinar, por edhe atë praktik. Kjo për njohje dhe zbatim më të mirë të Rregullores1bis të Brukselit, nga studentët, juristët, avokatët të cilët do të përballen në një të ardhme të afërt me to.

Rregullorja 1 bis e Brukselit konsiderohet si guri i themelit në ligjin European të procedurës ndërkombëtare civile. Kjo mund të konstatohet lehtësisht nga çdo praktikues i së drejtës që përballet në punën e tij me çështje civile dhe tregtare ndërkufitare në Europë. I ashtuquajturi “Regjimi i Brukselit” ka provuar vlerat e jashtëzakonshme për 50 vite në rregullimin e çështjeve të juridiksonit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në fushën civile dhe tregtare në Europë. Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe gjykatat anëtare të Bashkimit European kanë dhënë shumë vendime në këtë aspekt, duke interpretuar Konventën e Brukselit dhe Rregulloren 1 bis të Brukselit. Vlerësohet si një instrument shumë i rëndësishëm për të shmangur procedurat paralele dhe shërben si një referencë dhe mjet për instrumenta të tjerë, ka për qëllim lehtësimin e vendimeve gjyqësore dhe aksesin në drejtësi duke sjellë risi pasi aplikohet tashmë edhe ndaj shtetasve jo rezidentë në Bashkimin European.

### **1.1 Qëllimi i punimit**

Qëllimi i këtij punimi është analiza e detajuar e legjislacionit shqiptar dhe krahasimi me Rregulloren nr.1215/2012 të Brukselit “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”. Po ashtu qëllimi i këtij punimi është të përshkruaj dhe të analizoj konceptet themelore që përmban Rregullorja e Brukselit përsa i përket përcaktimit të juridiksionit gjyqësor, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave, ndryshimet e ngjashmëritë, të shpjegojë arsyet, shkaqet e këtyre ndryshimeve dhe ngjashmërive, të parashikojë trendin e ndryshimeve në të ardhmen, drejtimin që po merr legjislacioni, të rekomandojë ndryshime të legjislacionit shqiptar për tu harmonizuar me legjislacionin european në çështjet e juridiksionit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të huaja.

Analiza e detajuar e Rregullores 1 bis të Brukselit, si qëllim i këtij punimi, ka rëndësi primare në këtë drejtim duke marrë parasysh kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik, të nevojës për sigurinë e tregtisë dhe të investimeve të huaja e bëjnë të domosdoshme konsolidimin e organeve vendimarrëse, konsolidimin e një kuadri ligjor bashkëkohorë, drejt krijimit dhe organizmit të një juridiksioni gjyqësor më fleksibël drejt të drejtës europiane, për një respektim dhe liri vullneti nga ana e subjekteve si palë në një marrëdhënie juridike private.

Në këtë kuadër, Rregullorja e Brukselit nr.1215/2012 promovon sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e vendimeve duke vendosur rregulla uniforme dhe plotësohet nga një numër i konsiderueshëm çështjesh. Vlerësohet si një instrument shumë i rëndësishëm për të shmangur procedurat paralele dhe shërben si një referencë dhe mjet për instrumenta të tjerë ligjor. Rregullorja në fjalë përcakton rregulla uniforme që zgjidhin konflikte juridiksionale qofshin ato konflikte juridiksionale pozitive apo konflikt juridiksional negative, për lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore, përcaktimin e instrumentave autentik në Bashkimin European dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi jo vetëm të shtetasve european, por duke filluar nga 2015 shtrihet dhe mbi shtetasit jo rezidentë në hapësirën europiane.

Ky studim përfshin gjithashtu edhe jurisprudencën e pasur të Gjykatës Europiane të Drejtësisë në një vështrim krahasues, përmbledh në të analizën më të fundit të disa prej profesorëve dhe autorëve më të njohur të Shqipërisë dhe Europës, krahason rregulloret e Brukselit që nga viti 1968 deri te rregullorja më e re në këtë fushë, përfshin debatin bashkëkohor në fushën e rregullimit të marrëdhënieve juridike për juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare. Sugjerimi i



përmirësimeve dhe harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë Europian në këtë fushë, duke shpresuar në ofrimin e një guide modeste, të vlefshme për studentët, juristët, dhe akademikët, si një mjet pune në këtë fushë të ligjit.

## **1.2 Pyetjet kërkimore**

Pyetjet kryesore kërkimore që shtrohen në këtë punim doktoral janë:

1. Çfarë parashikon rregullorja nr.1215/2012 e Brukselit në fushën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve?
2. Çfarë parashikon rregullorja nr.1215/2012 e Brukselit për çështjet e juridiksionit?
3. Cilat janë ndryshimet që duhet të pësojë legjislacioni shqiptar për përafrimin e tij me rregulloren nr.1215/2012 të Brukselit në çështjet e juridiksionit?
4. Si duhet të ndryshojnë rregullimet e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë për përafrimin me rregulloren nr.1215/2012 të Brukselit në lidhje me çështjet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të huaja?
5. Si mund të ndryshojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë për lejimin e marrëveshjes së juridiksionit?

## **1.3 Hipoteza**

Në këtë punim doktoral kam ngritur një hipotezë qendrore dhe disa nën hipoteza.

Hipoteza qendrore:

Legjislacioni shqiptar duhet të ndryshojë në lidhje me çështjet e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare, për të arritur një përafrim më të mirë me legjislacionin europian në këtë fushë.

#### Hipoteza I

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë për tu harmonizuar me rregulloren e Brukselit nr.1215/2012 duhet të njohë marrëveshjet e juridiksionit të lidhur mes shtetasve shqiptarë për derogimin e juridiksionit, përveç atyre çështjeve që përfshihen në juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare.

#### Hipoteza II

Në mënyrë që të harmonizohet me legjislacionin europian, veçanërisht me Rregulloren nr.1215/2012 të Brukselit, duhet të ndryshohet Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë për çështje të tilla si juridiksioni ekskluziv, derogimi i juridiksionit dhe pezullimit të gjykimit, me qëllim lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore civile, aksesit në drejtësi, e për tu përshtatur më mirë me kushtet aktuale të tregut e qarkullimin civil.

#### Hipoteza III

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë duhet të heqi procedurën e ekzekutimit për vendimet e gjykatave të huaja dhe të ndiqet e njëjta praktikë ligjore që parashikohet në rregulloren 1215/2012, duke shkrirë procedurën “exequator” për vendimet e dhëna nga gjykatat europiane. Si bazë ligjore të përdoret neni 393 i K.Pr.C – së ku parashikohet mundësia që me marrëveshje ndërkombëtare mes Republikës së

Shqipërisë dhe shteteve të huaja mund të përcaktohet kushte të tjera për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave.

#### **1.4 Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor**

Disertacioni bazohet në disa metoda shkencore të kombinuara me njëra - tjetrën, metodën cilësore, analiza ligjore, sinteza, krahasimi, intervista cilësore, rishikimi i literaturës etj. Bazat e analizës së këtij disertacioni synon të identifikojë trendin dhe shqetësimet që kanë sjellë zhvillimet e reja në sistemet e ndryshme të së drejtës. Hyrja në fuqi e një normative të re Europiane, Rregullorja 1bis e Brukselit, që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën civile dhe tregtare sjell njëkohësisht një sërë lehtësirash, por edhe probleme të ndryshme ligjore, të cilat në praktikë nuk kanë munguar të shfaqen dhe që me gjithë përmirësimet dhe përditësimet e legjislacionit vazhdojnë të shfaqen problematika dhe dyshime për rregullimet specifike që kjo normativë parashikon dhe bën detyrues të aplikueshme për vendet që i përkasin jo vetëm hapësirës europiane, por tashmë dhe shtetasve që janë rezidentë në shtete të treta.

Kërkimi doktrinar përbën një element të rëndësishëm në realizimin e këtij punimi, nëpërmjet të cilit është arritur identifikimi, mbledhja, sistemimi i librave me autorë studiues të së drejtës, profesorë të shquar shqiptarë dhe të huaj, komentar, artikuj në revista shkencore, kumtesa mbajtura në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu si edhe një mori e madhe kauzash gjyqësore nga praktika shqiptare, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

#### ***Metoda e rishikimit të literaturës***

Me anë të kësaj metode do të njihemi me literaturën bashkëkohore të autorëve të huaj dhe shqiptar të së drejtës, të cilët kanë trajtuar çështje të juridiksionit, marrëveshjes së juridiksionit, trajtimet më bashkëkohore në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja si dhe problematikat praktike që lidhen me këto koncepte juridike.

### ***Metoda e analizës ligjore dhe krahasimit***

Procesi i krahasimit ka si objekt studimin e juridiksionit gjyqësor, njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare, sipas legjislacionit europian në krahasim me atë shqiptar. Krahasimi i dy juridiksioneve me njëri tjetrin bëhet me qëllim përcaktimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve, interpretimi i shkaqeve të ngjashmërive dhe ndryshimeve, vlerësimi i zgjidhjeve të dhëna prej tyre, dhe dalja në konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e legjislacionit.

Hapi i parë është analiza e kuadrit ligjor, objekti copëzohet në pjesët e tij përbërëse, analiza e pjesëve përbërëse të objektit, juridiksionit, përcaktimi i ndryshimeve dhe ngjashmërive në sisteme të ndryshme të së drejtës, si dhe ndryshimet dhe ngjashmëritë brenda të njëjtit sistem të së drejtës. Objekti që krahasohet riintegrohet në mjedisin shqiptar, që është kuadri ligjor dhe mjedisi ekonomik – social shqiptar, duke u vendosur në kontekst me normat e tjera të së drejtës, institucione të tjera me të cilat bashkëvepron e bashkëjeton.

Koncepti i juridiksionit, si një koncept thelbësor i së drejtës studiohet në kuadrin ligjor europian, duke bërë një analizë e krahasim të plotë të akteve europiane themelore që kanë rregulluar juridiksionin e gjykatave që nga viti 1968 e deri zhvillimet e fundit të së drejtës europiane, rregullimi i juridiksionit nga Konventa 1bis e Brukselit e vitit 2012,

që ka hyrë në fuqi në Janar 2015. Njëkohësisht, baza e krahasimit nuk është vetëm ky koncept në Europë, por krahasohet me kuadrin ligjor shqiptar, ku paraqet shumë ndryshime, me qëllim përmirësimin e legjislacionit, për t'iu përshtatur zhvillimit ekonomik e social të kohës që jetojmë, si dhe krahasimi i këtij koncepti brenda vet legjislacionit shqiptar, duke parë dhe përjashtimet nga juridiksioni, apo veprimin e tij ndaj shtetasve të huaj apo personave pa shtetësi.

Ky koncept themelor analizohet dhe krahasohet duke u bazuar në balancën karteziane, analizë e detajuar në kohë dhe në hapësirë, duke studiuar parimet e përgjithshme dhe rast pas rasti, duke shqyrtuar dhe rastet studimore që lidhen me të. Hapi i dytë, shpjegimi i lidhjes shkakësore, ka të bëjë me sigurimin e shpjegimeve mbi ngjashmëritë dhe ndryshimet që na jep analiza krahasuese dhe normative, sipas legjislacionit europian, sipas legjislacionit shqiptar. Analizohen faktorët që kanë ndikuar në pasqyrimin e këtyre ndryshimeve, ka një varg të tillë si shkaqe që lidhen me interpretimin e ligjit, shkaqe historike, sociale, ekonomike, politike, gjeo – politike, standartet ndërkombëtare etj.

Analizohen cilat janë ekzaktësisht ngjashmëritë dhe ndryshimet, si pasqyrim i situatës faktike, si dhe konvergjencat dhe divergjencat, si pasqyrim i drejtimit të caktuar që po merr zhvillimi i ligjit. Hapi i tretë ka të bëjë me vlerësimin e zgjidhjeve ligjore. Kjo është pjesa më esenciale e procesit kërkimor, duke dhënë një gjykim vlerësues, për të vlerësuar çdo rend juridik në shkallë të ndryshme, me qëllim harmonizimin e legjislacionit.

## 1.5 Rëndësia e studimit

Ky punim doktoral ka karakter ndërdisiplinor. Në të ndërthuren fusha të ndryshme të së drejtës, ndërthuret e drejta publike me të drejtën civile, e drejta ndërkombëtare private, e drejta procedurale civile, e drejta ndërkombëtare procedurale civile, e drejta europiane etj. Përbën risi trajtimi i rregullores 1bis të Brukselit, nr. 1215/2012 që ka hyrë në fuqi më 10 Janar 2015, duke qënë se është ndër të paktat punime shqiptare që bënë një analizë të thellë të kësaj rregulloreje, që konsiderohet si gurë themeli në hapësirën ligjore europiane në fushën e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, duke e krahasuar me legjislacionin shqiptar. Për vetë zhvillimet që ka sot ekonomia Shqiptare, në drejtim të ekonomisë europiane dhe asaj botërore, është e një rëndësie vendimtare analiza dhe krahasimi i akteve europiane dhe ballafaqimin me kuadrin ligjor shqiptar. Për këtë arsye, trajtimi i parashikimeve më të fundit europiane në lidhje me juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, krahasimi i tyre me legjislacionin shqiptar, dhe rekomandimet përkatëse për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë europian, si shtet që tashmë ka marrë statusin e vendit kandidat në B.E, paraqet interes të veçantë jo vetëm në aspektin shkencor dhe doktrinar, por edhe praktik, për njohje dhe zbatim më të mirë të Rregullores nr.1215/2012 të Brukselit, nga studentët, juristët, avokatët të cilët do të përballen në një të ardhme të afërt me to. Konventa 1bis e Brukselit sjell shumë risi në aspektin juridik, civil procedural, që mendoj se duhet të pasqyrohen me ndryshimet respektive në legjislacionin shqiptar.

## 1.6 Struktura e punimit

Ky disertacion është i strukturuar në 5 kapituj.

**Kapitulli i parë** trajton në mënyrë të përgjithshme qëllimin e punimit, pyetjet kërkimore, hipotezat kryesore të punimit, trajtohet metodologjia e përdorur dhe rëndësia e punimit. Pjesë e këtij kapitulli janë dhe përmbledhja dhe struktura e punimit.

**Kapitulli i dytë**, trajton debatin bashkëkohor në fushën e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në vendet e Bashkimit European. Miratimi i rregullores 1215/2012 të Brukselit solli një sërë risish në fushën e juridiksionit, në zgjerimin e rrethit të subjekteve ndaj të cilëve aplikohet rregullorja, duke përfshirë këtu dhe personat fizik apo juridik që nuk janë rezident në B.E. Reforma e “Hegjes së procedurës së ekzekutimit” është risia më e vlerësuar e Rregullores 1bis të Brukselit, e cila shkurtoi kostot dhe bën të mundur që një vendim gjyqësor të jetë direkt i zbatueshëm në secilin vend të B.E pa asnjë procedurë shtesë.

**Kapitulli i tretë**, trajton zhvillimet historike në fushën e rregullimit të marrëdhënieve juridike në çështjet e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, duke filluar nga Konventa e parë e Brukselit e vitit 1968, Konventa e Luganos dhe rregulloret e Këshillit European nr.44/2001 dhe e fundit që disiplinon marrëdhëniet në këtë fushë Rregullorja nr.1215/2012 e cila ka hyrë në fuqi në janar 2015. Ky kapitull trajton me detaje llojet e juridiksionit të parashikuar në këto dokumenta ligjore, juridiksionin e veçantë, juridiksionin dytësor, juridiksionin ekskluziv,etj. Trajton në një vështrim krahasues konventat dhe rregulloret në këtë fushë të së dretjës.

**Kapitulli i katërt**, bën një analizë të detajuar të legjislacionit shqiptar dhe e krahason atë me Rregulloren 1 bis të Brukselit për çështje të tilla si juridiksioni, derogimi i juridiksionit me marrëveshjen e palëve. Trajton aspekte të juridiksionit ekskluziv të gjykatave shqiptare, juridiksionin ndërkombëtar dhe imunitetin ndaj këtij juridiksioni.

Një çështje thelbësore e këtij kapitulli analitik është ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të huaja në Republikën e Shqipërisë me procedurën “exequatur”, e cila është procedura ligjore që përdoret në vendin tonë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja.

**Kapitulli i pestë** parashtron konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me këtë disertacion. Rregullorja 1bis e Brukselit solli një sërë risish të cilat mund të përmbliken në: Përmirësimin e efektivitetit të marrëveshjes së zgjedhjes së gjykatës apo e quajtur ndryshe Marrëveshjes së juridiksionit duke i dhënë përparësi marrëveshjes së palëve për zgjedhjen e gjykatës që ka juridiksion, në raport me gjykatën ku është filluar së pari çështja. Heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shtetet anëtare, procedura “exequatur”, solli lehtësimin e qarkullimit të vendimeve mes shteteve anëtare duke ulur kostot dhe shkurtuar kohën që kërkonte një vendim për të hyrë në fuqi. Zgjerimi i rregullave të juridiksionit edhe për personat që nuk banojnë në vendet anëtare të Bashkimit Europian, parashikimi i rregullave të detajuara kur ndodhemi para rasteve të përjashtimit të arbitrazhit. Pavarësisht përjashtimit që i bën rregullorja juridiksionit të arbitrazhit, duke u fokusuar vetëm në juridiksionin gjyqësor, në raste specifike gjykatat kanë bërë interpretim të zgjeruar duke shërbyer si bazë për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatës së arbitrazhit. Në mënyrë që të harmonizohet me legjislacionin europian, veçanërisht me Rregulloren nr.1215/2012 të Brukselit, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë duhet të ndryshojë rregullimet për çështje të tilla si juridiksioni ekskluziv, derogimi i juridiksionit dhe pezullimit të gjyqësorit, me qëllim lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore civile, aksesit në drejtësi, e për tu përshtatur më mirë me kushtet aktuale të tregut e qarkullimit civil.



**Bibliografia.** Bibliografia e përdorur në këtë punim bazohet në burime parësore, legjislacioni shqiptar dhe ai i Bashkimit Europian, burime dytësore, ku përfshihen libra dhe shkrime nga profesorë të shquar të së drejtës shqiptare dhe të huaj, në jurisprudencën shqiptare dhe të gjykatave të huaja. Në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë për çështjet e juridiksionit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të huaja dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, ky punim bazohet dhe në vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë si dhe në vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në artikuj dhe konferenca shkencore të mbajtura brenda dhe jashtë vendit, raporte të Bashkimit Europian mbi aplikimin e rregullores nr.1215/2012 etj.

## **Kapitulli II**

### **Debati bashkëkohor në fushën e rregullimit të marrëdhënieve juridike për juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare.**

#### **2.1 Marrëveshja e Juridiksionit**

Marrëveshja e Juridiksionit është marrëveshja e lidhur mes palëve për përzgjedhjen e juridiksionit të gjykatës së shtetit që do të zgjidhi çështjen për mosmarrëveshje që kanë lindur apo do të lindin në të ardhmen.

Kjo marrëveshje parashikohej së pari nga Rregullorja nr.44-2001 e Brukselit në nenin 23, si një mundësi që i njihej palëve që me vullnetin e tyre të lirë të vendosnin gjykatën që do të zgjidhte mosmarrëveshjen.<sup>1</sup>

Përcaktimi i juridiksionit mund të bëhet si një klauzolë e kontratës mes palëve ose si një kontratë më vete. Mund të lidhet para lindjes së mosmarrëveshjes ose pas lindjes së mosmarrëveshjes mes palëve. Zakonisht, dhënia e aprovimt për përcaktimin e juridiksionit të gjykatës varet nga cilësia e palëve, nëse kishin marrëdhënie biznesi, ishin konsumatorë apo marrëdhënie punësimi etj. Këto janë dhe sot marrëdhëniet kryesore që rregullohen nga kontratat. Pranimi mund të jepet me heshtje pranuese për zgjedhjen e gjykatës, ose mund të jetë në formën e një klauzole të parashikuar në kontratë, ose nëpërmjet një marrëveshjeje mes palëve që janë tashmë në një marrëdhënie kontraktore. (Mandro, Walker, Kadia, 2005:113)

---

<sup>1</sup> Rregullorja nr. 44/2001 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”

Mënyra se si bëhej përzgjedhja e gjykatës nuk ishte në liri absolute, por definohej nga vet rregullorja dhe bëhej për të mbrojtur palën më të dobët. P.sh në rastet e kontratave individuale të punësimit, parashikohej një mbrojtje e veçantë për punëmarrësin. Si në rastin e kontratave të konsumatorit dhe në kontratat individuale të punësimit, punëmarrësi mund të transferojë juridiksionin me anë të një marrëveshje të lidhur me punëdhënësin, duke respektuar kushtin që mosmarrëveshja të jetë lidhur pasi të ketë lindur mosmarrëveshja mes palëve, duke lejuar kështu marrëveshjen e palëve për të transferuar çështjen në atë gjykatë që i duket më e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjen që ka lindur. Pra në këtë rast që të kemi një marrëveshje të vlefshme duhet që kjo marrëveshje mes palëve të jetë lidhur pas lindjes së konfliktit, në mënyrë që të mbrohen më mirë intereset e punëmarrësve dhe t'i jepet mundësia e parashikimit të zgjidhjes nga ana e gjykatës kompetente. Nga ana tjetër, duket sikur ky nen bënte një ndalim absolut, duke bërë të pavlefshme çdo marrëveshje që është lidhur para lindjes së konfliktit. Për ta përforcuar këtë sanksionim, është parashikuar dhe në paragrafin e dytë të nenit 21, se klauzola e juridiksionit që është përcaktuar para se mosmarrëveshja të ketë filluar është e pavlefshme. Kështu, në këtë rast, punëmarrësi lejohet të procedojë në gjykata të tjera. Rregullorja 1 e Brukselit aplikohet vetëm në mosmarrëveshje ku pala e paditur ishte resident në B.E, pa qënë e rëndësishme vendbanimi i palës paditëse.

Problematika hasej në rastet kur palët me marrëveshje kanë vendosur juridiksionin e një shteti të caktuar dhe më pas padinë e kanë ngritur si fillim në një tjetër shtet anëtarë të Bashkimit Europian, e njohur ndryshe si “Italian Torpedo”. Kjo bëhej bazuar në Rregulloren 44/2001, e cila i jepte përparësi gjykatës ku është filluar së pari çështja në krahasim me gjykatën e përzgjedhur me marrëveshjen e palëve. Në këto raste hasej një konflikt juridiksional dhe përplasje të neneve 23 dhe 27 të Rregullores së Këshillit

Europian nr. 44/2001 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” ku neni 23 i saj lejonte zgjedhjen e juridiksionit me marrëveshjen e palëve dhe lejonte që çështja të gjykohej nga gjykata e cila është zgjedhur nga vete palët në klauzolën e marrëveshjes, ndërsa neni 27 juridiksonin ia kalonte gjykatës në të cilën është depozituar më parë dhe ka filluar të gjykohej çështja. Ky mekanizëm çoi në krijimin e një klauzole juridiksionale të papërcaktuar, ku palët “vraponin” për të dërguar çështjen e tyre në gjykatën e preferuar, në mënyrë që të kishin përfitime. Ky lloj abuzimi me rregullat e juridiksionit është i njohur ndryshe si “Italian torpedo”.<sup>2</sup>

Në këtë kuadër një çështje e njohur për përcaktimin e juridiksionit të gjykatës është *Turner v. Gravit*, në të cilën palët të njëjtën çështje e kishin ngritur në dy shtete të ndryshme. Gjykata Europiane e Drejtësisë vendosi që bazuar në Rregulloren 1 të Brukselit gjykata kompetente është gjykata ku është filluar së pari çështja. GJED në këtë vendim përforcoi parimin e uniformitetit, të besimit dhe bashkëpunimit reciprok, duke konkluduar se n.q.s mjetet procedurale që ekzistojnë në bazë të ligjit kombëtar dhe që forcojnë efektin e marrëveshjes së juridiksionit, ndërhyjnë padrejtësisht në përcaktimin që bëjnë gjykatat e shteteve anëtare për juridiksionin, konsiderohen si ta papajtueshme me rregulloren. Kjo për të minimizuar rrezikun e vendimeve të kundërta për të njëjtën çështje dhe për të shmangur procedurat paralele.<sup>3</sup> Parimi i uniformitetit “krijon një sistem të mbyllur ku presumohet që çdo shtet kontraktor do të dali me një vendim të ngjashëm”.<sup>4</sup>

---

<sup>2</sup> [http://www.lexology.com/library/detail, Gómez-Acebo & Pombo Abogados - Miguel Troncoso Ferrer](http://www.lexology.com/library/detail/?article=Gómez-Acebo+&Pombo+Abogados+-+Miguel+Troncoso+Ferrer)

<sup>3</sup> Case C-159/02 (Turner) Gjykata Europiane e Drejtësisë

<sup>4</sup> Hare, Christopher, Restraint of foreign proceeding *Turner v. Grovit* (2004), Cambridge laë Journal 570.

Neni 23 i rregullores, i interpretuar nga Gjykata Europiane e Drejtësisë, përcakton kushtet që kanë të bëjnë me rregulla mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së palëve për përzgjedhjen e gjykatës kompetente, pasiguritë në lidhje me karakterin shterues të këtyre kushteve. Çështja e zgjedhjes së gjykatës është bërë burim konflikti për shkak të kolizionit të normave juridike dhe parimeve të ndryshme juridike. Marrëveshja e palëve për përzgjedhjen e gjykatës është bërë subjekt i një dualizmi juridiksional dhe dyshime mbi përcaktimin e juridiksionit referuar *lex fori* apo *lex causae*. Kjo çon në pasoja të padëshirueshme pasi një marrëveshje për përzgjedhjen e gjykatës mund të jetë e vlefshme në një shtet anëtarë dhe e pavlefshme në një tjetër shtet anëtar.

Në një çështje të ngjashme Gjykata Europiane e Drejtësisë ka dhënë një zgjidhje koherente duke përcaktuar se: gjykata e dytëku është ngritur çështja pezullon procedurat derisa gjykata e parë që po shqyrton çështjen të pranojë ose refuzojë juridiksionin, edhe në rastet kur gjykata e dytë pretendon se ka juridiksion ekskluziv, duke qënë se është zgjedhur me anë të Marrëveshjes së Juridiksionit.<sup>5</sup>

Ndjekja e procedurave paralele mund të çoj në vonesa të cilat dëmtojnë funksionimin jo vetëm të gjykatave të shteteve anëtare, por dhe mirëfunksionimin e tregut të përbashkët europian. Në disa raste një palë mund të përdori këto vonesa procedurale për të favorizuar vetveten dhe për të dëmtuar në mënyrë të padrejtë palën ndërgjyqëse, duke e përdorur marrëveshjen e juridiksionit si “hile procedurale”. Procedurat paralele krijojnë kosto shtesë dhe pasiguri. Gjithashtu, vihet re tendenca e korporatave, të cilat bëjnë transaksione të parakohshme thjesht dhe vetëm për të paracaktuar gjykatën e

---

<sup>5</sup>Case C-116/02 ( Gasser ) Gjykata Europiane e Drejtësisë

leverdisshme për zgjidhjen e konflikteve.<sup>6</sup> Jurisprudenca e GJED në interpretim të rregullores 1 të Brukselit i ka dhënë përparësi Gjykatës ku fillohej së pari çështja, duke e shmangur kështu Marrëveshjen e Juridiksionit që lidhej mes palëve, në rastet e përplasjes së nenit 23 me 27 të rregullores.

Me miratimin e Konvetës 1bis të Brukselit u parashikua një ndryshim shume i rëndësishëm përsa i përket rregullit ndërkombëtar të gjyqëvarësisë, e cila ka si qëllim rregullimin e një prej problematikave kryesore në rregulloren e kaluar, forcimin e efektivitetit të “Marrëveshjes së Juridiksionit”. Rregullorja nr.1215/2012, “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare” në neni 27 (1) të saj parashikon: *“kur procedimet që përfshijnë të njëjtin objekt dhe të njëjtat palë janë paraqitur në gjykatat e shteteve të ndryshme anëtare, çdo gjykatë, përveç gjykatës ku është filluar së pari çështja duhet të pezullojnë procesin, derisa të përcaktohet juridiksioni i gjyktaës ku është filluar së pari çështja.”* Në pamje të parë duket sikur nuk ka ndryshim me rregulloren e vjetër, pasi dhe ajo kishte një parshikim të tillë në nenin 25 të saj. Në fakt, Rregullorja 1bis e Brukselit tashmë i jep përparsi gjykatës të zgjedhur nga palët, mbi çdo gjykatë tjetër pavarësisht se ku kanë filluar së pari procedurat, në ndryshim nga rregullorja 44/2001 e cila i jepte përparësi gjykatës ku është filluar së pari çështja në krahasim me gjykatën e përzgjedhur nga vetë palët. Sipas Rregullores 44/2001 të Brukselit gjykata që do të kishte juridiksion ishte gjykata e atij shteti anëtar në të cilin palët kanë depozituar kërkesë padinë. Ky do të ishte një juridiksion ekskluziv.<sup>7</sup> Rregullorja nr.1215/2012 e ruan parimin e përgjithshëm se gjykatat e tjera duhet të pezullojnë gjykimin në favor të gjykatës ku është filluar së pari

---

<sup>6</sup> [www.deguestasia.com](http://www.deguestasia.com)

<sup>7</sup> Rregullorja e Brukselit nr. 44/2001 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” Neni 23.

çështja, neni 29 (1), megjithatë ka përfshirë një përjashtim të rëndësishëm nga rregulli i përgjithshëm. Bazuar në nenin 31 (2) të Rregullores 1215/2012, kur një gjykatë e një shteti anëtar në të cilën palët kanë transferuar juridiksionin ka filluar procedurat, çdo gjykatë tjetër duhet të pezulloj procesin dhe të vendosin në favor të gjykatës që kanë përzgjedhur palët edhe nëse nuk është ajo gjykata ku është filluar së pari çështja. Me fjalë të tjera, gjykata në të cilën palët me marrëveshje kanë transferuar juridiksionin edhe nëse nuk është gjykata e parë ku është depozituar kërkesë padia, është gjykata që ka juridiksion ekskluziv. Të gjitha gjykatat e tjera duhet të mohojnë juridiksionin e tyre dhe të vendosin në favor të juridiksionit të gjykatës së përzgjedhur nga palët. Pra, janë parashikuar ndryshime në lidhje me zbatimin e klauzolës juridiksionale. Rregullorja “Bruksel 1bis” modifikon regjimin ligjor të gjyqëvarësisë mes gjykatave të shteteve anëtare. Në ndryshim nga rregullorja 44/2001, neni 33 i rregullores 1215/2012 përfshinë litispendencën mes gjykatave të shteteve anëtare ashtu edhe gjykatave të shteteve të treta, ku përfshihen shtetet që nuk janë pjesë e Bashkimit Europian, të cilat kanë shqyrtuar çështjen më parë. Gjykata e zgjedhur nga palët do të ketë prevalencë mbi “prioritetin e bazuar në kohë”, pavarësisht vendbanimit të palëve.<sup>8</sup> Regjimi i inkorporuar nga neni 33 do të jetë i aplikueshëm kur gjykatat e shtetit anëtar kanë juridiksion bazuar në nenin 4, ku kriter është vendbanimi i të paditurit, neni 7, 8, ose 9 që bën fjalë për juridiksionin e veçantë, i cili do të trajtohet gjërësisht në kapitullin vijues. Në këtë mënyrë, ky regjim nuk aplikohet kur gjykata ka juridiksion ekskluziv për çështjen, ose kur juridiksioni i saj është i bazuar në çështjet e sigurimeve,

---

<sup>8</sup>[http://www.elderecho.com/actualidad/anteproyecto\\_de\\_Ley\\_de\\_Cooperacion\\_Juridica\\_Internacional\\_en\\_materia\\_civil\\_0\\_697125092.html](http://www.elderecho.com/actualidad/anteproyecto_de_Ley_de_Cooperacion_Juridica_Internacional_en_materia_civil_0_697125092.html)

konsumatorit ose kontratat e punësimit, apo kur gjykata ka juridiksion në bazë të një marrëveshjeje të vlefshme nga palët.

Për më tepër, Rregullorja 1bis e Brukselit prezantoi tre ndryshime themelore për rregullat që lidhen me klauzolën juridiksionale. Së pari, për të qënë efektive, një klauzolë juridiksionale nuk duhet të jetë nul apo të ketë asnjë lloj pavlefshmërie, qoftë absolute ose relative, sipas ligjit të atij shteti gjyktës të së cilës i jep juridiksion. Pra, duhet të ketë një marrëveshje të vlefshme mes palëve që të derogoj juridiksionin. Bazuar në nenin 25 të rregullores palët me marrëveshje, pavarësisht vendbanimit të tyre, kanë mundësi ligjore të lidhin një marrëveshje ku përzgjedhin një gjykatë të një shteteti anëtar të ketë juridiksion për mosmarrëveshje ligjore që kanë lindur ose do të lindin në të ardhmen, kjo gjykatë do të ketë juridiksion vetëm nëse marrëveshja nuk është nul sipas ligjeve të shtetit anëtar të përzgjedhur. Ky juridiksion do të jetë ekskluziv, pavarësisht se ku është filluar së pari çështja. Së dyti, klauzola e juridiksionit do të jetë e vlefshme pavarësisht vendbanimit të palëve në ndryshim nga rregullorjaë 44/2001, e cila shtrihej vetëm mbi subjektet që kishin vendbanimin në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Së treti, kur një gjykatë, e cila nuk është ajo e përzgjedhur nga palët, ka filluar procesin gjyqësor, duhet të pezullojë gjykimin dhe të vendosi në favor të juridiksionit të gjykatës së përzgjedhur nga palët, e cila do të përcaktoj vlefshmërinë e marrëveshjes së juridiksionit.

### **2.1.2 Kriteret e vlefshmërisë së Marrëveshjes së Juridiksionit.**

Në mënyrë që një marrëveshje që ka deroguar juridiksioni në një nga gjykatat e shteteve anëtare të jetë e vlefshme duhet që të ketë formë të shkruar, ose të provohet me shkrim ekzistenca e marrëveshjes dhe e vullnetit të palëve. Një tjetër opsion për sa i përket



formës së saj është forma që përputhet me praktikën që palët kanë vendosur mes tyre apo standartet në fushën tregtare ndërkombëtare, ose në një formë e cila është e zakonshme dhe e njohur në këtë fushë. Gjithashtu, edhe çdo komunikim tjetër në rrugë elektronike që bën regjistrimin e marrëveshjes së derogimit të juridiksionit do të jetë ekuivalente me formën e shkruar të marrëveshjes dhe si pasojë kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për sa i përket një elementi të rëndësishëm të saj, formës së marrëveshjes juridike.

Rregullorja 1 bis i jep rëndësi të veçantë marrëveshjes së juridiksionit, jo vetëm për sa i përket përparësisë që ka në raport me gjykatën ku është filluar së pari çështja, por edhe duke mos e konsideruar pjesë integrale të kontratës së palëve, por si një marrëveshje e një lloji të veçantë. Ky përfundim del nga interpretimi i nenit 25 të Rregullores, duke e konsideruar këtë marrëveshje të pavaruar nga klauzolat e tjera të kontratës. Vlefshmëria e kësaj marrëveshje nuk mund të kundërshtohet gjyqësisht vetëm me argumentin se kontrata është e pavlefshme, pasi konsiderohen të pavarura nga njëra tjetra. Kështu, Marrëveshja e Juridiksionit do të konsiderohet si një marrëveshje e ndarë nga termat e tjerë të kontratës. Vlefshmëria e Marrëveshjes që derogon juridiksionin nuk mund të kundërshtohet vetëm mbi bazën se kontrata është e pavlefshme, duke bërë kështu një diferencë mes vullnetit në marrëveshjen e zgjedhjes së juridiksionit dhe vullnetit të palëve në kontratë. (Brigs,2008:24) Kështu, terminologjia që shoqëron këtë veprim juridik është Marrëveshje dhe jo Kontratë për zgjedhjen e juridiksionit, duke u mjaftuar vetëm në përzgjedhjen e juridiksionit të një shteti anëtar.

Subjektet që mund të lidhin marrëveshjen e juridiksionit janë çdo person fizik apo juridik rezident ose jo i Bashkimit European. Në ndryshim nga Rregullorja 44/2001 e

cila sanksiononte që palë e marrëveshjes të ishin vetëm rezidentët e B.E, Rregullorja 1bis e Brukselit lejon që një marrëveshje të tillë ta lidhin dhe personat që nuk janë rezidentë në B.E. Rregullorja 1bise Brukselit “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” parashikon rregulla për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur konfliktin e juridiksionit mes shteteve anëtare. Kjo mund të ndodh sepse shtetet anëtare kanë ligjet e tyre që përcaktojnë juridiksionin e gjykatave, por edhe sepse në Bashkimin Europian bashkëjetojnë dy sisteme të së drejtës, civil laë dhe common laë. Rregulli i përgjithshëm është së çështja gjykohet nga gjykata e atij vendi që është më e përshtatshme për gjykimin e saj. Ky parim sjell refuzimin e juridiksionit nga gjykata që ka filluar së pari çështjen dhe do të sjell gjykimin nga gjykata e shtetit anëtar më të përshtatshëm. Ky është një parashikim komplet i ndryshëm nga sistemi i të drejtës civile, i cili nuk merr parasysh parimin që bazohet në rrënjët e sistemit common laë. (Mandro, Ealker, Kadia, 2005:139)

Kushti që paditësi të kishte vendbanimin ose vendqëndrimin në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian është shfuqizuar, aktualisht nga Janari i vitit 2015 këtë marrëveshje ka të drejtë ta lidhi kushdo pavarësisht vendbanimit. Kjo marrëveshje e palëve përmes të cilës zgjedhin një juridiksion të një shteti anëtarë e bën gjykatën e këtij shteti të ketë juridiksion ekskluziv. Marrëveshja mes palëve për zgjedhjen e juridiksionit do të jetë e vlefshme n.q.s nuk konsiderohet nul nga ligjet e shtetit të zgjedhur. N.q.s gjykata e përcaktuar ka juridiksion të vlefshëm, që do të thotë se marrëveshja mes palëve, në të cilën zgjidhet juridiksioni i shtetit anëtar më të përshtatshëm për zgjidhjen e konfliktit që ka lindur apo do të lindë në të ardhmen, nuk është nul sipas ligjeve të atij shteti që është përzgjedhur dhe e ka pranuar atë, gjykatat e tjera duhet ta refuzojnë juridiksionin mbi çështjen. Kjo edhe në rastet kur kërkesa është

depozituar së pari në një gjykatë tjetër të një shteti anëtar. Kjo zgjidhje bën të mundur shmangien e konflikteve juridiksionale qoftë negative apo pozitive. Rregullorja e 1bis e Brukselit i jep përparësi gjykatës së përzgjedhur nga palët, ndërsa në rastet kur nuk ka një marrëveshje të tillë apo ajo është e pavlefshme, do të ketë juridiksion ekskluziv, gjykata ku është filluar së pari çështja.

### 2.1.3 Pasojat e shkeljes së Marrëveshjes së Juridiksionit

Mund të ndodhë që njëra nga palët në shkelje të Marrëveshjes së Juridiksionit, e depoziton kërkesë padinë jo në gjykatën e përcaktuar në marrëveshje, por në një gjykatë të një shteti tjetër anëtar i B.E ose jashtë B.E. Në të tilla raste palës tjetër i lind e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit për shpenzimet që ka sjell kjo shkelje e marrëveshjes. Një shkelje e tillë duhet konsideruar si shkelje procedurale apo si shkelje substanciale e së drejtës?

Padia e shpërblimit të dëmit si pasojë e shkeljes së Marrëveshjes së zgjedhjes së gjykatës e njohur si Marrëveshja e Juridiksionit i ka rrënjët në sistemin common law. Gjykatat e sistemit common law e trajtojnë shkeljen e Marrëveshjes së Juridiksionit si një shkelje substanciale dhe pranojnë kërkesë padinë për shpërblimin e dëmit të ardhur nga një shkelje e tillë.<sup>9</sup> Një çështje shumë e njohur në këtë fushë të së drejtës është *Union Discount v. Zoller*<sup>10</sup>, në të cilën Zoller në shkelje të Marrëveshjes së Juridiksionit në të cilën kishin zgjedhur gjykatën angleze, bën kërkesë padi në gjykatën e Neë York-ut. Në këto kushte Union discount, pala e paditur, kërkon dëmshpërblim për kostot e ardhura nga shkelja e marrëveshjes së juridiksionit. Duhet thënë një kërkesë

---

<sup>9</sup> Koji Takahashi, Damages for breach of a choice-of-court agreement, Yearbook of Private international law, vol 10. (2008), 65.

padi e tillë nuk duhet nënvlerësuar duke patur parasysh që kosto e shërbimit të avokatit është e lartë.<sup>11</sup>

Gjykata angleze pranon kërkesë padinë për dëmshpërblim si pasojë e shkeljes së Marrëveshjes së Juridiksionit, në lidhje me shpenzimet gjyqësore dhe ia ngarkon këto shpenzime palës që ka shkelur marrëveshjen.<sup>12</sup>

Në një rast të ngjashëm Gjykata e Lartë Federale Gjermane konstatoi shkeljen e Marrëveshjes së Juridiksionit nga njëra palë, por pala e dëmtuar nga ky veprim nuk u rimbursua plotësisht, por vetëm në masën sa do të ishin shpenzimet nga pala e dëmtuar n.q.s do të paguante një avokat gjerman, në vend të avokatit anglez që kushtonte me tepër. Këto shpenzime ju ngarkuan palës që kishte shkelur marrëveshjen e juridiksionit.<sup>13</sup>

Në shtetet ku aplikohet Rregullorja e Brukselit, për shkelje të marrëveshjes së juridiksionit dhe kalimit të tij nga një shtet anëtar në një tjetër, në shumicën e rasteve nuk është aplikuar kërkesë padisë për shpërblimin e dëmit vetëm mbi këtë bazë. Kërkesë padi të tilla janë pranuar dhe është dhënë dëmshpërblim vetëm në rastet kur në shkelje të marrëveshjes së juridiksionit, pala ka depozituar kërkesë padinë në një shtet jasht B.E-së.<sup>14</sup> Gjykatat e sistemit common law shkeljen e marrëveshjes së juridiksionit e konsiderojnë si shkelje substanciale, duke aplikuar ligjin e zgjedhur nga palët dhe kërkesë padinë për shpërblimin e dëmit për shkeljen e saj. Ndërsa, gjykatat e sistemit civil law e konsiderojnë shkelje procedurale, duke mos e pranuar kërkesë padinë për

---

<sup>11</sup> Koji Takahashi, Damages for breach of a choice-of-court agreement, Yearbook of Private international law, vol 10.(2008),60.

<sup>12</sup> *Union Discount v. Zoller*, Queen bench division Court,2001.

<sup>13</sup> C VIII ZB 55/04,2005 Vendim nga Gjykata e Lartë Federale Gjermane,(Bundesgerichtshof)

<sup>14</sup> Koji Takahashi, Damages for breach of a choice-of-court agreement, Yearbook of Private international law, vol 10.(2008), 10.

dëmshpërblim si pasojë e shkeljes së marrëveshjes së juridiksionit, në rastet kur ky i fundit i ka kaluar një shteti tjetër brenda B.E – së.

## **2.2 Risitë që solli Rregullorja 1bis e Brukselit**

Rregullorja 1215/2012 vendosi rregullua të reja në fushën e juridiksionit të gjykatave dhe thjeshtëzoi në mënyrë thelbësore procedurat mes palëve. Rregullat e parashikuara në të lehtësojnë qarkullimin e lirë të vendimeve të gjykatës dhe përmirësojnë aksesin në drejtësi. Risitë që solli Rregullorja 1bis e Brukselit përshijë aspektet ligjore që kanë të bëjnë me përmirësimin e efektivitetit të marrëveshjes së zgjedhjes së gjykatës apo e quajtur ndryshe Marrëveshjes së juridiksionit, heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shtetet anëtare, “procedura exequator”, zgjerimi i rregullave të juridiksionit edhe për personat që nuk banojnë në vendet anëtare të Bashkimit Europian, parashikimi i rregullave të detajuara kur ndodhemi para rasteve të përjashtimit të arbitrazhit, apo dhe rregullat e reja që lidhen me masat e sigurimit të padisë.

### **2.2.1 Shkaqet e miratimit të një Rregulloreje të re për rregullimin e marrëdhënieve juridike në fushën civile dhe tregtare.**

Marrëdhëniet juridike në fushën e juridiksionit dhe çështjet civile dhe tregtare rregulloheshin nga rregullorja 44/2001, e cila qëndroi në fuqi për 15 vite, poru vu re se disa parashikime të saj çonin në kolizion normash dhe në praktikë nuk jepnin efektin e duhur. Disa nga aspektet që duheshin ndryshuar kishin të bënin me çështje si gjyqëvarësia, gjykimi apo jo i marrëveshjes së arbitrazhit nga gjykatat e zakonshme, faktet lidhëse, juridiksioni dhe zbatimi i tij dhe ndaj personave jo rezident në B.E, heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimit, si një procedurë që zgjaste shumë në kohë dhe ishte me kosto të lartë.

Raporti i Komisionit Europian mbi zbatimin e kësaj rregulloreje në praktikë e vërtetoi një sërë problematikash në aplikimin e drejtë të saj dhe luajti një rol vendimtarë në miratimin e rregullores 1215/2012 e njohur ndryshe si rregullorja 1bis e Brukselit, për sa i përket zgjerimit të shtrirjes së saj dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në Bashkimit Europian.<sup>15</sup> Komisioni Europian vëzhgoi në mënyrë praktike aplikimin e Rregullores, duke nxjerr në pah problematikat e zbatimit dhe fushat ku kishte nevojë për të ndërhyrë me masa legislative.

Rol kryesor në hartimin e rregullores së re luajti edhe programi me titull “Programi i Stokholmit”, i cili u krijua në mbledhjen e Brukselit më datë 10 dhe 11 Dhjetor 2009. Ky program vë theksin te një Europë e hapur dhe e sigurtë. Në programin e Stokholmit Këshilli Europian sugjeroi heqjen e procedurës së njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja, për arritjen e objektivave të Bashkimit Europian në ruajtjen dhe zhvillimin e fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, duke lehtësuar aksesin në drejtësi, veçanërisht përmes parimit të njohjes reciproke të vendimeve në çështjet civile dhe bashkëpunimit gjyqësor, në bashkëpunim me shtetet ndërkufitare, me qëllimin funksionimin sa më të mirë të tregut të përbashkët europian. Diferencat mes rregullave të brendshme që çështjet e juridiksionit dhe njohjes së vendimeve dëmtojnë veprimin e tregut të brendshëm. Prandaj, unifikimi i rregullave për zgjidhjen e konflikteve juridiksionale në çështjet civile dhe tregtare si dhe sigurimi i njohjes dhe zbatimit të vendimeve gjyqësore në mënyrë të shpejtë është thelbësore.<sup>16</sup>

Rregullorja 1bis e Brukselit pasqyron realitetin e sotëm të Bashkimit Europian dhe nevojën për besim reciprok, siç e quan Gj.E.D mes gjykatave të shteteve anëtare, për

---

<sup>15</sup> Raporti i Komisionit Europian i dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.

<sup>16</sup> Raporti i Komisionit Europian i dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.

përmirësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve në fushën civile dhe tregtare, ndërveprimin dhe bashkëpunimin në shumë fusha të së drejtës, të subjekteve me origjinë të ndryshme, dinamikës së levizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, funksionimit të tregut të brendshëm Europian. Rregullat e juridiksionit duhet të jenë të parashikueshme dhe të bazohen në parimin se juridiksioni në përgjithësi bazohet në vendbanimin e të paditurit. Juridiksioni duhet të jetë i disponueshëm dhe i mirëpërcaktuar në mënyrë që të shmangen konfliktet juridiksionale. Për më tepër, në mënyrë që të përmirësohet administrimi i drejtësisë, duhet që juridiksioni të ketë si bazë një lidhje të ngushtë mes gjykatës dhe veprimit bazuar në vendbanimin e të paditurit. Ekzistenca e kësaj lidhjeje të ngushtë duhet për të respektuar parimin e sigurisë juridike dhe për të shmangur mundësinë që një person të paditet në gjykatat e një shteti anëtar të cilin ai nuk e ka parashikuar, duke i vështirësuar mbrojtjen dhe aksesin në gjykim.

Kjo është e rëndësishme veçanërisht në çështje që lidhen me detyrime jo kontraktore që ngrihen në lidhje me privatësinë dhe të drejtat që lidhen me personalitetin, përfshirë këtu dhe shpifjen. Në lidhje me raste të veçanta, si p.sh kur si palë e paditur janë konsumatorë, të punësuar apo në rastet e kontratave të sigurimeve, pala më e dobët, duhet të mbrohet nga rregullat e juridiksionit më të favorshme në interes të tyre, se sa të aplikohen rregullat e përgjithshme të juridiksionit. Nëse marrëveshja që përzgjedh një gjykatë të një shteti anëtar është nul, për sa i përket vlefshmërisë së pikave të tjera të marrëveshjes do të zbatohet ligji i shtetit anëtar të Bashkimit Europian që kanë përzgjedhur, përfshirë këtu dhe konfliktin e ligjeve të atij shteti anëtar. Kështu, për vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje do të zbatohen ligjet e atij shteti anëtar të përzgjedhur në marrëveshjen e palëve. Për harmonizimin e administrimit të drejtësisë është e nevojshme minimizimi i mundësive që të jepen vendime të ndryshme nga

gjykatat e shteteve anëtare për të njëjtën çështje. Për këtë arsye duhej një mekanizëm për zgjidhjen e çështjes së litispendencës ose gjyqëvarësisë, dhe çështjeve të lidhura, për të shmangur probleme që rrjedhin nga ndryshimet nacionale për përcaktimin e juridiksionit dhe përcaktimet se kur një çështje konsiderohet pezull përpara një apo disa gjykatave.

Në mënyrë që të rritet efektiviteti i marrëveshjes së përzgjedhjes së gjykatës dhe të shmangen abuzimet e mundshme të gjyqëvarësisë, u pa e nevojshme miratimi i një rregulloreje të re, e cila do të rregullonte marrëdhëniet në rastet kur hasen procedura konkurruese. P.sh në situatën kur një gjykatë që është zgjedhur nga palët që ka juridiksion ekzkluziv mbi çështjen ka filluar procedurën mbi çështjen, por ndërkohë çështja ka filluar dhe në një gjykatë tjetër, mes të njëjtëve palë dhe për të njëjtin objekt, këtu kemi të bëjmë me procedura konkurruese. Sipas rregullores 44/2001, në këto raste gjykatat e tjera duhet të pezullonin gjykimin, derisa të përcaktohej juridiksioni i gjykatës së fillimit, duke i dhënë kështu prioritet gjykatës ku është filluar së pari çështja në krahasim me gjykatën e përzgjedhur, gjë që me miratimin e rregullores 1215/2012 ndryshoi duke i dhënë prioritet dhe prevalencë gjykatës së përzgjedhur nga palët me marrëveshje mes tyre.

### **2.3 Risitë në fushën e zbatimit të Rregullores 1 bis të Brukselit**

Fusha e zbatimit të rregullores përcaktohet që në preambulën e saj, duke parashikuar që aplikohet në çështje civile dhe tregtare pavarësisht llojit të gjykatës që jep vendimin.

Ndryshimet në fushën e zbatimit të rregullores janë të vogla. Rregullorja ende aplikohet në çështjet civile dhe tregtare dhe ruan përjashtimin nga fusha e zbatimit të saj, të çështjeve fiskale, të doganave apo administrative. Gjithashtu, nuk aplikohet për zotësinë



juridike dhe zotësinë për të vepruar të personave fizik, të drejtën e pronësisë që rrjedh nga një marrëdhënie martesore. Rregullorja nuk aplikohet për procedurat e falimentit, të shpalljes insolvabël të kompanive dhe personave juridik, sigurimeve shoqërore, arbitrazhit, detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet familjare, prindërimi, birësimi, testamenti dhe trashëgimia, si dhe detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i vdekjes së personit.

Risia në fushën e zbatimit të rregullores është përjashtimi nga fusha e zbatimit të saj të akteve që nxirren në ushtrim të pushtetit autoritetit shtetëror, të njohur ndryshe si *acta iure imperii*.<sup>17</sup> Këto akte bazuar në rregulloren 1215/2012 nuk përfshihen në fushën e zbatimit të saj, në ndryshim nga rregullorja 44\ 2001 e cila rregullonte edhe këto lloj aktesh.

### **2.3.1 Heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve, si një risi e Rregullores 1bis të Brukselit.**

Objektivi kryesor i Rregullores 1bis të Brukselit është të thjeshtëzoj dhe të përshpejtoj njohjen reciproke të vendimeve mes shteteve anëtare të B.E. si dhe të promovojë lëvizjen e lirë të këtyre vendimeve në Bashkimin Europian. Kështu, ndryshimi i saj më i madhë është heqja e procedurës së ekzekutimit duke prezantuar në këtë mënyrë një mekanizëm më të thjeshtë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Rregullorja 1215/2012 në mënyrë substanciale thjeshtëzon sistemin e vendosur nga Rregullorja Bruksel 1, duke shkrirë procedurën “*exequatur*”, “*ekzekutimi i vendimit*”.

---

<sup>17</sup><http://www.peeters-law.be/documents/analyse-items/80-brussel-i-bis-verordening.xml>

Procedura exequatur, është një procedurë për deklarimin e ekzekutimit të vendimeve të dhëna nga një shtet anëtar, në shtetet e tjera anëtare. Sipas Rregullores Bruksel 1, duhej një deklaratë ekzekutimi për një vendim të dhënë nga një gjykatë e shtetit anëtar në mënyrë që ky vendim të zbatohet në një tjetër shtet anëtar. Rregullorja Brukselit 1 kërkonte që një vendim gjykate të dhënë nga një shtet anëtar i B.E të ishte i ekzekutueshëm në shtetet e tjera anëtare duhet të plotesohej një deklaratë ekzekutueshmërie, e cila kërkohej nga personi i interesuar në gjykatën e ekzekutimit, bazuar në nenin 38(1): *“një vendim gjykate të dhënë në një shtet anëtar dhe i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm në një tjetër shtet anëtar, n.q.s me aplikimin e palës së interesuar, është bërë i ekzekutueshëm dhe atje”*.<sup>18</sup>

Në çështjen *wolf v. Cox*, pala paditëse kërkonte që vendimi i dhënë nga gjykata Belge të njihej dhe të ekzekutohej nga gjykata e Hollandës, duke aplikuar përpara gjykatës hollandeze një procedurë më të lirë se ajo e përcaktuar nga Konventa e Brukselit. Sipas kësaj procedure, jo vetëm bëhej njohja e vendimit, por prekte dhe thelbin e çështjes, pra bënte një rigjykim të çështjes konkrete. Gjykata Europiane e Drejtësisë duke interpretuar nenin 31 të Konventës së Brukselit vendosi që: Konventa e Brukselit në asnjë rrethanë nuk parashikon që në procesin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të dhënë nga një gjykatë e një tjetër shteti anëtar të gjykohet thelbi i çështjes. Kjo për të shmangur vendime të ndryshme për të njëjtën çështje mes gjykatave të shteteve anëtare. Gjithashtu, Gjykata Europiane e Drejtësisë vendosi që e vetmja mënyrë që një vendim të bëhet i zbatueshëm në një tjetër shtet anëtar është njohja dhe zbatimi nëpërmjet

---

<sup>18</sup> Neni 38(1) i Rregullores 44/2001 për Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.

procedurës së ekzekutimit të parashikuar nga Konventa e Brukselit, jo ndonjë procedurë tjetër e njohur nga ligji i shtetit ku aplikon.<sup>19</sup>

Në një tjetër çështje të ngjashme Gj.E.D dha zgjidhje koherente duke përcaktuar si të vetmen procedurë për njohjen e vendimit të një gjykate të huaj, atë të parashikuar nga Konventa e Brukselit, dhe jo ndonjë procedurë tjetër që prekte themelin e çështjes.<sup>20</sup>

Komisioni European pasi vëzhgoi në praktikë zbatimin e rregullores 44/2001 për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të shteteve anëtare, konstatoi që kjo procedurë zgjaste procesin e ekzekutimit dhe kishte kosto të lartë për palët. Komisioni rekomandoi heqjen e kësaj procedure për lehtësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve.<sup>21</sup>

Sipas Komisionit European procedura e ekzekutimit zakonisht kushtonte nga 2.000 deri në 3.000 euro në varësi të shtetit anëtar ku bëhej aplikimi për të, ndërsa duke përfshirë dhe kostot e avokatit, përkthimin e dokumentit dhe shpenzimet gjyqësore kjo kosto varionte deri në 12.700 euro. Në pothuajse 95% të rasteve kjo procedurë ishte thjesht një formalitet.<sup>22</sup>

Rregullorja 1215/2012 bën të mundur që një vendim i dhënë në një shtet anëtar, i cili është në fuqi dhe i ekzekutueshëm në atë shtet anëtar, të jetë i ekzekutueshëm në të gjitha shtetet anëtare, pa qënë nevoja për nxjerrjen e një deklarate ekzekutueshmërie.

Neni 39 i Rregullores 1215/2012 parashikon: *“një vendimi dhënë në një gjykatë të një shteti anëtar, i cili është i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm dhe në*

---

<sup>19</sup> Wolf v. Cox, 42\76 ECR 01759

<sup>20</sup> Case Hoffmann v. Krieg

<sup>21</sup> Raporti i Komisionit European i dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.

<sup>22</sup> [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-3080\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-3080_en.htm).

*shtetet e tjera anëtare pa qënë nevoja e nxjerrjes së ndonjë deklarate ekzekutueshmërie*”.<sup>23</sup>

Reforma e “Heqjes së procedurës së ekzekutimit” është risia më e vlerësuar e Rregullores 1bis të Brukselit. Me rregulloren e mëparshme e cila duke filluar nga 10 janari 2015 është shfuqizuar, në mënyrë që të implementohej një vendim gjykate i një shteti anëtar në një tjetër shtet anëtar, duhej që paraprakisht të merrej një deklaratë zbatueshmërie nga një gjykatë nacionale. Me rregulloren 1215/2012, neni 39, deklarata e ekzekutueshmërisë nuk është më e nevojshme. Kjo për faktin se një vendim gjykate i dhënë në një shtet anëtar dhe i zbatueshëm në atë shtet anëtar duhet të jetë i ekzekutueshëm dhe në shtetet e tjera anëtare pa tërhequr deklaratën e zbatueshmërisë. Kjo do të thotë që çdo vendim i dhënë nga një gjykatë e një shteti anëtar të Bashkimit European do të njihet dhe zbatohet automatikisht në çdo shtet anëtar. Vendimi i gjykatës do të trajtohet njësoj sikur të jetë dhënë nga gjykata e shtetit anëtar ku kërkohet të ekzekutohet.

Nga 10 janari 2015, dita kur ka hyrë në fuqi Rregullorja 1 bis e Brukselit, në mënyrë që një vendim të bëhet i ekzekutueshëm në shtetet e tjera anëtare duhet që pala të cilës i drejtohet vendimi të paraqesi përpara gjykatës ku do të ekzekutohet vendimi, një kopje të vendimit dhe një certifikatë standarte të nxjerrë nga gjykata që ka dhënë vendimin, parashikuar në nenin 42 (1) dhe 53 të Rregullores. Kështu, pala që dëshiron të ekzekutohet vendimi në një tjetër shtet anëtar, duhet të pajisë autoritetin kompetentë të ekzekutimit me një kopje të vendimit duke siguruar autenticitetin e tij, dhe një certifikatë e siguruar nga gjykata e origjinës, pra gjykata që ka dhënë vendimin. Sipas

---

<sup>23</sup> Rregullorja e Këshillit Eurpian nr.1215/2012, mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare, neni 39.

ligjit të shtetit ku aplikon, personi i interesuar mund të kërkojë ekzekutimin e vendimit. Në zbatimin praktik, rekomandohet që personi të cilit i drejtohet vendimi, të paraqesi së bashku me vendimin, një përkthim të dokumentave, megjithëse përkthimi nuk kërkohet në mënyrë strikte nga Rregullorja e re, por për të shmangur kundërshtimet që mund të paraqesë pala tjetër.<sup>24</sup> Bazuar në nenin 40 të Rregullores 1bis të Brukselit, një vendim i ekzekutueshëm do të përfshijë ekzekutim edhe masat mbrojtëse të cilat ekzistojnë bazuar në ligjin e shtetit anëtar të cilit i adresohen.

Procedura e ekzekutimit rregullohet nga ligji i atij shteti anëtar ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit. Refuzimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor mund të kërkohet në rastet kur vendimi është në kundërshtim me rendin publik ose është në kundërshtim me një vendim të dhënë më parë për të njëjtin objekt, mes të njëteve palë ndërgjyqëse. Kjo është e mundur me kërkesën e debitorit apo e çdo pale të interesuar, e cila kërkon mos ekzekutimin e vendimit përkatës. bazuar në ligjin e shtetit në të cilin kërkohet ekzekutimi.

Heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve në shtetet anëtare redukton rrezikun që ekzekutimi i vendimit të vonohet pa arsye objektive, duke i shërbyer funksionimit të duhur të tregut të përbashkët dhe organizimit të gjyqëvarësinë mes shteteve anëtare në mënyrë efikase.<sup>25</sup> Një vendim që jepet në një shtet anëtar trajtohet njësoj sikur është dhënë në çdo shtet anëtar, edhe në rastet kur vendimi jepet kundër një subjekti që nuk është rezident në vendet e B.E – së.

---

<sup>24</sup> [www.jonesday.com/commentary](http://www.jonesday.com/commentary)

<sup>25</sup> <http://www.peeters-law.be/documents/analyse-items/80-brussel-i-bis-verordening.xml>

### 2.3.2 Arsyet ligjore të refuzimit të ekzekutimit të vendimit

Zbatimi i drejtëpërdrejtë në shtetet anëtare të një gjykimi të dhënë në një tjetër shtet anëtar, pa deklaratën e zbatimit nuk duhet të rrezikojë respektimin e të drejtave të mbrojtjes. Prandaj, në raste të caktuara një person mund të ngrejë çështjen e refuzimit të njohjes dhe zbatimit të një vendimi gjykate. P.sh kur i është mohuar e drejta e mbrojtjes. Kështu, njihet e drejta e refuzimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve të gjykatave të huaj kur palës së paditur nuk i janë krijuar kushtet për të realizuar mbrojtjen, i është mohuar e drejta për tu dëgjuar ose e drejta për të paraqitur dokumenta në seancë gjyqësore etj, pra kur është shkelur parimi i barazisë së armëve, i cili është një pjesë e rëndësishme e parimit të procesit të rregullt ligjor.

Ndryshimet që solli Rregullorja 1bis të Brukselit nuk prekën mekanizmin e refuzimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve, të parashikuara në nenin 45 të saj, i cili korrespondon me nenin 34 dhe 35 Rregullores 1 të Brukselit. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit nuk është absolut dhe nuk kryhet në çdo rast. Refuzimi i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve bëhet në raste të limituara dhe specifike. Arsyet ligjore për refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shtetet anëtare janë të njëjta si me rregulloren e parë. Refuzohet njohja e vendimit n.q.s vendimi është haptazi në kundërshtim me rendin publik të shtetit ku kërkohet të njihet apo ekzekutohet. Gjithashtu, do të refuzohet njohja e vendimit nëse vendimi është dhënë në mungesë të palës së paditur duke mos e njoftuar rregullisht, apo në rastet kur nuk i janë vënë në dispozicion dokumentat gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë kështu që i padituri mos të ketë mundësi të realizojë mbrojtjen ligjore para gjykatës për çështjen në fjalë. Nëse vendimi është në kundërshtim me një vendim të mëparshëm mes të njëjtave

palë, dhënë në shtetin anëtar ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tij, si dhe n.q.s vendimi është në kundërshtim me rregullat e juridiksionit të veçantë për çështjeve që kanë si palë të paditur të siguarit, konsumatorët dhe punëmarrësit, bazuar në nenin 10-16, neni 17-19, neni 22-23 si dhe bazuar në rregullat e juridiksionit ekskluziv të parashikuara në nenin 24. Me termin vendim do të kuptojmë çdo vendim që jepet nga gjykata ose nga një tribunal i një shteti anëtar, pavarësisht emërimit të tij vendim, urdhër, urdhëresë apo akt ekzekutimi.

Sipas Komisionit European rregullorja e re që heq procedurën e mëparshme dhe të gjatë të ekzekutimit, e cila përdorej 10,000 herë në vit, për rrjedhojë çështjet ndër-kufitare do të zgjidhen më shpejtë dhe do të kursejë shpenzimin e 48 milion Eurove në vit në Bashkimin European.<sup>26</sup>Në rastet kur vendoset refuzimi i njohjes dhe i ekzekutimit të vendimit, në asnjë lloj rrethane, gjyqtari nuk mund të rigjykojë apo të modifikojë vendimin original të gjykatës. Kështu, edhe nëse ndodhemi përpara rrethanave të përmendura në nenin 45 të Rregullores, për refuzimin e njohjes apo ekzekutimit të vendimit, nuk është në diskrecionin e gjyqtarit që e vlerëson ekzistencën apo jo të rrethanës, të ndryshojë vendimin, të rihapë çështjen apo të bëjë modifike të ndryshme në vendimin original. Ky parashikim i Rregullores 1bis të Brukselit është në përputhje me rregulloren EC nr.805/2004, Për krijimin e një urdhëri european për ekzekutimin e vendimeve të çështjeve të pakontestuar, që ka hyrë në fuqi në 21 Tetor 2005, e cila për herë të parë hoqi kërkesën për ekzekutim ndaj vendimeve të pakundërshtuar, që i është parashkruar afati i apelimit të vendimit. Për të tilla pretendime, duhet të paraqitet vetëm një certifikatë ekzekutimi, e njohur ndyshe si “Urdhëri European i Ekzekutimit”.Kjo certifikatë nxirret nga gjykata që ka dhënë vendimin. Gjithashtu, një parashikimi i

---

<sup>26</sup>[http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-3080\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-3080_en.htm).

tillësshtë në përputhje të plotë me jurisprudencën e Gj.E.D në të cilën parashkohet se gjykimi për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit nuk parashikon rigjykimin e çështjes.<sup>27</sup>

### **2.3.3 Zgjerimi i rregullave të juridiksionit edhe për personat që nuk banojnë në vendet anëtare të Bashkimit European.**

I gjithë kuadri ligjor që ka rregulluar marrëdhëniet juridike në fushën civile dhe tregtare, duke filluar nga Konventa e parë e Brukselit, Konventa e Luganos, Rregullorja nr.44/2001 e Këshillit European mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, aplikoheshin vetëm mbi shtetasit që kishin vendbanim ose vendqëndrim në shtetet e Bashkimit European. Fusha e zbatimit të rregullores ishte përcaktimi i Juridiksionit të shteteve anëtare të Bashkimit European, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Përsa i përket juridiksionit, si rregull i përgjithshëm ai përcaktohej nga vendbanimi i personit në një shtet anëtarë, cilado qoftë shtetësia e tij. Personat që nuk janë shtetas të shtetit anëtarë, por që banojnë në këtë shtet janë nën juridiksionin që zbatohet për shtetasit e këtij shteti. Këta shtetas mund të paditen në gjykatat e shteteve anëtare, përsa kohë kanë vendbanimin në një nga vendet anëtare dhe do të zbatohen të njëjtat rregulla të juridiksionit si për vendasit. Rregullorja nuk zbatohet për personat që nuk ishin resident në një nga shtetet e Bashkimit European. Nga analiza e neneve të Rregullores 44/2001 vihet re që kishte si parim kryesor aplikimin e saj vetëm mbi shtetasit që kishin vendbanim ose vendqëndrim në një nga shtetet anëtare të Bashkimit European, në ndryshim nga rregullorja e re e Brukselit Nr. 1215/2012 e cila ka shtrirje më të gjerë, duke u aplikuar edhe mbi personat fizik apo juridik që nuk janë rezidentë në një nga

---

<sup>27</sup> Wolf v. Cox dhe Hoffmann v. Krieg.



vendet e B.E. Rregullorja 1 e Brukselit aplikohej vetëm në mosmarrëveshje ku pala e paditur ishte rezident në B.E, pa qënë e rëndësishme vendbanini i palës paditëse, bazuar nënënet 2, 3, 4 të Rregullores 1 të Brukselit. Dallohej ndryshimi në trajtimin përpara gjykatave europiane tëpersonave që janë rezidentë në një nga shtetet anëtare me të huajt. (Mandro.Ëalker,Kadia,2005:96)Në sesionin 6 neni 22 rregullorja parashikonte juridiksionin ekskluziv.Ky lloj juridiksioni ishte i detyrueshëm në nivel komunitar dhe kishte aplikim të drejtpërdrejtë. Në raste të tilla juridiksioni nuk mund të përzgjidhej me marrëveshje të palëve, sepse në të kundërt kjo klauzolë juridiksionale do të ishte absolutisht e pavlefshme.Ky ishte një juridiksion nga i cili nuk mund të hiqje dorë dhe nuk e merrte parasysh rregullin e përgjithshëm, atë të rezidencës së palës së paditur. Në çdo rast, nëse palët njëra ose më shumë rezidentë në një nga shtetet anëtare, bien dakort që një gjykatë do të ketë juridiksion, është pikërisht kjo gjykatë që do të gjykonte çështjen.Ky juridiksion në këtë rast ishte ekskluziv në rast se palët nuk kishin vendosur ndryshe.

Risia që sjell Konventa 1bis e Brukselit, ka të bëjë me aplikimin e saj dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në Bashkimin Europian. Rregullorja 1215/2012 ka si qëllim lehtësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve gjyqësore në Bashkimin Europian dhe aksesin në gjykim, si pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, si garanci për mbrojtjen e të dretjave dhe interesave legjitim të subjekteve të interesuar. Kjo rregullore zgjeroi fushën e zbatimit të juridiksionit dhe u bë e aplikueshme edhe për të paditurit që nuk janë rezident në një nga vendet anëtare. Kështu, duke filluar nga Janari 2015 të gjitha marrëdhëniet që rregullon kjo rregullore do të shtrihen dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në B.E. Ky është një ndryshim themelor që bën Konventa 1bis e Brukselit në ndryshim nga i gjithë kuadri ligjor që ka qënë në fuqi deri në vitin 2015.

Ky ndryshim u bë për shkak të zhvillimeve dinamike që ka aktualisht Bashkimi European, për t'i shërbyer qarkullimit të lirë të vendimeve dhe për t'i dhënë mundësi palës së paditur, si palë që ka nevojë më tepër për mbrojtje reale, për tu dëgjuar e për të realizuar mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre, duke i shërbyer aksesit në drejtësi. Kështu, përveç heqjes së procedurës së njohjes së vendimeve gjyqësor, ka zgjeruar qëllimin e juridiksionit edhe mbi të paditurit që nuk janë rezidentë në vendet e B.E. Rregullorja e re përcakton se rregullat e juridiksionit do të bazohen në vendbanimin e të paditurit, përveç në disa raste të caktuara në të cilat për shkak të subjektit ose autonomisë së palëve justifikon përdorimin e kritereve të ndryshme. Kjo bëhet që të parandalojë që një person të marri një kërkesë padi nga një gjykatë e një shteti anëtar që nuk ka mundur ta parashikojë. Siç e theksova dhe më lart, kjo rregullore shtrihet vetëm mbi shtetasit që ishin resident në B.E. në rast se marrëveshja lidhet nga palë që nuk ishin resident në B.E gjykatat e atij shteti anëtar nuk do të kishin juridiksion mbi mosmarrëveshjen e palëve. Çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me nenet 13, 17 ose 21 të Rregullores Bruksel 1ishte e pavlefshme. Rregullorja 44/2001 bën një rregullim të detajuar për sa i përket çështjes së derogimit të juridiksionit me marrëveshjen e palëve. Në nenin 25 të Rregullores së Brukselit nr.44/2001 I njihej mundësia palëve që nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët të të zgjedhin njërin juridiksion të një shteti anëtar për mosmarrëveshjen e tyre, me kushtin sinequanon që palët të kishin vendbanimin në Bashkimin European.

Tashmë me Rregulloren 1bis të Brukselit nr.1215/2012 është modifikuar ky nen dhe korrespondon me nenin 27 të saj i cili i jep mundësi për përzgjedhjen e juridiksionit me marrëveshje edhe palëve që nuk janë rezident në B.E. Neni 27 i rregullores 1bis të Brukselit, sipas të cilës i njihet mundësia palëve që nëpërmjet një marrëveshjeje të

përbashkët, të zgjedhin njërin juridiksion të një shteti anëtar, që u duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre, që ka lindur ose që mund të lindë në të ardhme. Kushti që paditësi të kishte vendbanimin ose vendqëndrimin në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian është shfuqizuar. Këtë marrëveshje ka të drejtë ta lidhi kushdo pavarësisht vendbanimit të tij. Gjithashtu, rregullorja parashikoi rregulla specifike për disa kategori që tashmë gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga normat e saj. Këto kategori janë konsumatorët, punëmarrësit dhe të siguruarit. Bazuar në rregulloren 44/2001 konsumatorët shpesh nuk kishin mundësi të ushtronin të drejtat e tyre, në rastet kur blinin mallra nga kompani me seli në një shtet jo anëtar i B.E, por që shisnin mallra në B.E.

Rregullat e reja të juridiksionit në lidhje me punëmarrësit, konsumatorët dhe të siguruarit do të aplikohen pavarësisht vendbanimit të punëdhënësit, kompanisë tregtare, apo kompanisë së sigurimeve. Përveç rregullit të përgjithshëm për përcaktimin e juridiksionit, rregullorja njih edhe përjashtime, të cilat i konsideron juridiksione të veçanta. (Brati, 2008:73)

Rregullat e juridiksionit të veçantë mbrojnë këto kategori të veçanta, respektivisht në nenet 10, 17, 18, 20, 21 të rregullores së re. Kështu, një punëdhënës i cili nuk ka vendbanimin në një shtet anëtar, mund të paditet në një gjykatë të B.E ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij, ose në gjykatën e shtetit ku ka kryer së fundmi punën e tij, edhe pse punëdhënësi nuk ka seli në B.E, por në shtetet e treta.

#### **2.3.4 Arbitrazhi, përjashtimisht brenda qëllimit të Rregullores.**

Një nga debatet më të forta në lidhje me Rregulloren<sup>1</sup> të Brukselit lidhej me natyrën e “përjashtimit të arbitrazhit” nga qëllimi i rregullores. Arbitrazhi është i përjashtuar nga

fusha e zbatimit të rregullores 1215/2012. Megjithatë, një sërë vendimesh të Gjykatës Europiane të Drejtësisë e përmbysën këtë parim.

Si rregull, Rregullorja aplikohet vetëm në çështjet civile dhe tregtare, por ka dhe përjashtime, e një nga këto përjashtime është arbitrazhi. Arsyeja e përjashtimit të arbitrazhit nga qëllimi i rregullores është se arbitrazhi rregullohet nga konventa të tjera, përfshirë këtu dhe Konventën e Nju Jorkut. Ka patur propozime gjatë draftimit të Rregullores së re për të vendosur rregulla për koordinimin më të mirë mes arbitrazhit dhe procesit gjyqësor. Problemi në praktikë ka lidhje me çështje të tilla si përplasja mes arbitrazhit dhe rregullores, sidomos në procedura që përfshijnë ekzistencën apo vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.<sup>28</sup> Përpara miratimit të Rregullores së re, përcaktimi së çështja do të përfshihej në përjashtimet për arbitrazhin, bëhej duke patur si kriter objektin e çështjes dhe nëse ky objekt përshihej në qëllimin e rregullores. Praktika që merrej parasysh lidhej me natyrën e të drejtave që mbronte marrëveshja. Nëqka këto të drejta përfshiheshin në qëllimin e rregullores, atëherë gjykata do të bënte vlerësimin e marrëveshjes së arbitrazhit.

Sipas kësaj qasje, nëse gjykata e vlerësonte objektin e kërkesë padisë të përfshirë në qëllimin e rregullores, çdo pretendim në lidhje me ekzistencën apo vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit konsiderohej kompetencë e gjykatës. Kjo paqartësi u theksua më tepër nga vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në një nga çështjet më të njohura në këtë fushë “*West Tankers*”, e cila u kritikua për zgjerim të qëllimit të Rregullores së Brukselit, duke përfshirë në të dhe arbitrazhin, në një mënyrë që dëmton efektivitetin e marrëveshjes së arbitrazhit. Kritikët argumentuan se ky vendim i lejon

---

<sup>28</sup> [www.blplaw.com/arbitrationexception](http://www.blplaw.com/arbitrationexception)

palët të shpëtojnë nga detyrimi për t'ia nënshtruar mosmarrëveshjen e tyre arbitrazhit, duke zgjedhur gjykatën e tyre të preferuar dhe në këtë mënyrë të fillojnë gjykimi i themelit të çështjes, e njohur si procedura “Italian Torpedo”, pra abuzim me procedurën.

Ky propozim u përfshi në raportin e Komisionit European për ndryshimet që duhet të përshiheshin me miratimin e Rregullores së re të Brukselit. Rregullorja 1215/2012 përmban sqarime të detajuara në lidhje me këtë çështje. Së pari, përjashtimi i arbitrazhit vazhdon të jetë në fuqi dhe me rregulloren e re, përkatësisht neni 1(2)(d) e gjithashtu sqaron detajet se kur kemi të bëjmë me përjashtim për sa i përket arbitrazhit që shpjegojnë mënyrën se si duhet interpretuar ky përjashtim nga rregulli i përgjithshëm. Gjithashtu, Rregullorja 1bis e Brukselit ka përfshirë një nen të ri, nenin 73(2), i cili sanksionon se Rregullorja nuk do të ndikojë mbi aplikimin e Konventës së Nju Jorkut për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Sipas Rregullores 1bis e Brukselit, përjashtimi i arbitrazhit mbulon procedurat paraprake që lidhen me arbitrazhin, duke përfshirë këtu formimin e gjykatës, fuqinë e arbitrave, dhe njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi. Gjykatat e shteteve anëtare janë të lira të përcaktojnë vlefshmërinë ose jo të marrëveshjes së arbitrazhit, në përputhje me ligjin kombëtar. Kjo bën që një veprim i qëllmshëm i palëve në proces për të abuzuar apo shmangur procedurat juridiksionale, qoftë të arbitrazhit apo gjyqësore, nuk do të ndikojnë gjykatën e një shteti tjetër anëtar të gjykojë vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.

Gjykimi i vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit nga ana e gjykatës qëndron jashtë qëllimit të rregullores, pavarësisht se gjykohet si procedurë paraprake apo si kërkesë

themeli. Gjykatat e shteteve anëtare nuk janë të detyruara të zbatojnë një vendim të një gjykate tjetër për të njëjtën çështje, pra për vlefshmërinë apo jo të marrëveshjes. Kjo i jep liri gjykatave të shteteve anëtare të vendosin për vlefshmërinë ose jo të marrëveshjes së arbitrazhit pa u ndikuar nga vendimet e gjykatave të tjera.

Kjo rrit rrezikun e procedurave paralele në disa gjykata dhe dhënien e vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje. Konventa e Nju Jorkut prevalon mbi Rregulloren e Brukselit në rast të konfliktit mes një vendimi gjykate, i cili konstanton pavlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit dhe vendimit të arbitrazhit. Kjo lejon që gjykatat e shteteve anëtare të ekzekutojnë një vendim arbitrazhi nëse është i rregullt sipas Konventës së Nju Jorkut. Një vendim që jepet nga gjykatat e shteteve anëtare mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit nuk duhet të jetë subjekt i rregullave të njohjes dhe ekzekutimit që parashikohen në Rregulloren 1bis të Brukselit. Kur gjykata vendos që marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme, vendimi i gjykatës mbi themelin e çështjes duhet njohur dhe zbatuar sipas Rregullores 1215/2012.

Rregullorja 1215/2012 sqaron disa paqartësi që lidhen me rastet gjyqësore që ka shqyrtuar Gjykata Europiane e Drejtësisë, sidomos rasti *Ēest Tankers*.<sup>29</sup> Një palë ka mundësi të hapi proces gjyqësor mbi vlefshmërinë e një marrëveshje arbitrazhi dhe gjykata ku ngrihet çështja duhet t'i referoj palët në arbitrazh. Megjithatë, një gjykatë e shteteve anëtare nuk i kërkohet të njoh një vendim të një gjykate tjetër mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit. Edhe në rastet e vendimeve të kundërta, kur një gjykatë e një shteti anëtar vlerëson si të vlefshme marrëveshjen e arbitrazhit dhe në përputhje me Konventën e Nju Jorkut, ndërsa gjykata tjetër jep vendim gjyqësor të ekzekutueshëm

---

<sup>29</sup> C-185/07 *West Tankers*

sipas Rregullores 1215/2012, zbatimi dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit ka përparësi mbi ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Sipas nenit 73 pika 2 e rregullores, kjo rregullore nuk ka ndikim mbi zbatimin e Konventës së Nju Jorkut të 1958, pra janë dy rregullore paralele që nuk ndikojnë njëra - tjetrën.<sup>30</sup>

Megjithë përmirësimet që solli Rregullorja 1215/2012 për çështjet e arbitrazhit, disa aspekte mbetën ende të pasqaruara dhe ekziston ende rreziku i procedurave paralele në abuzim nga palët me qëllim shmangien e gjykatës kompetente. Gjithashtu, është rreziku i procedurave të përsëritura kur palët të pakënaqura nga një vendim mbi vlefshëminë e marrëveshjes së arbitrazhit, bëjnë përsëri kërkesë padi në gjykata të shteteve të tjera, duke qënë së në këto raste vendimet e gjykatave nuk janë detyruese për gjykatat e tjera të shteteve anëtare.

### **2.3.5 Masat e përkohshme si risi e rregullores**

Zbatimi i masave të përkohëshme meriton një vëmendje të veçantë, si një nga pikat ku rregullorja e re prezanton një risi të rëndësishme. Në rastet kur masat e përkohëshme, që përfshijnë dhe masat mbrojtëse, urdhërohen nga një gjykatë që ka juridiksion për thelbin e çështjes, qarkullimi i lirë i këtyre masave sigurohet dhe nga rregullorja. Megjithatë, kjo nuk aplikohet në të gjitha masat e përkohshme dhe masat mbrojtëse.<sup>31</sup>

---

<sup>30</sup>Marta Requejo Isidro, Recognition and Enforcement in the new Brussels I Regulation (Regulation 1215/2012, Brussels I recast, Barcelona, 2014).

<sup>31</sup>Marta Requejo Isidro, Recognition and Enforcement in the new Brussels I Regulation (Regulation 1215/2012, Brussels I recast, Barcelona, 2014).

Gjykata Europiane e Drejtësisë ka jurisprudencë të pasur në këtë fushë, ku saktëson problematikat e vërejtura në zbatimin praktik të masave të përkohshme.

Masat e përkohshme mbeten një hapësirë ku diversiteti në ligjin procedurat të shteteve anëtare bën të vështirë aplikimin e këtyre masave. Një nga rastet e paqartësisë dhe dykuptimësisë së vërejtur lidhet me marrjen e masave mbrojtëse, të cilat merren pa qënë e nevojshme të thirret i padituri. Në rastin C-125/79 ( Denilauler) Gjykata Europiane e Drejtësisë mbajti qëndrimin që këto lloj masash qëndrojnë jashtë qëllimit për njohjen dhe zbatimin e rregullores. Një tjetër vështirësi ngrihet në lidhje me masat mbrojtëse me qëllim marrjen e informacionit dhe provave. Në rastin C -104/03 (St. Paul Dairy), Gjykata Europiane e Drejtësisë mbajti qëndrimin se masat për sigurimin e dëshmisë një dëshmitari nuk mbulohet nga nocioni i masave mbrojtëse në kuptim të nenit 31 të Rregullores.

Nga interpretimi i jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë nuk del qartësisht deri në çmasë këto masa të përkohshme përjashtohen nga aplikimi i nenit 31 të Rregullores. Duke analizuar dhe interpretuar vendimet e gjykatës në raste të ndryshme sugjeroj që, në mënyrë që të zbatohet e drejta për akses në gjykatë, në të mirë të drejtësisë, si pjese e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, do të ishte më mirë që vetë rregullorja të përcaktonte juridiksionin për këto masa në gjykatat e shteteve anëtare ku është prova apo dëshmia që kërkohet të merret.

Një tjetër çështje që kërkon interpretim ka lidhje me aplikimin e kushteve të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë në rastin C-391/95 ( Van Uden ) dhe C-99/96 ( Mietz ), për rastet e marrjes së masave të përkohshme si p.sh rastet e sigurimit të padisë, në rastet kur gjykata nuk ka juridiksion për themelin e çështjes. Pra ekziston një dualizëm përse i



përket juridiksionit të gjykatës për marrjen e masave të sigurimit të padisë, kur juridiksionin për themelin e çështjes e ka një tjetër gjykatë.

Në këtë rast shtrohet çështja se Cili shtet ka juridiksion për marrjen e masave të sigurimit të objektit të padisë, kur palët me marrëveshje kanë përcaktuar një tjetër juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes? Sipas nenit 31 të rregullores: "Një kërkesë në gjykatat e shteteve anëtare mund të bëhet për masa të tilla të përkohëshme, përfshirë masa mbrojtëse, siç mund të jenë të disponueshme sipas ligjit të atij shteti, edhe në qoftë se, sipas rregullores, gjykata e një shteti tjetër anëtar kanë juridiksion në lidhje me thelbin e çështjes".

Kështu sipas rregullores edhe nëse për themelin e çështjes ka juridiksion një gjykatë tjetër e vendeve anëtare, për masat e sigurimit të padisë mund të jepen dhe nga kjo gjykatë.

Gjithësesi, nga interpretimi i rregullores dhe i vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtësisë nuk del qartësisht deri në çmasë këto masa të përkohshme përjashtohen nga aplikimi i nenit 31 të Rregullores. Në mënyrë që të zbatohet e drejta për akses në gjykatë, në të mirë të drejtësisë, si pjesë rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, do të ishte më mirë që vetë rregullorja të përcaktonte juridiksionin për këto masa në gjykatat e shteteve anëtare ku është prova apo dëshmia që kërkohet të merret.

### **Kapitulli III- Zhvillimet historike të rregullimit të marrëdhënieve juridike për juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare.**

#### **3.1 Kuadri ligjor europian që rregullon marrëdhëniet juridike për juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare.**

Çështjet tregtare dhe civile para krijimit të Bashkimit Europian janë rregulluar nga marrëveshjet bilaterale që bënë vetë shtetet me njëra tjetrën. Një nga marrëveshjet e para ishte ajo e lidhur mes Belgjikës dhe Francës më 8 Korrik 1899, Konventa mbi juridiksionin, vlefshmërinë dhe zbatimin e vendimeve, arbitrazhit dhe instrumenteve autentik Gjithashtu, vlen të përmendet Konventa për juridiksionin, njohjen e vendimeve, arbitrazhit dhe falimentit, e lidhur mes Belgjikës dhe Hollandës më 28 Mars 1925; Konventa mbi ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare mes Francës dhe Italisë e lidhur më 3 qershor 1930, në Romë, Konventa për ekzekutimin e vendimeve reciproke në çështjet civile dhe tregtare dhe protokollit të lidhur mes Britanisë së Madhe dhe Republikës së Francës, me 18 janar 1934; Konventa për njohjen reciproke të vendimeve të çështjet civile dhe tregtare dhe protokollit lidhur mes Britanisë së Madhe dhe Mbretërisë së Belgjikës më datë 2 Maj 1934. Konventën mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare lidhur në Romë më 9 mars 1936 mes Gjermanisë dhe Italisë. Konventën mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare lidhur në Romë më 30 qershor 1958 mes Gjermanisë dhe Belgjikës. Pra, ishin këto konventa specifike të lidhura mes dy shtetesh që rregullonin marrëdhëniet në këtë fushë deri në vitin 1968 që u miratua Konventa e Brukselit, e cila

zëvendësoi të gjitha konventat e mëparshme dhe i hapi rrugë krijimit të regjimit juridik të Brukselit, si një kornizë ligjore specifike dhe e vlerësuar në këtë fushë, me qëllime specifike, si qarkullimi i lirë i vendimeve gjyqësore, aksesit në drejtësi, besimit reciprok mes gjykatave të shteteve anëtare, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe tregtare, përmirësimi i realizimit të objektivave të tregut të përbashkët europian, etj.

Konventa e Brukselit e datës 27 Shtator 1968 ishte ndër aktet e para që rregulluan fushën e përcaktimit të juridiksonit në çështjet civile dhe tregtare, më pas u miratua Konventa e Luganos, më tej lënda që rregullohej nga Konventa e Brukselit, u normua nëpërmjet Rregullores së Këshillit të Komunitetit Europian nr. 44\2001 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e cila qëndroi në fuqi deri në miratimin e rregullores së re të Brukselit nr.1215/2012 e njohur si rregullorja 1 bis e Bruksellit, e cila hyri në fuqi më 10 janar 2015.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e lëvizjes së lirë të vendimeve në fushën civile dhe tregtare është e nevojshme dhe e domosdoshme që rregullat që përcaktojnë juridiksionin dhe njohjen e vendimeve të rregullohen nga një instrument legal komunitar i cili duhet të jetë i detyrueshëm dhe direkt i aplikueshëm. Normat europiane që rregullojnë marrëdhëniet në fushën civile dhe tregtare mund të përmbliidhen në atë kuadër ligjor të njohur si “Regjimi i Brukselit”, i cili ka 50 vjet që rregullon marrëdhëniet juridike në Bashkimin Europian dhe vlerësohet si gurë themeli në krijimin e një hapësire ligjore europian të përbashkët në këtë fushë. Qëllimi i këtij regjimi ligjor është të rregullojë të gjitha çështjet kryesore në fushën civile dhe tregtare, përveç çështjeve që janë të mirëpërcaktuara tashmë. Duhet të ketë një lidhje mes procedurave në të cilën ky regjim aplikohet dhe territorit të shteteve anëtare. Rregulla të përgjithshme të juridiksionit, si

parim aplikohen kur i padituri ka vendbanimin në një nga vendet anëtare. Një i paditur që nuk ka vendbanim në një shtet anëtar është subjekt i ligjeve të shtetit, shtetas i të cilit është, përsa i përket juridiksionit. Mëgjithatë me risitë e fundit të Rregullores 1bis të Brukselit, janë vënë re ndryshime themelore për sa i përket kësaj çështjeje. Tashmë, përpara gjykatave të B.E mund të paditen dhe persona fizik apo juridik që nuk janë rezidentë në B.E, por banojnë në shtete të treta. Për qëllimin e lëvizjes së lirë të vendimeve, vendimet që jepen nga gjykata në një shtet anëtar, duhet të njihen dhe në shtetet e tjera anëtare edhe në rastet kur i padituri ka vendbanim në një shtet të tretë, jo anëtar i B.E. Përsa i përket vendbanimit të të paditurit, duhet të ketë hapësira alternative juridiksionale bazuar në një lidhje të ngushtë mes gjykatës dhe veprimit juridik, në mënyrë që të lehtësohet administrimi i mirë i drejtësisë. Të renditura në rend kronologjik në “Regjimin e Brukselit” përfshihen: Konventa e Brukselit e vitit 1960, Konventa e Luganos e vitit 1988, Rregullorja e Brukselit nr.44/2001, dhe më e fundit që është objekt i studimit të këtij punimi është Rregullorja 1bis e Brukselit nr.1215/2012, e cila hyri në fuqi më 10 janar 2015. Të gjitha këto akte rregullojnë juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare në B.E.

### **3.1.1 Konventa e Brukselit**

Konventa e Brukselit e vitit 1968 edhe pse si kuadër të saj kishte vetëm shtetet të pranuar deri atëherë në komunitetin evropian, pati rëndësi mbarëbotërore për rregullimin juridik për mjaft marrëdhënie që kishin të bënin me institute të ndryshme të së drejtës civile si p.sh: gjëndjen juridike të personave fizik, për zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar, regjimin e pasurisë bashkëshortore, testamentin në të drejtën trashëgimore, si dhe trashëgiminë në përgjithësi; falimentimin e personave juridik dhe

procedurat e falimentimit; sigurimet shoqërore dhe arbitrazhin ndërkombëtar. Në Konventën e 1968 u trajtuan çështje që i kalonin kufijtë e komunitetit evropian të atëhershëm. Ajo rregulloi marrëdhënie që kishin rëndësi të dorës së parë për çdo sistem të së drejtës civile të shteteve jo anëtare si dhe zgjidhjen e konflikteve midis normave juridike të shteteve anëtare. (Craig, De Burga, 2005:54)

Konventa e Brukselit e vitit 1968 mbi “juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e njohur si “Bruksel 1”, përcaktoi rregulla të përgjithshme mbi juridiksionin, njohjen e vendimeve gjyqësore në B.E, ekzekutimin e vendimeve, përcaktoi koncepte të tilla si derogimi i juridiksionit, juridiksioni special, juridiksioni ekskluziv, juridiksioni dual etj. Me miratimin e kësaj Konvente u zëvendësuan dhe pushoi fuqia juridike e të gjitha konventave që ishin lidhur më parë me shteteve europiane dhe mbeti në fuqi vetëm Konventa e Brukselit. (Bruksel 1)

Konventa e 1968 që në preambulën e saj përcaktonte qëllim e miratimit të saj, për të zbatuar nenin 220 të traktatit që lidhet me lehtësimin e formaliteteve që rregullojnë njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave, për të forcuar mbrojtjen ligjore të personave që ndodhen në shtete të ndryshme, duke konsideruar që është e nevojshme për këtë qëllim përcaktimi i juridiksionit ndërkombëtarë të gjykatave, për të lehtësuar njohjen dhe për të përcaktuar një procedurë që do të aplikohet për ekzekutimin e gjykimeve në shtetet anëtare, si një instrument autentik.

Kjo konventë, fillimisht u nënshkrua nga Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksenburgu dhe Holanda. Fusha e zbatimit të saj ishin çështjet civile dhe tregtare dhe shtrihej vetëm mbi shtetasit që kishin vendbanim në një shtet anëtar dhe jo mbi shtetasit që nuk ishin rezident në shtetet anëtare. Kjo ishte e përcaktuar si juridiksioni i

përgjithshëm. Konventa përcaktonte që në nenin 2 juridiksionin special sipas të cilit një shtetas mund të ishte i paditur në secilin shtet anëtar përse i përket detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, për dëme kontraktore ose jashtkontraktore, për të punësuarit për çështje që lidhen me detyrimet në punë që rrjedhin nga një kontratë, detyrime që rrjedhin nga kujdestaria, për detyrime që rrjedhin nga shkaktimi i një dëmi civil nga një çështje penale, çështjet e konsumatorit, si dhe çështjet që lidhen me sigurimet. Në nenin 21 të Konventës së Brukselit të 1968, përcaktohet juridiksionin i gjykatës së fillimit sipas të cilit: gjykata e fillimit ka juridiksion, ndërsa të gjykatat e tjera ku është ngritur çështja duhet të pezullojnë gjykimin derisa të përcaktohet juridiksionin i gjykatës së fillimit. Ide që përforcohet dhe nga nenet e tjera, 22, 23, e në vijim. Në këtë kuptim, Konventa e Brukselit i jepte përparësi juridiksionit të gjykatës së fillimit, ndërsa gjykatat e tjera duhet të deklaronin mungesën e juridiksionit. Gjithashtu, Konventa parashikonte rregulla përse i përket masave të përkohshme, si rregullave për sigurimin e padisë. Sipas nenit 24 të Konventës, mund të ngrihet padi për marrjen e masave të përkohshme, si sigurimi i padisë në çdo shtet anëtarë, pavarësisht se ku është ngrit padia për gjykimin e çështjes në themel. Me miratimin e Konventës së Brukselit të vitit 1968, pushoi fuqia juridike e shumë konventave dhe marrëveshjeve bilaterale që ishin në fuqi, të cilat kishin rregulluar deri atëhere marrëdhëniet në fushën e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në çështjet civile dhe tregtare. duke u bërë legjislacioni më i rëndësishëm për kohën që rregullonte marrëdhëniet juridikenë Bashkimit Europian. Konventa e Brukselit qëndroi në fuqi deri në vitin 2000 dhe u shfuqizua me miratimin e rregullores nr.44/2001, e 22 Dhjetorit 2000. “Mbi juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”

### 3.1.2 Konventa e Luganos

Konventa e Luganos ishte një tjetër konventë që rregulloi marrëdhëniet në fushën e juridiksionit dhe në fushën e zbatimit dhe njohjes së vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare. Konventa për juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare nr.88/592/EEC, lidhur në Lugano, më 16 shtator 1988, fletore zyrtare L, 25/11/1988 P. 0009 – 0048, e cila u miratua kronologjikisht pas Konventës së Brukselit, ishte një tjetër konventë që unifikoi marrëdhëniet në fushën civile dhe tregtare. Konventa u miratua duke marrë parasysh vendosjen e rregullave uniforme të përcaktimit të juridiksionit ndërkombëtarë të gjykatave, për të lehtësuar njohjen dhe prezantimin e një procedure uniforme për sigurimin dhe zbatimin e vendimeve, instrumentave autentik dhe vendimeve të gjykatës. Kjo konventë u miratua pas sanksionimit në fushën ekonomike të lirisë së tregut nëpërmjet marrëveshjeve që u lidhën mes Komunitetit Ekonomik Europian dhe shteteve anëtare të shoqatës europiane të tregëtisë së lirë. Duke marrë parasysh Konventën e Brukselit të miratuar në 1968, si dhe amendimet e mëvonshme që u miratuan pas hyrjes në Bashkimit Europian të shteteve të tjera dhe zgjerimit të B.E. Në një vështrim krahasues të kësaj Konvente dhe Konventës së Brukselit, vihet re që nuk ka ndryshim përsa i përket qëllimit dhe përjashtimit nga fusha e veprimit të konventave, që do të thotë edhe Konventa e Luganos rregullonte marrëdhëniet juridike dhe juridiksionin në çështjet civile dhe tregtare. Konventa e Luganos përjashtonte nga fusha e zbatimit arbitrazhin, marrëdhëniet që lindin si pasojë e trashëgimisë ose testamentit, procedurat që lidhen me falimentimin e kompanive dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga falimenti, si dhe sigurimet shoqërore. Konventa e Luganos nuk e shfuqizoi Konventën e Brukselit si dhe

protokollin mbi interpretimin e saj nga Gjykata Europiane e Drejtësisë, nënshkruar në Luksenburg, më 3 qershor 1971, por qënduran në fuqi paralelisht.

### **3.2 Rregullorja e Këshillit Europian nr.44/2001 mbi “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.”**

Rregullorja e Këshillit Europian nr. 44/2001, e 22 Dhjetorit 2000, “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, u nënshkrua duke patur parasysh objektivat e Komunitetit Europian për ruajtjen dhe zhvillimin e një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie, për të lehtësuar lëvizjen e lirë të personave, mallrave dhe e shërbimeve. Në mënyrë që të bëhet progres në këtë fushë, u pa e nevojshme miratimi i masave ligjore që lidhen me bashkëpunimin gjyqësor civil, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, të cilat janë të nevojshme për mirëfunksionimin e tregut të brendshëm.<sup>32</sup> Divergjencat mes legjislationeve të shteteve anëtare që rregullojnë juridiksionin dhe njohjen e vendimeve pengonin veprimin e tregut të brendshëm, për këtë arsye u miratua rregullorja nr. 44/2001. Kjo rregullore kishte si qëllim unifikimin e rregullave të konflikteve juridiksionale në çështjet civile dhe tregtare, me qëllim thjeshtëzimin e formaliteteve në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve mes shteteve anëtare.

Rregullorja bazohej në nenin 5 dhe 65 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian, ku përfshihet pjesa e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare dhe parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit në Bashkimin Europian.

---

<sup>32</sup>[http://eur-lex.europa.eu/legal\\_content](http://eur-lex.europa.eu/legal_content)



Për realizimin e lëvizjes së lirë të vendimeve në fushën civile dhe tregtare, rregullat që përcaktojnë juridiksionin dhe njohjen e vendimeve u rregulluan nga një instrument legal komunitar, i cili ishte i detyrueshëm dhe direkt i aplikueshëm. Rregullorjambulonte të gjitha çështjet kryesore në fushën civile dhe tregtare, përveç çështjeve që nuk përfshiheshin në fushën e saj të zbatimit, pasi konsideroheshin si të mirëpërcaktuara nga instrumente të tjera ligjore që vepronin në Bashkimin Europian.<sup>33</sup>

Kishte një lidhje mes procedurave që aplikonte rregullorja dhe territorit të shteteve anëtare. Rregullat e përgjithshme të juridiksionit, aplikoheshin në rastet kur i padituri kishte vendbanimin në një nga vendet anëtare. Një i paditur që nuk kishte vendbanim në një shtet anëtar ishte subjekt i ligjeve të shtetit, shtetas i të cilit ishte, përsa i përket rregullave të juridiksionit. Me miratimin e kësaj rregulloreje u siguria edhe vazhdimësia me Konventën e Brukselit të 1968, e cila bazuar në vendimet e Gj.E.D qëndroi në fuqi dhe u aplikua edhe në rastet e çështjeve që ishin në proces në kohën kur kjo rregullore hyri në fuqi.

Kjo rregullore nuk zbatohet në rregullat që përcaktonin juridiksionin dhe njohjen e vendimeve, që qëndronin në instrumentat specifik të Komunitetit. Duke analizuar nenet e rregullores, me “instrumenta specifik” kuptojmë ato instrumenta që janë të përjashtuara nga fusha e zbatimit të rregullores, të cilat ishin të përcaktuara në nenin 1 të qëllimi i rregulores 44/2001. Bëhet fjalë për kërkesë paditë apo mjete të tjera ligjore në fuqi sipas legjislacionit të shteteve anëtare që rregullojnë statusin e personave juridik apo fizik, të drejtave të pronësisë që rrjedhin nga marrëdhëniet martesore, trashëgiminë

---

<sup>33</sup>Raporti i Komisionit Europian, marrë nga <https://eur-lex.europa.eu/legal/content>  
Report from the Commission to the European Parliament, the Council and the European Economic and Social Committee on the application of Council Regulation (EC) No 44/2001 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters /\* COM/2009/0174 fina

apo testamentin, falimentimi, procedurat që lidhen me shpalljen isolvabël të kompanive apo personave juridik, siguria publike dhe arbitrazhi. Pra, instrumentat specifike që rregullojnë juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në këto fusha nuk përfshihen në objektin e kësaj rregulloreje. Rregullorja nuk kishte ndikim mbi angazhimet ndërkombëtare që lidhen me çështje specifike në të cilat shtetet anëtare ishin pjesë, ndërsa rregullimet specifike të protokolleve që lidhen me juridiksionin dhe njohjen e vendimeve gjyqësore u inkorporuan dhe u bënë pjesë integrale e saj. Për një tranzicion harmonik të disa zonave të cilat ishin subjekt i rregullimeve speciale në protokollin aneks të Konventës së Brukselit të 1968, kjo rregullore parashikoi norma të veçanta tranzitoriale që rregulluan marrëdhëniet juridike në disa shtete anëtare.

### **3.2.1 Fusha e zbatimit të Rregullores nr. 44\2001 të Brukselit.**

Fusha e zbatimit të rregullores ishte përcaktimi i Juridiksionit të shteteve anëtare të Bashkimit European, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Përsa i përket juridiksionit, si rregull i përgjithshëm ai përcaktohej nga vendbanimi i personit në një shtet anëtarë, cilado qoftë shtetësia e tij. Personat që nuk ishin shtetas të shtetit anëtarë, por që banonin në B.E ishin nën juridiksionin që zbatohet edhe për shtetasit e këtij shteti. Rregullorja nuk zbatohet për personat që nuk ishin resident në një nga shtetet e Bashkimit European. Përveç rregullit të përgjithshëm për përcaktimin e juridiksionit, rregullorja bënte edhe përjashtime, të cilat i konsideronte juridiksione të veçanta. Kështu, në lidhje me detyrimet që lindin nga kontratat, juridiksionin mbi këto çështje e kishte gjykata e vendit në të cilën duhet të përmbushej detyrimi i kontratës. Në këtë aspekt në rast se palët nuk vendosnin ndryshe, zbatoheshin kushtet e mëposhtme: Për kontratat me objekt dorëzimi i sendeve, juridiksioni i takonte gjykatës së vendit ku duhet të dorëzohen sendet. Kur kontrata ka për objekt kryerjen e shërbimeve,

juridiksioni i takon gjykatës së vendit ku kryhej shërbimi. Në çështjet me objekt gjykimi detyrimet jashtë kontraktore, juridiksioni i gjykatës përcaktohet nga vendi ku ka ndodhur fakti i paligjshëm. Në rast se padia civile për dëmin jashtëkontraktor bazohej mbi një veprim kriminal, juridiksioni përcaktohet nga gjykata që shqyrton çështjen penale, në masën që kjo gjykatë ka juridiksion sipas ligjit të saj për të shqyrtuar padinë civile. Në rastet e gjykimit me objekt veprimtarinë e një dege ose filiali të një kompanie, juridiksioni i takonte gjykatës në vendin e të cilës dega ose filiali ushtronte veprimtarinë e saj. Në rastet e bashkëndërgjyqësisë me shumë të paditur, padia mund të ngrihej në vendbanimin e njërit prej të paditurve, me kusht që paditë e veçanta që mund të ngriheshin të ishin të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që të gjykohen dhe vendosen së bashku. Kjo me qëllim evitimin e çdo rreziku të vendimeve që vijnë në kundërshtim me njëra-tjetrën që mund të rezultojnë nga procese të veçanta. Kundërpadia që rrjedh nga e njëjta kontratë ose i njëjti fakt duhet të ngrihet në të njëjtën gjykatë që është ngritur padia. Kur objekti i mosmarrëveshjes lidhet me të drejta dhe detyrime që burojnë nga pasuria e paluajtshme, në këtë rast juridiksioni i takonte gjykatës së vendit në të cilin pasuria e paluajtshme ndodhej. Në rast se detyrimi buron nga një kontratë sigurimi, juridiksioni i takon gjykatës së vendit në të cilin siguruari ka vendbanimin e tij ose në vendin në të cilin paditësi ka vendbanimin e tij, në rast se padia është ngritur nga i siguruari ose përfituesi në sigurim. (Brati, 2008:73)

Rregullorja parashikonte gjithashtu edhe juridiksione ekskluzive që lidhen me të drejtat mbi pronësinë e paluajtshme ose mbi vlefshmërinë e krijimit, pavlefshmërinë dhe shpërndarjen e shoqërive, si dhe në lidhje me të drejtat që burojnë nga vlefshmëria e patentës, markës dhe stemës, të cilat duhej të regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Në këto raste juridiksioni mbi çështjet e gjykimit që lidhen me këto të drejta

pavarsisht nga vendbanimi i të paditurit i takonte gjykatës, në vendin e të cilës ndodhet pasuria e paluajtshme, ose në vendin në të cilin janë regjistruar këto të drejta tregtare dhe ky ishte një lloj ekskluziv juridiksioni.

Ndërsa në lidhje me sigurimet, kontratat e konsumatorit dhe punësimin, parashikimet në rregullore janë bërë për të mbrojtur palën më të dobët nga rregullat e juridiksionit më të favorshme në interes të tyre sesa rregullat e përgjithshme. Në interes të harmonizimit të administrimit të mirë të drejtësisë në miratimin e rregullores u pa e nevojshme të minimizohej mundësia e procedurave paralele dhe dhënia e dy vendimeve për të njëjtën çështje. Rregullorja 44/2001 parashikoi një mekanizëm të qartë dhe efektiv për zgjidhjen e çështjes së litispendencës dhe çështjeve të lidhura.

Komisioni European hartoi një raport në vitin 2009, i cili përmbante një vëzhgim të plotë mbi mënyrën si është aplikuar rregullorja në praktikë, duke paraqitur propozime për adaptime të mëtejshme. Sipas raportit të Komisionit European, për administrimin e mirë të drejtësisë duhet që vendimet e gjykatave të njihen automatikisht në çdo shtet anëtarë pa qënë nevoja e ndjekjes së procedurave të mëtejshme, si p.sh procedura për ekzekutimin e vendimeve që parashikohej nga rregullorja 44/2001, si e vetmja rrugë ligjore për ekzekutimin e vendimeve në shtetet anëtare. Duke përcaktuar të njëjtat parime, procedura e zbatimit të vendimeve gjyqësore duhet të jetë efiçente dhe e shpejtë. Për sa më sipër deklarata që një vendim është në fuqi duhet të jetë automatike pas kontrollit të dokumentave, duke i dhënë mundësi gjykatës që kryesisht, edhe pa kërkesë të palëve të shqyrtojë nëse vendimi është në fuqi në atë shtet apo jo.<sup>34</sup>

---

<sup>34</sup>Raport nga Komisioni për Parlamentin European, Këshillin dhe Komitetin Ekonomiko Social mbi aplikimin e rregullores 44/2001.

### 3.2.2 Llojet e juridiksionit sipas rregullores 44\2001. Juridiksioni dytësorë.

Në rastet kur i padituri nuk kishte vendbanim apo vendqëndrim në vendet e Bashkimit European, Rregullorja 44/2001 bënte referim te i ashtëquajtur “Juridiksion dytësor”, që në këtë rast është juridiksioni i ushtruar nga gjykatat kombëtare dhe legjislacionit kombëtar, pra të shtetit, shtetas i të cilit është i padituri, me përjashtim të rasteve kur gjykata e shteteve anëtare kishte juridiksion ekskluziv.<sup>35</sup> Zbatimi i Rregullores në planin ndërkombëtar ka qënë objekt i një numri të madh çështjesh të referuara në Gjykatën Europiane të Drejtësisë. Rregulli i përgjithshëm i juridiksionit në rregulloren 1 të Brukselit ndiqte Parimin latin “*actor sequitur forum rei*” sepse e bënte më të lehtë për të paditurin të mbronte vetveten.

Gjykata Europiane e Drejtësisë në rastin *Josi v. UGIC*, ka sqaruar se në rastet kur pala e paditur ka vendbanimin në vendet anëtare të B.E dhe pala paditëse në një shtet të tretë ose jo anëtar i B.E, pala e paditur mbështetet në mbrojtjen e ofruar nga Rregullorja 1 e Brukselit. Kjo për t’i ofruar një mbrojtje më të mirë palës së paditur në rastet kur ka nuk ka vendbanim në vendet e B.E dhe paditetnga shtetas të B.E, duke ndjekur parimin që padia i nënshtrohet ligjit të vendit ku është ngritur padia<sup>36</sup>

Gjykata në një tjetër çështje vendosi që rregullat e juridiksionit, në veçanti rregullat themelore të juridiksionit të gjykatës së vendbanimit të të paditurit janë të natyrës detyruese dhe aplikimit i tyre nuk mund të mënjanohet në favor të ligjit kombëtar. Kjo

---

<sup>35</sup> Neni 22,23 i Rregullores së Këshillit European 44/2001”Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare.

<sup>36</sup> Rasti C 412/98 Vendim 412/98 i Gjykatës Europiane të Drejtësisë, *Josi v. UGIC*.

jo vetëm në rastet mes vendeve anëtare, por dhe në çështjet që kanë lidhje me shtete jo anëtare të Bashkimit European dhe nuk kanë pikë takimi me shtetet anëtare.<sup>37</sup>

Gjyktata Europiane e Drejtësisë sugjeron që rregullat e juridiksionit në lidhje me shtetet e treta, pra jashtë B.E, të aplikohen në rastet ku i padituri ka vendbanim në vendet e Bashkimit European në rastet kur padia është ngritur jo në një shtet anëtar të Bashkimit European, bazuar në juridiksionin ekskluziv, të parashtruar si nga Rregullorja dhe nga Konventa e Brukselit e 1968.<sup>38</sup> Mungesa e normave të harmonizuara mbi juridiksionin dytësor shkaktonte një akses të pabarabartë në drejtësi për qytetarët e komunitetit european, duke shkelur të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për t'u mbrojtur përpara gjykatave të shteteve të treta. Sipas rregullores 44/2001 në gjykatat e shteteve anëtare nuk mund të ngrihej padi kundër të paditurve që nuk kanë vendbanimin në vendet e B.E, por në shtete të treta.

Sipas raportit të Komunitetit European juridiksioni dytësor i rregullores 44/2001 tregonte mungesën e normave të harmonizuara që përcaktojnë rastet kur gjykatat e shteteve anëtare shpallin mungesën e juridiksionit dhe kalimin e tij në favor të gjykatave të shtetve të treta, gjë që sillte konfuzion dhe pasiguri për palët pjesëmarrëse në proces. Mungesa e rregullave të përbashkëta mbi efektin e vendimeve të gjykatave të shteteve jo anëtare mund të çojnë në situata ku keto vendime njihen dhe kanë fuqi juridike edhe në vendet e B.E – së edhe kur ligji i komunitetit në këto raste pajis me juridiksion ekskluziv gjykatat e shteteve anëtare dhe jo ato të vendeve të treta.<sup>39</sup>

---

<sup>37</sup> Rasti C-281/02 ( Owusu ) i Gjykatës Europiane të Drejtësisë <http://curia.europa.eu/juris/>

<sup>38</sup> Opinion 1/03 i Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

<sup>39</sup> Raport nga Komisioni për Parlamentin European, Këshillin dhe Komitetin Ekonomiko Social mbi aplikimin e rregullores 44/2001

Në përgjithësi Rregullorja 44\2001e Brukselit është konsideruar një instrument i suksesshëm ligjor, i cili ka lehtësuar qarkullimin e vendimeve të gjykatave mes shteteve anëtare, përmes një sistemi eficient të bashkëpunimit gjyqësor, i bazuar mbi rregulla krahasimore juridiksionale, koordinim të procedurave gjyqësore për shmangien e procedurave paralele. Sistemi i bashkëpunimit gjyqësor i parashtruar në rregulloren 44/2001 u adaptua në mënyrë të suksesshme me ndryshimin e ambientit institucional, nga bashkëpunimi ndërqeveritar në një instrument për t'u integruar në B.E, si dhe në një instrument për sfidat e kohës në të cilën veproji. Si e tillë është vlerësuar shumë mes praktikantëve të ligjit, juristëve, avokatëve, studiuesve, si një instrument praktik dhe si një zgjidhje për çështjet ku të paditurit dhe paditësit janë të nacionaliteteve të ndryshme, apo kur vendi i ngritjes së padisë ndyshon nga shteti i palëve. Rregullorja e Brukselit nr.44\2001 dt.22.12.2000, “Mbi juridiksionit,Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, solli ndryshime thelbësore në konceptin e juridiksionit në krahasim me Konventën e vitit 1968, por i qëndroi parimit themelor, që do të aplikohet në rastet e një mosmarrveshjeje me karakter ndër komunitar.

### **3.2.3 Juridiksioni i veçantë dhe zbatimi i tij për kontratat e konsumatorit, të sigurimeve dhe të punës sipas rregullores 44\2001.**

Rregullorja parashikonte konceptin e juridiksionit të veçantë për tre lloj kontratash, kontratat e konsumatorit, të sigurimeve dhe kontratat e punës, për të mbrojtur “palën më të dobët”, konsumatorët, të siguruarit dhe punëmarrësit.

Rregullorja parashikonte shprehimisht dhe me detaje juridiksionet e veçanta për çdo çështje që përfshihej në objektin e saj. Sipas rregullores 44/2001 për çështje që lidhen me kontrata dhe detyrime, mund të ngrihej padi në gjykatat ku do të ekzekutohej

detyrimi i marrë përsipër në kontratë. Kur behej fjalë për kontratën e shitjes, në vendin ku sipas kontratës malli duhet të dorëzohej; në rastin e shërbimit, kërkesë padia mund të ngrihej atë vend anëtar ku sipas kontratës, duhej të kryhej shërbimi. Në rastet e shkaktimit të dëmit kontraktor ose jashtë kontraktor, mund të ngrihej në gjykatën e atij shteti anëtar ku është shkaktuar dëmi. Përsa i përket një pretendimi civil për shkaktimin e një dëmi që lidhet me procedura penale, padia mund të ngrihej në të njëjtën gjykatë ku është duke u gjykuar çështja penale. Në nenin 6 të rregullores parashikohej se çfarë ndodh kur të paditur janë disa persona që kanë vendbanimin në shtete të ndryshme të B.E, në këto raste mund të ngrihej padia në njërin nga shtetet ku një nga personat kanë vendbanimin. Nga analiza e neneve të Rregullores 44/2001 vihet re që kishte si parim kryesor aplikimin e saj vetëm mbi shtetasit që kanë vendbanim ose vendqëndrim në një nga shtetet anëtare të Bashkimit European, në ndryshim nga rregullorja e re e Brukselit nr. 1215/2012 e cila ka shtrirje më të gjerë, duke u aplikuar edhe mbi personat fizik apo juridik që nuk janë rezidentë në një nga vendet e B.E.

Gjithashtu, në konceptin e juridiksionit të veçantë, rregullorja përfshinte dhe juridiksionin e kontratave të konsumatorit. Në seksionin 4 të saj parashikohej se në çështjet që lidhen me kontratat e konsumatorit, për shitjen e mallrave ose shërbimeve që lidhen me subjekte që ndodhen në një nga vendet anëtare, gjykatat e B.E kishin juridiksion dhe mund të ngrihej padia në gjykatat e atij shteti anëtar ku konsumatori kishte vendbanimin ose vendqëndrimin ose në shtetin anëtar ku ndodhej selia e subjektit tregtar. Kjo lihej në zgjedhje të palës paditëse. Ndërsa në rast se konsumatori lidhte një kontratë shitje malli ose shërbimi me një subjekt, i cili nuk kishte vendbanim ose vendqëndrim në B.E, por kishte një degë ose filial të hapur në një nga vendet e B.E,



kërkesë padia nga ana e konsumatorit mund të ngrihej në shtetin anëtar në të cilin subjekti kishte filialin, agjensinë ose çdo lloj organizimi tjetër juridik tregtar.

Ndryshe ishin parashikimet në rastet kur i paditur ishte konsumatori. Që gjykatat europiane të kishin juridiksion, kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm (*sine qua con*) ishte që konsumatori të kishte vendbanim ose vendqëndrim në një nga shtetet anëtare. Në këtë rast kërkesë padia ngrihej në shtetin ku kishte rezidencën konsumatori.

Sipas rregullores palët kishin liri të plotë për derogimin e juridiksionit në një shtet anëtar me anë të një marrëveshjes tyre. Marrëveshja në këtë rast ka disa specifika të ndryshme nga marrëveshja e zakonshme e juridiksionit e lidhur mes dy palëve. Kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm për këtë lloj marrëveshjeje ishte që duhet të kishte hyrë në fuqi pasi mosmarrëveshja kishte lindur, ose të lejojë konsumatorin të ngrejë çështjen në një tjetër gjykatë, përveç atyre që parashikonte rregullorja. Konsumatori dhe pala tjetër e kontratës, në rastet kur ishin rezidentë në të njëjtin shtet anëtarë, mund të lidhin një marrëveshje me anë të së cilës transferojnë juridiksionin në një tjetër shtet anëtar. Kjo marrëveshje e transferimit të juridiksionit është e vlefshme për sa kohë nuk është në kundërshtim me ligjin e atij shteti anëtar, në të cilin palët transferojnë juridiksionin.

#### **3.2.4 Juridiksioni i veçantë dhe zbatimi i tij në kontratat e punës.**

Një tjetër juridiksioni i veçantë që parashikonte rregullorja ishte juridiksioni mbi kontratat individuale të punësimit, tëparashikuara në seksionin 5 të Rregullores të Këshillit European 44/2001. Për rastet kur kontrata individuale e punësimit lidhej me punëdhënës që nuk kishin vendbanimin në një nga shtetet anëtarë, por kishin një filial ose degë në një nga vendet anëtare, juridiksioni gjyqësor i përkiste ai shteti anëtar ku

ndodhej filiali, agjensia, ose dega e kompanisë. Në rastet e tjera, një punëdhënës mund të paditej në gjykatat e vendeve anëtare ku ndodhej selia qendore ose në një tjetër shtet anëtar ku punëdhënësi kishte vendin e punës. Në rastet ku nuk është e përcaktuar vendi se ku punëdhënësi kryente punën e tij, në shtetin ku kryehej puna. Ndërsa punëdhënësi mund të padiste punëmarrësin vetëm në shtetin ku punëmarrësi ka vendbanimin ose vendqëndrimin. Ky parashikim i rregullores bëhej për t'i dhënë mundësi punëmarrësit që të mbronte interesat legjitim si shtresë më e dobët dhe delikate në krahasim me pozicionin e punëdhënësit, si një mbrojtje e veçantë që i behëj shtresës së punëmarrësve dhe konsumatorëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore. Si në rastin e kontratave të konsumatorit dhe në kontratat individuale të punësimit, punëmarrësi mund të transferonte juridiksionin me anë të një marrëveshje të lidhur me punëdhënësin, duke respektuar kushtin që marrëveshja të ishte lidhur pasi të ketë lindur mosmarrëveshja mes palëve, duke lejuar kështu marrëveshjen e palëve për të transferuar çështjen në atë gjykatë që i duket më e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjen që ka lindur. Pra në këtë rast që të kemi një marrëveshje të vlefshme duhet që kjo marrëveshje mes palëve të jetë lidhur pas lindjes së konfliktit, në mënyrë që të mbrohen më mirë interesat e punëmarrësve dhe t'i jepet mundësia e parashikimit të zgjidhjes nga ana e gjykatës kompetente. Nga analiza e neneve të rregullores shohim që ende nuk ishte lejuar kërkesë padia në një shtet anëtar, ku të paditur të ishin subjekte tregtare, kompani apo punëdhënës të cilët nuk kishin seli apo degë në një nga vendet e B.E. – së.

### **3.2.5 Juridiksioni ekskluziv sipas Rregullores 44\2001**

Përveç juridiksionit të veçantë dhe juridiksionit dytësor, rregullorja parashikonte dhe juridiksionin ekskluziv për disa çështje si p.sh: në rastet e pasurive të paluajtshme,

personave juridik dhe çështjet që lidhen me to; çështje të regjistrimit në regjistrat publik, pra përsa i përket dokumentave zyrtare; çështjeve që lidhen me markat, patentat dhe për çështjet që lidhen me zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Rregulli i përgjithshëm i përcaktimit të juridiksionit sipas rregullores ishte vendbanimi i të paditurit. Por në rastet e çështjeve që lidhen me pasuritë e paluajtshme, juridiksion ekskluziv kishte gjykata ku ndodhej sendi i paluajtshëm, pavarësisht vendbanimit të palës paditëse ose të paditur. Për çështjet e vlefshmërisë, personalitetit juridik të personave juridik ose në lidhje me vlefshmërinë e vendimeve të organeve të tyre, bazuar dhe në rregullat e të drejtës ndërkombëtare private, juridiksion ekskluziv kishte gjykata e shtetit ku ndodhej selia e personit juridik. Për sa i përket procedurave qëkishin për objekt vlefshmërisë e dokumentimit në regjistrat publik, juridiksion ekskluziv kishin gjytatat e shtetit anëtar, në të cilin ndodheshin regjistrat publik. Për sa i përket procedurave për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave në vendet e tjera, juridiksion ekskluziv kishte shteti anëtar ku kishte dalë vendimi i gjykatës. Ishte pikërisht gjykata që nxjerr vendimin, e cila lëshonte dhe deklaratën e ekzekutimit të vendimit, pa të cilën vendimi gjyqësor nuk mund të ekzekutohej në një tjetër shtet anëtar. Deklarata e ekzekutimit të vendimit gjyqësor u hoq me miratimin e rregullores së re të Brukselit nr.1215/2012. Që një vendim të ekzekutohet në një tjetër shtet anëtar nuk është më e nevojshme që gjykata të nxjerr deklaratën e ekzekutimit, por bëhet automatikisht, sipas parimit të qarkullimit të lirë të vendimeve gjyqësore brenda Bashkimit European, duke dorëzuar pranë gjykatës së shtetit ku do të bëhet ekzekutimi një kopje të vendimit gjyqësor dhe një certifikatë standarte të nxjerrë nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Rregullorja nr.44/2001 me paraardhësen e saj Konventën e Brukselit konsiderohej si një nga pjesët e legjislacionit me të suksesshëm të Bashkimit Europian, pasi përcaktoi bazat për një hapësirë Europiane ligjore në këtë fushë. Promovoi sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e vendimeve duke vendosur rregulla uniforme dhe u plotësua nga një numër i konsiderueshëm çështjesh të Gj.E.D dhe të gjykatave të shteteve anëtare. Është vlerësuar si një instrument shumë i rëndësishëm për të shmangur procedurat paralele dhe si një referencë për instrumenta të tjera.

Rregullorja e Këshillit Europian nr.44/2001 krijoi formën dhe strukturën e duhur të bashkëpunimit juridiksional në fushën civile dhe tregtare. Përcaktoi rregulla uniforme që zgjidhin konfliktet juridiksionale qofshin ato konfliktet juridiksionale pozitive apo konflikt juridiksional negativ, për lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore.

### **3.2.6 Pranimi dhe mohimi i juridiksionit sipas Rregullores 44/2001**

Pranimi ose mohimi i juridiksionit konsideroht një çështje mjaft delikate dhe një sfidë, sepse sisteme të ndryshme të së drejtës mbajnë qëndrime të ndryshme në lidhje me pranimin ose refuzimin e juridiksionit. Arsyeja pse gjykatat vendosin të pranojnë apo refuzojnë juridiksionin mbi një çështje të caktuar varet nga rrethanat e veçanta të çështjes.<sup>40</sup> Arsyet e pranimit ose të mohimit të juridiksionit janë të ndryshme. Ato mund të jenë rrjedhojë e konfliktit pozitiv apo negativ të juridiksionit mbi një çështje të caktuar, e cila lidhet me vendodhjen e sendit të paluajtshëm, ekzekutimin e një vendimi ose mundësinë e ekzekutimit në një shtet të caktuar, përpjekja për të shmangur mbivendosjen e kompetencave mes gjykatave të shteteve të ndryshme anëtare etj.

---

<sup>40</sup><http://www.otto-schmidt.de/brussels-regulation-commentary.html>

Rregullorja nr.44/2001parashikonte rregulla që ndihmonin në minimizimin e sa më shumë të jetë e mundur të konflikteve juridiksionale. Këto konflikte mund të ndodhnin sepse shtetet kanë rregullat e tyre për përcaktimin e gjykatës kompetente, por gjithashtu sepse shtetet janë palë e dy sistemeve thellësisht të ndryshme, si common law dhe civil law, të dyja pjesë e Bashkimit Europian.<sup>41</sup> Parimi i përgjithshëm i kësaj rregulloreje ishte se gjykata kompetente për zgjidhjen e çështjes është gjykata që konsiderohet më e përshtatshme për zgjidhjen e saj. Ky parim sjell refuzimin e gjykatës që ka filluar gjykimin në favor të gjykatës më të përshtatshme. Ky është një parashikim i ndryshëm me sistemin civil law, i cili nuk merr parasysh këtë parim që është i bazuar në rrënjët e sistemit common law. (Mandro,Walker, Kalia,2005:139) Qëllimi i parimit është i ndryshëm me atë që ekziston në themelin e Rregullores 1 të Brukselit. Bazuar në këtë parim kjo rregullore mundohet të gjej një mënyrë alternative të parashikimit të parimit të litispendencës, duke i dhënë prioritet gjytës ku është filluar së pari çështja. Gjithashtu, parshikohej që këto parime do të zbatoheshin vetëm në rastet e personave resident në B.E dhe shmangnin proceset paralele për çështje të njëjta.

Juridiksioni që përcaktohej nga palët bazuar në rregulloren 44/2001 të Brukselit kishte një sërë kufizimesh për arsye të ndryshme. Përcaktimi i juridiksionit mund të bëhej si një klauzolë e kontratës mes palëve ose si një kontratë më vete. Mund të lidhej para lindjes së mosmarrëveshjes ose pas lindjes së mosmarrëveshjes mes palëve. Zakonisht, dhënia e aprovimit për përcaktimin e juridiksionit të gjykatës varej nga cilësia e palëve, nëse kishin marrëdhënie biznesi, ishin konsumatorë apo marrëdhënie punësimi etj. Pranimi mund të jepej me heshtje pranuese për zgjedhjen e gjykatës, ose mund të jetë në formën e një klauzole të parashikuar në kontratë, ose nëpërmjet një marrëveshjeje mes

---

<sup>41</sup>Case C-125/92 [1993] ECR I-4075, Muloxvs.Geels

palëve në një marrëdhënie kontraktore.(Mandro,Walker,Kadia,2005:113). Mënyra se si bëhej për zgjedhja e gjykatës nuk ishte në liri absolute, por definohej nga vet rregullorja dhe bëhej për të mbrojtur palën më të dobët. P.sh në rastet e kontratave individuale të punësimit, parashikohej një mbrojtje e veçantë për punëmarrësin. Si në rastin e kontratave të konsumatorit dhe në kontratat individuale të punësimit, punëmarrësi mund të transferonte juridiksionin me anë të një marrëveshje të lidhur me punëdhënësin, duke respektuar kushtin që marrëveshja e juridiksionit të jetë lidhur pasi të ketë lindur mosmarrëveshja mes palëve, duke lejuar kështu marrëveshjen e palëve për të transferuar çështjen në gjykatën e zgjedhur me marrëveshje. Pra në këtë rast që marrëveshja të ishte e vlefshme duhej që kjo marrëveshje mes palëve të ishte lidhur pas lindjes së konfliktit, në mënyrë që të mbrohen më mirë intereset e punëmarrësve dhe t'i jepej mundësia e parashikimit të zgjidhjes nga ana e gjykatës kompetente. Nga ana tjetër, duket sikur ky nen bente një ndalim absolut, duke bërë të pavlefshme çdo marrëveshje që është lidhur para lindjes së konfliktit. Për ta përforcuar këtë sanksionim, në paragrafin e dytë të nenit 21, parashikohej se klauzola e juridiksionit që është përcaktuar para se mosmarrëveshja të ketë filluar është e pavlefshme. Rregullorja 1 e Brukselit aplikohet vetëm në mosmarrëveshje ku pala e paditur ishte resident në B.E, pa qënë e rëndësishme vendbanimi i palës paditëse. Në rastet kur të paditur ishin persona fizik apo juridik pa vendbanim apo vendqëndrim në shtetet e B.E. –së, gjykatat europiane refuzonin juridiksionin mbi çështjen. Dallohej ndryshimi në trajtimin përpara gjykatave europiane të personave që ishin rezidentë në një nga shtetet anëtare me të huajt.(Mandro,Walker,Kadia,2005:96).Në rastet kur disa padi janë ngritur kundër disa

të padiëturve, është e pamundur që procesi të realizohet në një gjykatë të një shteti anëtarë, kur të paditurit kanë shtetësi të ndryshme.<sup>42</sup> Situata vështirësohet kur këto padi ngriheshin në shtete tëndryshme dhe bazuar në nenin 28 pika 2 të Rregullores gjykata e dytë duhej të refuzonte juridiksionin, në favor të gjykatës ku ishte ngritur së pari çështja. Por kjo mund të çonte në një konflikt negativ juridiksioni nëse dhe gjykata ku është ngritur së pari çështja nuk pranonte juridiksionin mbi të.

### **3.3 Rregullorja e Këshillit European nr. 1215/2012, mbi “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e njohur si Rregullorja 1 bis e Brukselit.**

Kuadri ligjor më i ri që rregullon marrëdhëniet në fushën civile dhe tregtare, për sa i përket juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit të marrëdhënieve juridike është Rregullorja e Këshillit European nr. 1215/2012 e 12 Dhjetorit 2012, mbi “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e ndryshuar. e njohur ndryshe si Konventa 1bis e Brukselit, e cila hyri në fuqi më datë 10 Janar 2015.

Rregullorja bazohet nënenin 67(4), pika (a), (c), dhe (e), nenin 81 (2), të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit European, u propozua nga Komisioni European, pas miratimit të draftit legjislativ në parlament, duke marrë parasysh opinionin e Komitetit European Ekonomik e Social, në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative të miratimit të akteve. Pas raportit të 21 Prillit 2009 të Komisionit European mbi aplikimin e rregullores nr.44/2001, të 22 Dhjetorit 2000, mbi “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, u konkludua se në përgjithësi

---

<sup>42</sup>Neni 6/1 lejonte paditë me shumë palë vetëm në rastet kundër disa të paditurve

aplikimi në praktik i rregullores 44/2001 ishte i kënaqshëm, por duhet të ndryshoheshin neneve të caktuara, për të përmirësuar qarkullimin e lirë të gjykimeve në çështjet civile dhe tregtare. Duhesh bërë një sërë amendimesh mbi rregulloren me qëllim qartësimin e normave të saj.<sup>43</sup> Përveç raportit të Këshillit European, rol kryesor në hartimin e rregullores 1215/2012 luajti gjithashtu, programi me titull “Programi i Stokholmit”, i cili u krijua në mbledhjen e Brukselit më datë 10 dhe 11 Dhjetor 2009. Ky program vuri theksin te një Europë e hapur dhe e sigurtë. Në programin e Stokholmit, Këshilli European konsideronte që heqja e procedurës së njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja ishte thelbësore, por duhej të shoqërohej nga një sërë masash mbrojtëse për aplikimin në praktikë të tyre.

Diferencat mes rregullave të brendshme që rregullojnë juridiksionin dhe njohjene vendimeve u panë si faktorë që dëmtojnë veprimin e tregut të brendshëm. Gjithashtu, u pa e nevojshme parashikimi i normave që unifikojnë rregullat e konflikteve juridiksionale në çështjet civile dhe tregtare dhe që sigurojnë njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave të shteteve anëtare në mënyrë të shpejtë.

Bashkimi European me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, për lehtësimin e aksesit në drejtësi, veçanërisht përmes parimit të njohjes reciproke të vendimeve në çështjet civile dhe tregtaremiratoi Rregulloren 1bis të Brukselit si një instrument ligjor i Bashkimit European i detyrueshëm dhe i aplikueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendet anëtare. Rregullorja lehtëson bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile e tregtare, i shërben parimit të besimit reciprok, forcon bashkëpunimin mes shtetet ndërkufitare emirë funksionimine tregut të përbashkët european.

---

<sup>43</sup> Raporti i Komisionit European i dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.



Rregullorja 1bis e Brukselit konsiderohet si guri i themelit në ligjin European të procedurës ndërkombëtare civile. Kjo mund të konstatohet lehtësisht nga çdo praktikues i së drejtës që përballlet në punën e tij me çështje civile dhe tregtare ndër kufitare në Europë.<sup>44</sup>

I ashtëquajhuri “Regjimi i Brukselit” ka provuar vlerat e jashtëzakonshme që ka për 50 vite që ka rregulluar çështjet e juridiksonit, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve në fushën civile dhe tregtare në Europë. Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe gjykatat anëtare të Bashkimit European kanë prodhuar një sërëvendimesh, si një thesar të çmuar në punën e praktikuesve të së drejtës, duke interpretuar Konventën e Brukselit, Rregulloren e parë të Brukselit, si dhe Rregullores 1bis të Brukselit.

Rregullorja 1bis e Brukselit është e strukturuar mbi të njëjtat parime dhe linja si rregullorja nr.44/2001 e Brukselit, kjo nuk do të thotë që nuk ka sjellë ndryshime. Përkundrazi, një pohim i tillëdo të ishte i pavërtetë. Ndryshimet që solli rregullorja u panë si evolucion në fushën e së drejtës ndërkombëtare.<sup>45</sup>

Rregullorja 1bis e Brukselit nr.1215/2012 është akti juridik european më i rëndësishëm që rregullon marrëdhëniet në fushën e përcaktimit të juridiksionit mes vendeve anëtare të Bashkimit European, si dhe përcakton rregulla për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave europiane në vendet anëtare. Kjo rregullore ka sjellë ndryshime thelbësore në konceptin e juridiksionit dhe njohjes së vendimeve të gjykatave europiane, si dhe çështjes së litispendencës, duke e zgjeruar rrethin e subjekteve që mund të jenë paditës dhe të paditur para gjykatave europiane. Njohja e kësaj rregulloreje mer një rëndësi të

---

<sup>44</sup> <http://www.otto-schmidt.de/brussels-ibis-regulation-commentary.html>

<sup>45</sup> Lukas Dyrda, Jurisdiction in civil and commercial matters in the regulation 1215/2012 between common grounds of jurisdiction and divergent national rules.

veçantë, duke marrë parasysh që Shqipëria ka marrë statusin e vendit kandidat në Bashkimin European, dhe me miratimin e reformës në drejtësi nga parlamenti shqiptar, një konsensus historik për drejtësin, Republika e Shqipërisë është në pritje të hapjes së negociatave me Bashkimin European. Pavarësisht se Rregullorja 1bis e Brukselit ende nuk ka fuqi detyruese për vendin tonë, studimi dhe njohja e saj na shërbën si studiues të së drejtës për të vënë në dukje ndryshimet themelore që ka me legjislacionin shqiptar dhe për të përafruar legjislacionin shqiptar me aktet ndërkombëtare, duke synuar krijimin e një kornizë ligjore sa më bashkëkohore dhe të përshtatur me ekonominë dhe lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, në mënyrë të tillë që t'i paraprijë integritetit të Shqipërisë në B.E, forcimit të parimit të sigurisë juridike dhe shtimit të investimeve të huaja.

### **3.3.1 Veçoritë e Rregullores 1bis të Brukselit, si burim i së drejtës në Bashkimin European.**

Aktet juridike europiane ndahen në dy kategori: në akte të detyrueshme dhe akte jo të detyrueshme. Aktet e detyrueshme dytësore dhe më të rëndësishme të Bashkimit European janë: rregulloret, direktivat dhe vendimet. Në rendin juridik të Komunitetit, këtyre akteve detyruese u bashkohen dhe akte të tjera, që nuk janë detyruese për destinatarët e tyre: bëhet fjalë për rekomandimet dhe opinionet. (Canaj, Bana: 2011, 86)

Rregullorja 1bis e Brukselit bën pjesë në aket e detyrueshme dytësore të Bashkimit European, është e detyrueshme në të gjitha elementët e saj dhe zbatohet drejtëpërdrejtë në të gjitha vendet e B.E. Ka rolin e ligjit në të drejtën shtetërore, pra është akt i përgjithshëm juridik. Normat e saj kanë për qëllim disiplinimin e të gjithë lëndës dhe duhet zbatuar në tërësi nga destinatarët e saj, në fushën e zbatimit. Asnjë prej vendeve

anëtare nuk mund të zbatoj në mënyrë selektive Rregulloren e Brukselit, ashtu si asnjë rregullore tjetër. Shtetet anëtare janë të detyruara ta zbatojnë në tërësi dhe jo në mënyrë selektive me qëllim paralizimin e atyre pjesëve të rregullores që konsiderohet si në kundërshtim me aktet kombëtare. Rregullorja 1 bis e Brukselit është e detyrueshme në tërësinë e saj për institucionet, për të gjitha shtetet anëtare dhe për individët. Ajo aplikohet në të gjitha situatat që hyjnë në fushën e saj të aplikimit. Sipas Gj.E.D vështirësitë në aplikimin e një rregulloreje të B.E –së nuk mund ti lejojnë një shteti anëtarë që të mos e zbatojë atë.<sup>46</sup> Çdo marrëveshje apo akt ligjor në kundërshtim me këtë është i pavlefshëm. Megjithatë, rregullorja u lë vend masave për ekzekutim si në planin komunitar, ashtu dhe në atë kombëtar.

Këto masa ekzekutimi mund të nxirren si nga vet institucioni që e ka nxjerr rregulloren, në këtë rast Këshilli European, ashtu dhe nga një institucion tjetër komunitar p.sh Komisioni, ashtu edhe nga autoritetet kombëtare.

Rregullorja e Brukselit ka zbatueshmëri të drejtëpërdrejtë në vendet anëtare. Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë është veçoria më “origjinale” e rregulloreve komunitare, që do të thotë që kjo rregullore prodhon efekte juridike në shtetet anëtare pa qënë nevoja që vendi të cilit drejtohet të nxjerr një akt pranimi ose përshtatje me rendin e tij, (të ashtëquajturat norma self – executing). (Canaj,Bana:2011:155). Kjo veçori i bën këto norma të vetzbatueshme në shtetet anëtare të Bashkimit European.

Sipas juridprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë rregulloret nuk duhet të jetë objekt i asnjë mase traspozimi dhe bëhet e detyrueshme që nga momenti i hyrjes së saj në fuqi në rendet juridike kombëtare. Madje çdo formë transpozimi është e ndaluar,

---

<sup>46</sup>C39/72,rec 101 Commission C Italie.

sepse do të hidhte dyshime për origjinën e detyrimeve që përmban rregullorja dhe datën e hyrjes së tyre në fuqi.(Jacque:2010,396)

Në nenin 288 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit European thuhet se rregulloret duhet të jenë “të zbatueshme drejtëpërsëdrejti”. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë aplikimi i drejtëpërdrejtëi rregullores nënkupton që hyrja në fuqi dhe zbatimi i saj është i pavarur nga çfarëdo mase e së drejtës kombëtare. Shtetet anëtare janë të detyruara të mos pengojnë zbatimin e saj dhe rregullave të tjera të së drejtës së Bashkimit Europiansi dhe të mos marrin asnjë masë që mund të ndikojnë në juridiksionin e kësaj gjykate.<sup>47</sup> Shtetet anëtare duhet t’i përmbahen dhe ta zbatojnë rregulloren duke e inkorporuar si pjesë të legjislacionit të brendshëm pozitiv të shtetit, ndërsa në rast të shkeljes së rregullores prej ndonjë shteti të caktuar, Gjykata Europiane e Drejtësisë përmes vendimit gjyqësor e detyron shtetin në fjalë ta zbatojë drejtëpërdrejtë në territorin e vet, pa marrë masa të tjera paraprake administrative. Në rastin *Variola kundër Ministrisë së Financave të Italisë*, Gjykata Europiane e Drejtësisë deklaroi se dispozitat e rregulloreve mund të inkorporohen në rendin juridik të shteteve anëtare pa qënë nevoja për marrjen e ndonjë mase nga shteti apo pa ndërmjetësinë e legjislacionit kombëtarë të shtetit.

Megjithatë, termi “të zbatueshme drejtëpërsëdrejti” ka dhe një kuptim tjetër, që lidhet me mënyrën në të cilën normat ndërkombëtare hyjnë në sistemet ligjore kombëtare. Në disa shtete anëtare, kryesisht në ato që kanë një pikpamje dualiste mbi marrëdhëniet midis të drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare, kjo duhet bërë ose nga sistemi kombëtar,

---

<sup>47</sup> Rasti 34/73, *Variola kundër Ministrisë së Financave të Italisë*

që e transformon masën brenda së dretjës kombëtare ose nga një akt kombëtar më i shkurtër, që miraton aktin përkatës ndërkombëtar.

Veçoria e zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë të rregullores së Brukselit sjell një sërë detyrimesh që vendet anëtare duhet t'i ndjekin në mënyrë të përpiktë. Një nga këto detyrime është që me hyrjen në fuqi të rregullores pas botimit në fletoren zyrtare të Bashkimit Europian, çdo akt apo masë legislative edhe e mëparshme që nuk përputhet me rregulloren nuk mund të zbatohet.

Një tjetër karakteristikë e rregullores është që ka fuqi veprimi të përgjithshme, nuk u drejtohet subjekteve të paracaktuara dhe as të indentifikueshme, por u drejtohet kategorive të konsideruara në mënyrë abstrakte, të përgjithshme në tërësinë e tyre. Rregullorja në Bashkimin Europian ka rolin që ka ligji në të drejtën shtetërore, pra është akt i përgjithshëm juridik. (Reka,2000:53)

Në mënyrë të përmblendhur mund të themi që karakteristikat e Rregullores së Brukselit janë: fuqia e përgjithshme e veprimit; karakteri detyrues; zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e saj. Fuqia e përgjithshme nënkupton që i drejtohet një numëri të papërcaktuar subjektesh dhe është abstrakte, qëndron mbi faktin konkret dhe mund të zbatohet për çdo rast që hyn në parashikimin e vet. Rregullorja 1bis e Brukselit ka karakter detyrues në të gjitha elementët e saj dhe ka zbatim të drejtpërdrejtë në të gjitha shtetet anëtare, në mënyrë automatike, pa qënë nevoja ndërhyrja normative e pushtetit të shteteve përmes akteve ligjore. Ajo jep të drejta dhe imponon detyrime për shtetet anëtare, për organet e tyre dhe për të gjitha subjektet që veprojnë në shtetet anëtare, subjekte fizike apo juridike publike e private.

### **3.3.2 Juridiksioni i përgjithshëm në vendet e Bashkimit European sipas Rregullores së Këshillit European nr. 1215/2012, “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.**

Rregullorja nr.1215/2012 e Brukselit u miratua mbi strukturën e rregullores 44/2001, mbi të njëjtat linja dhe parime, por solli ndryshime esenciale të cilat u panë si evolucion nga praktikuesit e së drejtës.<sup>48</sup> Kjo rregullore e re solli një sërë ndryshimesh substanciale në krahasim me gjithë historikun e rregullimit të marrëdhënieve juridike në fushën e juridiksionit. Solli ndryshime për sa i përket juridiksionit ndërkombëtar, gjyqëvarësisë, fakteve lidhëse, fushës së zbatimit, duke e zgjeruar atë për rrethin e subjekteve që i drejtohet, pasi përfshiu jo vetëm personat rezident në B.E, por edhe personat fizik e juridik që nuk janë rezidentë në B.E. Gjithashtu, ndryshime thelbësore pati dhe për sa i përket çështjes së njohur në termin juridik si procedura “*exequatur*”, heqja e procedurës për njohjen e vendimeve gjyqësore, duke sjellë ndryshime për procedurën e njohjes së vendimeve gjyqësore të shteteve anëtare në shtetet e tjera.

Duke marrë parasysh zhvillimet dinamike brenda B.E, për qarkullimin e lirë të vendimeve të gjykatave, për ndikimin që kanë në qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve, duke qënë se rregullon marrëdhëniet në fushën civile dhe tregtare, duke marrë parasysh dhe sugjerimet për ndryshime respektive ligjore, u pa e nevojshme krijimi i një rregulloreje të re të reformatuar për rregullimin e marrëdhënieve në fushën e juridiksionit ndërkombëtar, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Kjo solli krijimin e Rregullores 1 bis të Brukselit, e cila solli shfuqizimin e akteve ligjore të mëparshme që rregullonin marrëdhëniet në këtë fushë.

---

<sup>48</sup> Lukasz Dyrda, Jurisdiction in civil and commercial matters under the regulation 1215/2012, between common ground of jurisdiction and divergent national rules.

Qëllimi i rregullores së re është të krijojë një funksionim më të mirë të aspekteve ligjore për sa i përket çështjes së juridiksionit ndërkombëtar, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve, litispendencës etj. Që në preambulën e saj përcaktohet fusha e zbatimit, duke parashikuar që aplikohet në çështje civile dhe tregtare pavarësisht llojit të gjykatës që jep vendimin. Nuk aplikohet në çështjet administrative, të doganave, të ardhurave apo të detyrimeve të shtetit për të nxjerr akte në ushtrim të autoritetit shtetëror, të njohur ndryshe si *acta iure imperii*. Gjithashtu, nuk aplikohet për zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar të personave fizik, të drejtën e pronësisë që rrjedh nga një marrëdhënie martesore. Rregullorja 1215/2012 nuk aplikohet për procedurat e falimentit, të shpalljes insolvabël të kompanive dhe personave juridik, sigurimeve shoqërore, arbitrazhit, detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet familjare, prindërimi, birësimi, testamenti dhe trashëgimia, si dhe detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i vdekjes së personave.

Rregullorja e re e Brukselit u prit mjaft mirë nga operatorët e ndryshëm të drejtësisë dhe biznesit, duke parë lehtësimin që i jep qarkullimit të vendimeve gjyqësorë, aksesit në gjykim, dhe si rrjedhojë shërben për lehtësimin e qarkullimit të mallarave dhe shërbimeve në B.E dhe jashtë.

Në lidhje me miratimin e Rregullores 1bis të Brukselit, Vëra Jourová Komisionerja e Bashkimit European për Drejtësi, Tregëti dhe Barazi Gjimore, deklaroi: *është një lajmë i mirë për qytetarët e B.E dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të mesme miratimi i kësaj rregulloreje. Këto rregulla të reja kursejnë një shumë prej 2000 deri 12000 Euro për çështje individuale. Është një ogur i mirë për tregun e përbashkët European. Ky veprim*

*do të sjellë një ndryshim rrënjësor sidomos në ndërmarrjen e vogla dhe të mesme dhe do të sjellë më shumë mundësi për biznesin në Europë.*<sup>49</sup>

Rregullorja e Brukselit e ndryshuar prezanton përmirësime të ndryshme në këtë instrument të rëndësishëm të B.E. – së. Veçanërisht, ndryshimet për gjyqëvarësinë do të kenë impakt në sjelljen e palëve në çështjet tregtare.<sup>50</sup> Me miratimin e kësaj rregulloreje palët mund të kërkojnë rihapjen e çështjeve të tyre dhe të zgjedhin juridiksionin ekskluziv të gjykatave anëtare për çështjet ekskluzive, për të përfituar nga ky rregull. Nga ana tjetër, pasiguritë qëndrojnë lidhur me çështjet që përfshijnë shtetet e treta, dhe sidomos marrëveshjet e juridiksionit të shteteve të treta, pasi ka një rrezik që rregullat e reja të gjyqëvarësisë ndërkombëtare do të cojnë në një rritje të gjyqëvarësisë dhe shtimit të çështjeve përpara gjykatave europiane.<sup>51</sup> Kjo duke qënë se me rregulloren lejohen Marrëveshjet e Juridiksionit të lidhura me persona fizik apo juridik me shtetësi jashtë B.E – së, si rrjedhojë do të ketë më shumë persona që çështjen e tyre ja besojnë gjykatave të shteteve anëtare.

Rregullorja 1215/2012 ka si qëllim lehtësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve gjyqësore në Bashkimin Europian dhe aksesin në gjykim, si pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, si garanci për mbrojtjen e të dretjave dhe interesave legjitim të subjekteve të interesuar.

Kjo rregullore zgjeroi qëllimin e juridiksionit dhe u bë e aplikueshme për të paditurit që nuk janë rezident në një nga vendet anëtare. Kështu, duke filluar nga Janari 2015 të gjitha marrëdhëniet që rregullon kjo rregullore do të shtrihen dhe ndaj personave që nuk

---

<sup>49</sup>[https://Europe.eu/rapid-release\\_IP15-3080-en.htm](https://Europe.eu/rapid-release_IP15-3080-en.htm)

<sup>50</sup>[http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-\(RECAST\)-ARE-YOU-READY.aspx](http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-(RECAST)-ARE-YOU-READY.aspx)

<sup>51</sup>[http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-\(RECAST\)-ARE-YOU-READY.aspx](http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-(RECAST)-ARE-YOU-READY.aspx)



janë rezidentë në B.E. Ky ndryshim u bë për shkak të zhvillimeve dinamike që ka aktualisht Bashkimi Europian, për t'i shërbyer qarkullimit të lirë të vendimeve dhe për t'i dhënë mundësi palës së paditur, si palë që ka nevojë më tepër për mbrojtje reale, për t'u dëgjuar e për të realizuar mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre, duke i shërbyer aksesit në drejtësi. Kështu, përveç heqjes së procedurës së njohjes së vendimeve gjyqësor, ka zgjeruar qëllimin e juridiksionit edhe mbi të paditurit që nuk janë rezidentë në vendet e B.E.

Rregullorja e re përcakton se rregullat e juridiksionit do të bazohen në vendbanimin e të paditurit, përveç në disa raste të caktuara në të cilat për shkak të subjektit ose autonomisë së palëve justifikon përdorimin e kritereve të ndryshme. Kjo bëhet që të parandalojë që një person të marri një kërkesë padi nga një gjykatë e një shteti anëtar që nuk ka mundur ta parashikojë. Si rregull, subjekt i kësaj rregullorje janë personat që kanë vendbanimin ose vendqëndrimin në një nga shtetet e B.E, pavarësisht kombësisë së tyre, ata mund të paditen në gjykatat e shteteve anëtare. Personat që nuk kanë kombësinë e atij shteti anëtar janë rezident, do t'i nënshtrohen rregullave të juridiksionit të atij shteti shtetas të cilit janë. Nqs paditësi nuk është reziden në atë shtet anëtar, juridiksioi i gjykatës i atij vendi anëtar do të përcaktohet nga ligji i shtetit anëtar. N.q.s kundra këtij të padituri, persona rezident të shtetit anëtar, pavarësisht kombësisë, ngrejne padi, këta të paditur mund ta pranojnë këtë juridiksion të këtij shteti anëtar vullnetarisht.

### 3.3.3 Juridiksioni i veçantë sipas Konventës 1bis të Brukselit.

Përveç rregullit të përgjithshëm për përcaktimin e juridiksionit, rregullorja njih edhe përjashtime, të cilat i konsideron juridiksione të veçanta. (Brati,2008:73) Një person rezidentë në një nga vendet e B.E mund të paditet në një tjetër shtet anëtar, për çështje që lidhen me kontratat, në gjykatën e vendin ku do të kryehet veprimi ose detyrim, për rastet e shitjes së mallrave në vendin ku sipas kontratës, malli do të dergohet. Në rastet e shkaktimit të dëmit kontraktor ose jashtë kontraktor, mund të ngrihet në gjykatën e atij shteti anëtar ku është shkaktuar dëmi. Përsa i përket një pretendimi civil për shkaktimin e një dëmi që lidhet me një proces penal, pra që lidhen me një vepër penale, padia mund të ngrihet në të njëjtën gjykatë ku është duke u gjykuar çështja penale. Për çështje që kanë lidhje me veprimin e agjensive, filialeve, kërkesë padia do të ngrihet në gjykatën e vendit ku ndodhet selia, dega apo agjensia respektive. Kur kemi të bëjmë me shumë të paditur, padia mund të ngrihet në shtetin e njërit nga të paditurit, në rastet kur është e pamundur të ndahet çështja. Gjithashtu, në rastet e kontratave me objekt sendet e paluajtshme, kërkesë padia do të ngrihet në shtetin ku ndodhet sendi i paluajtshëm. Si juridiksione të veçanta, Konventa 1bis e Brukselit parashikon në seksione të veçanta të saj me rregulla të detajuara, juridiksionin mbi çështjet e konsumatorit, juridiksionin mbi kontratat individuale të punës dhe juridiksionin mbi çështjet e sigurimeve. Për sa i përket juridiksionit për çështjet e sigurimeve, rregullorja e re parashikon që një kompani sigurimesh mund të paditet në një nga shtetet anëtare ku ka selinë, ose në rastet kur është një bashkë sigurues, në një nga gjykatat e shteteve anëtare ku ka filluar procedura kundër siguruesit kryesor. Për kompanitë e sigurimeve që nuk kanë selinë qendrore në një shtet anëtar, por kanë një filial, degë ose agjensi në një nga shtetet anëtare, do të prezumohet se në atë shtet është vendbanim dhe aty do të paraqitet kërkesë padia. Në

rastet e kontratave të sigurimeve për pronat e paluajtshme, siguruesi mund të paditet në gjykatat e shteti ku ka ndodhur ngjarja. Nga ana tjetër, një sigurues mund të ngrej padi vetëm një gjykatat e shtetit anëtar në të cilin i padituri ka vendbanimin, pavarësisht se i paditur është i siguruari, përfituesi apo mbajtësi i policës së sigurimit. Shohim në këtë mënyrë mbrojtjen e veçantë procedurale që i bën rregullorja 1bis e Brukselit palës së paditur, të siguruarve, konsumatorëve dhe punëmarrësve. Gjithashtu, vëmë re autonominë e vullnetit që kanë palët në përzgjedhjen edhe në këtë rast të juridiksionit të gjyktës së shtetit anëtar që dëshirojnë, me kusht që kjo marrëveshje e paleve për juridiksionin të jetë lidhur pasi të ketë lindur mosmarrëveshja, ose në rastet kur fakti ka ndodhur jashtë B.E, palët mund të lidhin marrëveshje për derogimin e juridiksionit në shtetin anëtar ku janë rezidentë të dyja palët, me kusht që kjo marrëveshje të mos jetë në kundërshtim me ligjet e atij shteti anëtar. Për sa i përket juridiksionit për çështjet e konsumatorit, rregullorja parashikon që konsumatori mund të bëjë një kërkesë padi kundra palës tjetër në kontratë në shtetin ku pala e paditur ka vendbanimin, ose në shtetin ku konsumatori ka vendbanimin e tij. Kështu, shohim një ndryshim nga rregullorja e mëparshme nr.44/2001 në përfshirjen edhe të kompanive të sigurimeve që janë rezidentë jashtë B.E – së. Ndërsa, procesi kundër konsumatorit mund të fillojë vetëm në shtetin ku ky i fundit ka vendbanimin. Një tjetër lloj juridiksioni i veçantë sipas rregullores 1215/2012, është juridiksioni mbi kontratat individuale të punësimit, një lloj i veçantë i cili parashikohet në sesionin 5, neni 20 – 23. Në çështjet që lidhen me kontratat individuale të punësimit, kur si palë paraqiten një punëdhënës që nuk ka selinë qendrore në një nga shtetet e B.E, por ka një degë ose filial në to, kërkesë padia do të ngrihet në këtë shtet. Një punëdhënës resident në një shtet anëtar mund të paditet në shtetin anëtar ku ka vendbanimin ose në një tjetër shtet anëtar në të cilin punëmarrësi

kryer zakonisht punën e tij, ose në shtetin ku ka kryer punën për herë të fundit. Një nga rrishtë që parashikon rregullorja nr. 1215/2012 është e drejta për të ngritur padi dhe ndaj punëdhënësve që nuk janë rezidentë në B.E. Në këto raste, kërkesë padia mund të ngrihet nga punëmarrësi në shtetin ku punëmarrësi ka kryer zakonisht punën e tij, ose në shtetin ku punëmarrësi ka kryer së fundmi punën e tij. Ndërsa nga ana tjetër, një punëdhënës mund të padisë punëmarrsin vetëm në shtetin në të cilin ky i fundit ka vendbanimin. Ky juridiksion i veçantë, i cili është në mbrojtje të punëmarrësve edhe në rastet kur punëdhënësi nuk është rezidentë në B.E, në ndryshim nga rregullorja 44/2001 e cila nuk parashikonte kërkesë padi kundër palëve që nuk ishin rezidentë në B.E, mund të derogohet vetëm me marrëveshjen e palëve, me kusht që kjo marrëveshje të jetë lidhur pasi ka lindur konflikti dhe i lejon punëmarrësit të hapi proces në një gjykatë tjetër nga këto që parashikohen në këtë sesion.

#### **3.3.4 Juridiksioni ekskluziv sipas Rregullores 1bis të Brukselit**

Gjykata e shteteve anëtare do të kenë juridiksion ekskluziv pavarësisht vendbanimit të palëve në disa raste të përcaktuara në sesionin 6, neni 24 i Rregullores 1215/2012. Në procese me objekt të drejta që rrjedhin nga pasuri të paluajtshme, kërkesë padia mund të ngrihet në shtetin ku ndodhet sendi apo pasuria e paluajtshme. Në procedura që kanë si objekt vlefshmërinë ose pavlefshërinë e vendimeve të personave juridik ose të vendime dhe veprimeve të organeve të tyre, kërkesë padia mund të ngrihet në shtetin ku ka selinë personi juridik, për përcaktimin e vendodhjes së selisë së personit juridik gjykata do të zbatojë rregullat e të drejtës ndërkombëtare private. Për procese që kanë si objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat publikë, kërkesë padia do të ngrihet në atë shtet anëtar ku janë regjistrat. Në procedura që lidhen me regjistrimin apo vlefshmërinë e

patentave, markave tregtare, dizenjimin, ose të drejta të ngjashme me to, të cilat kërkojnë regjistrim, kërkesë padia do të ngrihet në atë shtet anëtar ku janë regjistruar këto marka, ose ku kanë depozituar kërkesën për t'u regjistruar. Parashikimi që bën në këtë rast rregullorja nuk shkel juridiksionin e Zyrës Europiane të Patentave, krijuar me Konventën Europiane të Patentave, nënshkruar më 5 Tetor 1973 në Munih. Ndërsa për procedurat që lidhen me zbatimin e vendimeve në shtete të tjera anëtare të B.E, juridiksion ekskluziv do të kenë gjykatat e atij shteti anëtar ku është nxjerrë vendimi gjyqësor, të cilat me heqjen e procedurës së ekzekutimit të vendimeve, e kanë më të thjeshtë të nxjerrin vendimin e ekzekutimit në shtetet e tjera anëtare.

## **Kapitulli IV Juridiksioni gjyqësor në Shqipëri.**

### **4.1 Nxerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, shkelje e të drejtës për akses në gjykatë dhe e procesit të rregullt ligjor.**

Juridiksioni është një element kryesor dhe vital për sovranitetin e shtetit, është një ushtrim autoriteti i cili krijon marrëdhënie juridike dhe detyrime, qëmund të arrihen mes veprimtarisë legislative, ekzekutive ose gjyqësore. Në çdo rast, autoritetet e shtetit të njohura nga sistemi ligjor i atij shteti përmbushin funksione të caktuara që përshihen në sistemin e tyre. Karakteristika kryesore e juridiksionit është instrumentalizmi, pasi shërben si një instrument, si një mjet për mbrojtjen e të drejtave, është mjeti që përdoret për të bërë efektive të drejtat e personit. Mbrojtja e të drejtave përbën substancën e aktivitetit juridiksional dhe është funksioni global i juridiksionit. Shteti e ushtron veprimtarinë nëpërmjet organeve të tij, të cilëve me ligj u janë dhënë funksione të caktuara e kur është rasti, të zgjidhin çështje ose mosmarrëveshje që kanë lidhje me këto funksione. E drejta e organeve shtetërore për të zgjidhur çështjet që përfshihen në organet e tyre quhet juridiksion. (Lamani, 1962:62) Fjala juridiksion vjen nga latinishtja, jurisdiction, do të thotë të thuash ligjin, fjala juris është fjala latine që do të thotë ligj dhe dictio do të thotë të thuash, të deklaroj. Kjo fjalë është përdorur për të shpjeguar pushtetin që kishte një gjykatë për të interpretuar dhe zbatuar ligjin, ndërsa fjala latine jus dare do të thotë të bësh ligjin dhe përdorej për të treguar pushtetin që i ishte dhënë legjislatorit për të bërë ligje. (Brati, 2008:51) Një përkufizim tjetër e shih si një mekanizëm apo instrument sanksioni, si një mekanizëm reagimi që vihet në levizje sapo verifikohet fenomeni i dhunimit të të drejtave apo shkeljes së ligjit. Sipa këtij autori

juridiksioni është vënia në jetë e sanksioneve, ndërsa, nga këndvështrimi i funksionit të tij është mbrojtja e të drejtave.(Redenti,1980:22) Ky është dhe funksioni global i juridiksionit që qëndron në “ratio” e ligjit. Juridiksioni në të drejtën ndërkombëtare lidhet me fuqinë e shteteve nën ligjin ndërkombëtar të rregullojnë ose të ndikojnë mbi njëri-tjetrit, pronat, çështjet dhe reflekton parimet themelore të sovranitetit, barazisë mes shteteve dhe mos ndërhyrjes në punët e brendshme.(Malkolm,2008:645)

Bazuar në Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, e drejta për të interpretuar dhe zbatuar ligjin, pra për të gjykuar, i është dhënë pushtetit gjyqësor.Koncepti i Juridiksionit është i natyrës kushtetuese dhe rrjedh nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Në varësi të llojeve të organeve shtetërore që janë ngarkuar me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dallohet juridiksioni gjyqësor,juridiksioni administrativ dhe juridiksioni arbitrazhit.Juridiksioni gjyqësor ndahet në juridiksion penal dhe civil,në varësi të natyrës së ligjeve që duhen zbatuar.Kjo është ndarja kryesore midis juridiksionit gjyqësor.Në teorinë juridike bëhet dhe dallimi midis juridiksionit të zakonshëm dhe juridiksionit special apo të veçantë. (Chiovenda,1995:332)

Juridiksioni gjyqësor civil është tërësia e të drejtave dhe detyrave të gjykatës për të shqyrtuar çështje që i janë dhënë nga ligji në kompetencë.(Tafaj,Vokshi,2011:201)Shtrirja ose rrethi i çështjeve të juridiksionit gjyqësor, si dhe elementët e parimit të procesit të rregullt ligjor në Republikën e Shqipërisë, dalin nga kuptimi i nenit 42 i Kushtetutës,në të cilën parashikohet: *“Kushdo për mbrojtjen e të drejtave,të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore,ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij,ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik*

*brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*” Nga përmbajtja e këtij neni del, se gjykimi i çdo gjëje që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore, apo gjykimi i çdo akuze në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohet një kontrolli gjyqësor, të kryer nga gjykata. Nuk ka rëndësi nëse kjo gjykatë i përket juridiksionit kushtetutues të ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, apo juridiksionit gjyqësor civil apo penal. E rëndësishme është që duhet të përmbush të gjitha garancitë kushtetuese, të jetë e krijuar me ligj, të mos jetë gjykatë e jashtëzakonshme e krijuar vetëm për gjykimin e një çështjeje të veçantë, të jetë e paanshme dhe e pavaruar, gjykimi i bërë prej saj të jetë publik dhe brenda një afati të arsyeshëm. Këto janë kërkesat për një proces të rregullt ligjor. Çështja e juridiksionit të legjislacionin shqiptar është një çështje që i përket administrimit të mirë të drejtësisë, si dhe nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor sipas Gjykatës Kushtetuese *“prek standartet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e pengimit të shqyrtimit të çështjes nga gjykata”*.<sup>52</sup> Sipas Gjykatës Kushtetuese nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit është shkelje e aksesit në gjykim e si rrjedhojë shkelje e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Aksesit në gjykim përbën garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, gjë që nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por dhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë mundësi.<sup>53</sup> Juridiksioni gjyqësor në këtë rast nuk përfshinë vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur nga ana e gjykatës një zgjidhje përfundimtare. Prandaj gjykata i ka qëndruar opinionit se çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të Konventës

---

<sup>52</sup> Vendimi nr. 10/2007 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>53</sup> Vendimi nr. 14/ 2009 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.



Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre.<sup>54</sup> Rol përcaktues për respektimin e aksesit në gjykatë dhe elementëve të tjerë të procesit të rregullt ligjor ka luajtur jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Neni 6 i K.E.D.NJ - së ka rëndësi primare në këtë aspekt, duke siguruar aksesin në gjykatë si pjesë integrale e procesit të rregullt ligjor, por nga ana tjetër shërben si garanci për mbrojtjen ligjore në përgjithësi, duke përcaktuar procedurën që ndiqet përpara një gjykate. Kjo e drejtë është njohur fillimisht nga Gjykata në çështjen *Golder kundër UK*. Në këtë çështje GjEDNJ mbajti qëndrimin se neni 6 ka të bëjë jo vetëm me mënyrën ligjore të procesit të kryer, por gjithashtu jep të drejtën e aksesit në gjykatë, si pjesë e procesit të rregullt gjyqësor. Sipas Gjykatës, garancia për një gjykim të drejtë do të jetë pa vlerë nëse do të ishte e pamundur të fillohej procedura gjyqësore në shkallë të parë.

Ka patur mjaft çështje të trajtuara nga GjEDNJ kundër Shqipërisë për shkelje të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, procesit të rregullt ligjor.

Më konkretisht, në çështjen pilot *Manushaqe Puto* dhe të tjerë kundër Shqipërisë, GjEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të Konventës për një proces të rregullt ligjor, si dhe shkeljen e nenit 13, nenit 1 të protokollit nr.1, e drejta e pronësisë. Sipas GjEDNJ mos ekzekutimi i vendimit është shkelje e procesit të rregullt ligjor. Shteti shqipar duhet të marrë masa në mënyrë që të sigurohet e drejta për kompensim brenda 18 muajve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë. Edhe zbatimi i një vendimi gjyqësor me vonesë është konsideruar si cënim i afatit të arsyeshëm, e për rrjedhojë shkelje e procesit të rregullt ligjor. Edhe në çështjen *Gjyli* kundër Shqipërisë, GjEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak të mos ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

---

<sup>54</sup> Vendimi nr.7/2008 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

E drejta për akses në gjykatë është vërejtur që është shkelur edhe në rastin Shkalla kundër Shqipërisë. GJEDNJ konstatoi shkelje të procesit të rregullt ligjor si pasojë e shkeljes së të drejtës për akses dhe mos dëgjimit të palës, pas nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit kushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Në një tjetër çështje Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr.8/2010 vendosi që: e drejta e kërkuarit për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është cënuar për shkak të veprimeve të institucioneve shtetërore, të cilat rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar zbatimin në kohë të vendimeve të gjykatave.<sup>55</sup>

Edhe pse neni 6 i KEDNJ në mënyrë eksplicite përmend juridiksionin gjyqësor civil dhe penal, kur përmend mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile dhe akuzën penale për një mosmarrëveshje për të cilën individit ka të drejtë për një gjykim të rregullt, praktika e GJEDNJ – së e ka zgjeruar fushëveprimin e këtij neni, duke përfshirë edhe procedurat administrative dhe procedurat parlamentare. Në këtë drejtim është e orientuar dhe jurisprudenca e gjykatave shqiptare, qoftë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe ajo e Gjykatës së Lartë. Për sa i përket çështjes së juridiksionit dhe kompetencës së gjykatave, Gjykata Kushtetuese në rastin e shoqërisë tregtare All & Development CO sh.p.k, pas sekuestrimit të pasurisë dhe të llogarive bankare, iu drejtua gjykatës për kundërshtimin e aktit administrativ. Gjykata Kushtetuese konkludon se nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, prek standartet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e pengimit të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, duke i mohuar shoqërisë kërkuar të drejtën për gjyq.<sup>56</sup> Nga ana tjetër nëq paditësi nuk ka shteruar rrugën administrative, në rastet kur është e

---

<sup>55</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.8/2010

<sup>56</sup> Vendimi nr.10/2007 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

detyrueshme, por ka investuar gjykatën, duke kaluar kështu direkt në juridikionin gjyqësor, jurisprudenca kushtetuese nuk e ka konsideruar cënim të së drejtës për akses, kur gjykata pushon çështjen me argumentin e mosshterimit nga kërkuesi të rrugës administrative. Mospërmbushja nga kërkuesi i standarteve të ngritjes së padisë nuk e vënë gjykatën para detyrimit për ta marrë atë në shqyrtim.<sup>57</sup> Në një tjetër rast, Gjykata e Lartë ka konkluduar për juridiksionin gjyqësor se pushimi i çështjes është cënim i të drejtës për akses. Në atë rast gjykata duhet të shprehej për bazueshmërinë në ligj apo jo të vendimit të gjykatës së apelit, i cili ka qënë objekt i kundërshtimit të rekursit.<sup>58</sup> Duke iu referuar juridiksionit gjyqësor për sa i përket jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, vihet re se edhe subjektet publik mund t'i referohen të drejtës për akses në gjykatë. Gjykata Kushtetuese ka pranuar legjitimitimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe ka theksuar se nisma për një gjykim kushtetues nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik, publik apo privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtrohen.<sup>59</sup> Të njëjtin arsyetim ka përdorur gjykata në rastin kur pala paditëse ishte një person juridik privat, duke u përqëndruar të natyra e pretendimeve dhe jo nga natyra e personit.<sup>60</sup> Të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e ka dhe gjykata e zakonshme, nëse i referohemi gjykimit incidental.<sup>61</sup> Të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e kanë dhe gjyqtarët e ndëshkuar disiplinarisht. Për këtë çështje është shprehur Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 24/2007 ku shprehet se: të drejtat e njeriut nuk mund të vendosen në të njëjtin nivel

---

<sup>57</sup> Vendimi nr.18, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>58</sup> Vendimi i Gjykatës së Lartë nr.16/2010

<sup>59</sup> Vendimi nr.22/2006 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

<sup>60</sup> Vendimi nr.36/2010 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

<sup>28</sup> Vendimi nr.18, datë 23.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

mbrojtjeje me të drejtat që i përkasin një funksionari publik, por e drejta e gjyqtarit për t'iu drejtuar gjykatës për veprimet që çenojnë të drejtat dhe elementet e pavarësisë së tij, nuk mohohet nga Kushtetuta apo ligji. Kushtetuta është një instrument i gjallë dhe duhet interpretuar nën dritën e kushteve aktuale jetësore dhe në mënyrën që të ketë kuptimin më tëarsyeshëm dhe më efikas të mundshëm. Parë në këtë këndvështrim, duke e interpretuar ligjin në mënyrë pajtuese, Kushtetuta orienton ligjvënësin të garantojnë të gjitha hapësirat e nevojshme ligjore të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatës për shqyrtimin e masave të tjera me karakter disiplinor.<sup>62</sup> Ligjvënësi ndryshoi ligjin “Për organizimin gjyqësor”, dhe parashikoi të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatës edhe për masat e tjera disiplinore, duke zgjeruar kështu juridiksionin gjyqësor. Një ndryshim i tillë ecën paralel me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila ka krijuar standarte minimale të përbashkëta të mbrojtjes gjyqësore që zbatohen nga të gjitha gjykatat kombëtare në Bashkimin European. Këtu vlen për t'u përmendur çështja Borelli e shqyrtuar nga Gjykata Europiane e Drejtësisë. Borelli paraqiti një kërkesë para GJED-së ndaj refuzimit që i kishin bërë autoritetet italiane dhe pretendonte për paligjshmëri të veprimit të ketyre autoriteteve. Sipas legjislacionit procedural italian, ky veprim i autoriteteve vendase nuk mund të kundërshtohet para një gjykate italiane. Gjykata Europiane e Drejtësisë duke u bazuar në Parimin e mbrojtjes efektive, ka vlerësuar se ligji procedural italian duhet të ndryshoj për t'i dhënë mundësi individit të kundërshtoj veprimet që e çenojnë në gjykatë.<sup>63</sup> Në këtë mënyrë respektohet e drejta e individit për mbrojtje efektive gjyqësore, që rrjedh nga tradita kushtetuese e çdo shteti dhe nga nenet 6 dhe 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

---

<sup>62</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetutuese nr.25/2007

<sup>63</sup> The Borelli Case (C-97/91) ECR 1992

#### 4.1.2 Karakteristikat kryesore të juridiksionit gjyqësor në Shqipëri.

Juridiksioni gjyqësor në Republikën e Shqipërisë është një juridiksion i detyrueshëm, por nuk mund t'i tejkalojë kufijtë e sovranitetit shtetëror, shprehje e të cilit ai është. Karakteri detyrues i juridiksionit del nga neni një i Kodit të Procedurës Civile i cili parashikon: *“Gjykata nuk mund të refuzoj të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.”* Koncepti i juridiksionit është një nga konceptet më të rëndësishme të së drejtës procedurale civile. Kodi i Procedurës Civile nuk bën një përkufizim të elementëve të konceptit të juridiksionit, por në nenin 36 parashikon që: *“Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrveshjet civile dhe mosmarrveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera. Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë.”*

Duke iu referuar këtij neni dhe nenit një të Kodit të Procedurës Civile kuptojmë se në juridiksionin civil përfshihet fusha e zbatimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata është organi i pushtetit shtetëror që i përket e drejta dhe detyra që të ushtrojë funksionin juridiksional. Juridiksioni gjyqësor përbën një pengesë për juridiksionet e tjera, kur çështja është duke u gjykuar nga ky juridiksion, pasi vetë ligji përcakton se asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtën ta pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata dhe çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë, është e pavlefshme. Mungesa e juridiksionit mund të vihet re në raste të ndryshme. Një rast mund të jetë që t'i mungojë juridiksioni një organi

të shtetit kundrejt organeve të tjera të të njëjtit shtet.p.sh një çështje mund t'i përkasi juridiksionit gjyqësor,juridiksionit administrativ apo të arbitrazhit.Mungesa e juridiksionit mund të jetë e përgjithshme për të gjithë organet e shtetit,për shkak të përjashtimit ndaj këtij juridiksioni që gëzon i padituri, p.sh:në rastet e juridiksionit ndaj përfaqësuesve diplomatik.Përfaqësitë diplomatike përjashtohen nga juridiksioni shqiptar. Subjekti që gëzon përjashtimin nga juridiksioni ka të drejtë të heqi dorë me vullnetin e tij nga ky përjashtim dhe në çdo rast mund të paraqitet si paditës në gjykatë.Një tjetër rast i mungesës së juridiksionit është për shkak të veçanësisë së mosmarrëveshjes së parashtruar para gjykatës p.sh çështjet që përfshihen nëjuridiksionin kushtetues.Juridiksioni gjyqësor meret edhe me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, por kjo nuk duhet të ngatërrohet me juridiksionin administrativ që ushtrohet nga organet e administratës publike.Është ligji ai që vendos kufijt ndarës midis njërës aktivitet dhe tjetrit,pra midis veprimtarisë gjyqësore që ka si qëllim dhënien e drejtësisë dhe veprimtarisë administrative që ka për qëllim zbatimin e ligjit dhe realizimin e përditshëm të veprimtarisë administrative në shërbim të qytetarëve në ushtrim të funksionit ekzekutiv urdhërdhënës.

#### **4.2 Konfliktet e juridiksionit në lidhje me procesin civil ndërkombëtar.**

Bashkëekzistenca e një pluraliteti rendesh juridike sjell si pasojë krijimin e rregullave të caktuara, të cilat duhet të marrin në konsideratë rendet juridike të shteteve të tjera për të parë mundësinë e zbatimit të tyre në raste të caktuara. Në këtë kuadër nuk duhet të mohohet se ekzistenca në vazhdimësi, e konflikteve të ligjeve të brendshme ka qënë e lidhur ngushtë me karakterin e shteteve, apo rendin juridik e politik të tyre.(Kalia,2010:11)

Në lidhje me marrëdhëniet juridike me element të huaj, mund të lindin konflikte të cilat paraqiten përpara gjykatës ose arbitrazhit për t'u zgjidhur. Këto lloj konfliktesh quhen konflikte juridiksionale në procesin civil ndërkombëtar. Problemet që lindin në kuadër të procesit civil ndërkombëtar lidhen me kompetencën në të drejtën ndërkombëtare private, procedurën e aplikueshme në këto lloje konfliktesh dhe efektet e vendimeve gjyqësore të lëshuara nga gjykatat e huaja.

Përsa i përket kompetencës juridiksionale dallojmë dy lloj kompetencash të tilla: kompetencë në të drejtën ndërkombëtare private dhe kompetenca në të drejtën e brendshme. Kompetenca në të drejtën ndërkombëtare private është ajo kompetencë që i referohet përcaktimit të gjykatave të një vendi, në raport me gjykatat e një vendi tjetër, që thirren të zgjidhin konfliktin e lindur. Kështu, nëse një konflikt është në kompetencë të gjykatave shqiptare kjo do të thotë që përcaktohet kompetenca e tij juridiksionale në të drejtën ndërkombëtare private. Në analizë të nenit 37 të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare tregon që nëse ekzistojnë konflikte kompetencash që lindin midis gjykatave apo organeve të tjera me aktivitet gjyqësor, atëherë ky lloj konflikti do të zgjidhet nga organi gjyqësor që është superior në këndvështrimin hierarkik. Si pasojë, kompetenca e përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare private është e ndryshme nga koncepti i kompetencës së përgjithshme të së drejtës procedurale civile, e cila përcakton gjykatën kompetente brenda shtetit. Kompetenca në të drejtën e brendshme thirret të zgjidhë konfliktin. Në këtë rast është fjala për kompetencë materiale dhe territoriale në kuptimin e të drejtës procedurale civile. Kështu, pasi përcaktohet se gjykata shqiptare ka juridiksion ndërkombëtar për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar, duhet të përcaktohet gjykata kompetente brenda sistemit gjyqësor shqiptar. Në analizë të nenit 54 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, midis dy gjykatave kompetente për

zgjidhjen e një çështjeje, paditësi duhet të zgjedhë gjykatën kompetente për ngritjen e padisë. Kur në gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshjet midis të njëjtëve palë dhe kanë të njëjtën shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruara më parë. Kjo sepse konfliktet për kompetencë mes gjykatave nuk lejohen. Përcaktimi i saktë i gjykatës kompetente është kusht *sine qua non* për funksionimin normal të një organi shtetëror. Një gjykatë nuk është kompetente, kur sipas ligjit një çështje nuk mund ta shqyrtojë ajo, por një gjykatë tjetër. Nëse kemi kapërcim kompetencash, kemi moskompetencë, pasi të kapërcesh do të thotë të kalosh në një nivel tjetër dhe nëse kapërcehet kompetenca do të thotë, së paku, se janë marrë kompetencat e një gjykate tjetër. (Tafaj, Vokshi, 2013:346)

Për sa i përket kompetencës së gjykatave mund të gjendemi përpara tre situatave të ndryshme:

- a) Mund të ndodhë që gjykata që shqyrton çështjen të jetë jokompetente që në fillim. Në këtë rast, gjykata nuk mund të shprehet për themelin e çështjes dhe të gjitha veprimet procedurale të kryera e humbasin vlerën e tyre sapo deklarohet moskompetenca. Në këtë rast kërkesë padia nuk ka efekte procedurale apo materiale, përveç rastit të parashkrimit. Një gjykatë që është jokompetente që në fillim, nuk mund të fitojë asnjëherë kompetencën për gjykimin e një çështjeje të caktuar, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Në rastin e moskompetencës, ligji parashikon se gjykata e konstaton atë *ex officio*, ose me kërkesën e palëve dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente. K.Pr.C ndryshe nga përcaktimet mbi juridiksionin për të cilin në nenin 59/1 parashikon se: “Gjykata, edhe kryesisht në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit shqyrton nëse ka apo jo juridiksion për gjykimin e çështjes”. Në rastin e kompetencës nuk shprehet në lidhje me



momentin procedural në të cilin mund të shqyrtohet kompetenca e gjykatës për gjykimin e një çështjeje.

- b) Nëse në momentin e paraqitjes së kërkesë padisë gjykata ishte kompetente për shqyrtimin e çështjes dhe për shkak të një fakti të ndodhur më vonë kthehet në gjykatë jokompetente, kjo lloj moskompetence nuk ndikon në veprimet e mëpërshme që gjykata ka kryer në kohen kur ka patur kompetencë për çështjen në fjalë. Edhe kërkesëpadia i ruan efektet e saj dhe çështja i kalon gjykatës më të lartë që është bërë kompetente.
- c) Nëse një gjykatë me lartëeshtë duke gjykuar çështjen, ajo do të vazhdojë gjykimin pavarësisht se kompetente për gjykimin e çështjes bëhet një gjykatë më e ulët. Kjo bazohet në parimin procedural të vazhdimit të kompetencës.

Neni 62 i K.Pr.C u njeh palëve të drejtën për të bërë ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë vetëm në rastin kur gjykata që po shqyrton çështjen shpall moskompetencën.<sup>64</sup> Kjo nuk aplikohet në rastet kur gjykata me vendim të ndërmjetëm rrëzon kërkesën e njëres palë për deklarin e moskompetencës. Kështu, nuk lejohet ankim i veçantë kur gjykata ka vendosur se është kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes. Vendimi që deklaron moskompetencën e gjykatës jepet gjatë shqyrtimit të çështjes, nuk është përfundimtar, si dhe nuk ndalon zhvillimin e mëtejshëm të procedurës para gjykatës. Ndaj këtij lloj vendimi mund të bëhet ankim, së bashku me vendimin përfundimtar.(Lamani,1962:97)

Ligji shqiptar mbështet parimin që konfliktet për kompetencë nuk lejohen. Kjo do të thotë që edhe në qoftë se në një gjykatë që nuk është kompetente, dërgohet

---

<sup>64</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë nr.887,dt.05.07.2007

një çështje për t'u gjykuar nga një gjykatë tjetër, e cila ka deklaruar moskompetencën e saj, gjykata pritëse duhet të gjykojë çështjen dhe në të njëjtën kohë duhet t'i parashtrojë pretendimet e saj Gjykatës së Lartë, e cila ka të drejtë të vendosë për rregullimin e kompetencës. (Tafaj,Vokshi,2013:342)

Në ndryshim nga rasti i konfliktit mbi juridiksionin, në rastin e gjykimit mbi përcaktimin e gjykatës kompetente, gjykimi në Gjykatën e Lartë nuk pezullon gjykimin në gjykatën që është duke shqyrtuar çështjen. K.Pr.C parashikon pezullimin e gjykimit në rastin kur bëhet ankim kundër vendimit të gjykatës që shpall moskompetencën. Edhe në këtë rast Gjykata e Lartë shqyrton ankimin në dhomë këshillimi me tre gjyqtarë. Gjykata e Lartë vendos për rregullimin e kompetencës dhe jep udhëzimet për vazhdimin e procesit nga gjykata që deklarohet kompetente.

#### **4.2.1 Normat që përcaktojnë kompetencën në të drejtën ndërkombëtare private.**

Legjislacioni i çdo shteti përcakton normat juridike, me ndihmën e të cilave mund të përcaktohet kompetenca në të drejtën ndërkombëtare private, për organet e shtetit në fjalë. Kompetenca e gjykatave shqiptare në lidhje me konfliktet me element të huaj përcaktohet sipas dispozitave të përfshira në ligjet shqiptare dhe jo sipas dispozitave të përfshira në ligjet e shteteve të tjera. Në këto kushte tërësia e normave juridike që formojnë të drejtën ndërkombëtare private mund të ndahet në dy kategori të mëdha:

- a) Norma që rrjedhin nga rendet juridike të shteteve të ndryshme ose nga burimet normale të së drejtës.

- b) Norma që rrjedhin nga ekzekutimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e marrëdhënieve juridike civile (konventa, traktate etj) (Kalia, 2010:45)

Normat që përfshihen në kategorinë e parë i japin vend asaj që quhet e drejtë ndërkombëtare private e përgjithshme, e cila është në fuqi në çdo shtet. Normat e grupit të dytë formojnë atë që quhet e drejta e veçantë ose speciale. Kjo e drejtë është e bazuar mbi parimin se e drejta speciale është dominuese mbi atë të përgjithshmen. (Kalia, 2010:45)

Ky parim është i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 122/2 ku parashikohet: *“Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”*

Në Republikën e Shqipërisë marrëveshjet ndërkombëtare me karakter juridiko – civil zbatohen brenda shteti me anë të procedimit të veçantë, duke nxjerrë norma të posaçme për ekzekutimin e tyre. Këto marrëveshje ndërkombëtare shndërrohen në norma të brendshme nga momenti në të cilin normat e posaçme për ekzekutimin e tyre, i japin mundësinë që të zbatohen në rendin tonë të brendshëm juridik dhe të shndërrohen në pjesë të së drejtës së shtetit tonë.

Normat që përcaktojnë kompetencën në të drejtën ndërkombëtare private dallojnë nga normat e konfliktit. Normat e konfliktit janë norma deleguese, ndërsa normat që përcaktojnë kompetencën në të drejtën ndërkombëtare private nuk janë norma deleguese apo dërgimi. Normat e konfliktit nuk aplikohen drejtëpërdrejtë, por ato vetëm tregojnë ligjin e aplikueshëm. Si pasojë, normat e konfliktit mund të merren edhe me situatën kur vetë ligji nuk është i aplikueshëm, duke bërë referime në ligjin e aplikueshëm. Normat që përcaktojnë kompetencën në të drejtën ndërkombëtare private dhe gjykatat

kompetente parashikohen me ligj. Normat e konfliktit e zgjidhin konfliktin e ligjeve, ndërsa normat e tjera zgjidhin konfliktin e kompetencave. Rregullimi i një marrëdhënieje juridike me element të huaj është objekt i normave të konfliktit dhe nga ana tjetër, tregimi i ligjit të aplikueshëm është funksioni i tyre i përgjithshëm.(Kalia,2010:105) Normat e konfliktit kanë karakter indirekt veprimi, të cilat me anë të kësaj mënyre veprimi shprehin vet funksionin e tyre. Normat e konfliktit nuk përcaktojnë drejtëpërdrejtë zgjidhjen e një çështjeje të caktuar apo rregullimin e një marrëdhënieje juridike të dhënë, siç ndodh me llojet e tjera të normave juridike, por kufizohen në përcaktimin e normës juridike që duhet të zbatohet për të rregulluar një marrëdhënie juridike të caktuar. Teknika e veprimit e normave të konfliktit është ajo e procedimit indirekt të tyre. Në teorinë e së drejtës bëhet dallimi midis normave materiale dhe normave instrumentale (formale). Normat materiale kanë si qëllim rregullimin direkt të marrëdhënies juridike, ndërsa normat instrumentale (formale) nuk parashikojnë në vetvete se si duhet të rregullohet një marrëdhënie juridike, por tregojnë normat e tjera, tek të cilat duhet referuar për të rregulluar marrëdhënien në fjalë. Normat materiale janë më të shumta në numër se sa normat instrumentale. Normat instrumentale quhen të tilla, sepse nuk bëjnë vet rregullimin e marrëdhënies juridike, por tëreferojnë në norma të tjera.Normat e konfliktit janë norma tipike instrumentale. Funksion i normës së konfliktit nuk është zgjidhja e çështjes, por disponojnë në vetvete një mjet teknik për arritjen e një qëllimi të tillë. Marrim përshëmbull përmbajtjen e një norme konflikti, konkretisht ligji nr 10428,datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, neni 11, pika 1 : “*Zotësia për të vepruar e personit fizik dhe kufizimi apo heqja e zotësisë për të vepruar rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ai ka.*” Kjo normë tregon natyrën instrumentale që ka norma e konfliktit, duke na

referuar shtetësinë e të cilit personi mban. Normat e konfliktit në këtë mënyrë janë norma instrumentale, të cilat hera herës referojnë për aplikim tek e drejta e brendshme dhe herë të referojnë për aplikim te lex fori. Normat e konfliktit zgjidhin konfliktin e ligjit, ndërsa normat e tjera zgjidhin konfliktin e kompetencave. Ato tregojnë kompetencë ligjore, e cila mund të jetë e ligjit të saj kombëtar apo e një ligji të huaj, ndërsa normat e tjera tregojnë kompetencën juridiksionale për gjykatat kombëtare dhe jo për gjykatat e huaja.

Normat e konfliktit identike nuk sjellin gjithmonë zgjidhje konkrete identike. Zgjidhja e konfliktit mund të ndryshojë në marrëdhënie me gjykatën kompetente edhe pse normat e konfliktit mund të jenë identike, pasi ligjet në të cilat bëhet referimi, nga normat e konfliktit mund të jenë të ndryshme dhe kështu edhe zgjidhja e konfliktit do të jetë e ndryshme.(Qoku,2016:424) Ndonjëherë palët mund të heqin dorë në mënyrë të shprehur ose të heshtur nga aplikimi i të drejtës së huaj kompetente, duke kërkuar që të aplikohet lex fori. Kjo është një e drejtë që ia jep ligji. Gjykata kompetente aplikon si rregull ligjet e procedurës së saj. Si pasojë, përcaktimi i juridiksionit nënkupton dhe përcaktimin e normave të procedurës së aplikueshme, të cilat mund të jenë të ndryshme nga njëri shtet në tjetrin dhe duke influencuar kështu në zgjidhjen e konfliktit. Në rastet kur, përjashtimisht, nuk mund të përcaktohet përmbajta e ligjit të huaj, gjykata aplikon sipas sistemit tonë të konfliktit, pra aplikohet ligji shqiptar.

Përcaktimi i juridiksionit bëhet paraprakisht zgjidhjes së konfliktit të ligjeve. Ligji procedural shqiptar përcakton detyrimin e gjykatës që në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, të shqyrtojë nëse çështja që po gjykon hyn në juridiksionin gjyqësor, administrativ apo të arbitrazhit. Bazuar në nenin 59 pika 1 të K.Pr.C kundër vendimit të dhënë nga gjykata mund të bëhet ankim i veçantë në

Gjykatën e Lartë, vendimi i të cilës është përfundimtar. Neni 59 i K.Pr.C parashikon se është detyrë e gjykatës që në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë dhe kryesisht të shprehet nëse ka juridiksion për çështjen në fjalë. Juridiksioni është një kusht paraprak i procesit gjyqësor, mungesa e të cilit e bën nul të gjithë procesin. Në një vendim unifikues Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehen se: *“Gjykata e Apelit Gjirokastrë nuk duhej ta shqyrtonte çështjen, por në bazë të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile duhej të vendoste moskompetencën e saj dhe ta dërgonte aktet në gjykatën kompetente që në këtë rast është Gjykata e Lartë. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin se vendimi i dhënë nga kjo gjykatë është jo vetëm i kundraligjshëm, por është njëvendim absolutisht i pavlefshëm që nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe si i tillë duhet të priset. Çdo individ pasi të ketë ezuruar rekursin administrativ, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës me padi për detyrimin e organit administrativ për nxjerrjen e një akti administrativ brenda kompetencave të tij, me qëllim realizimin e një të drejte ligjore të pretenduar. Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin se gjykatës i lind e drejta, të detyrojë me vendim cilindo organ jo vetëm të ushrojë detyrën, por ta ushrojë atë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet duke garantuar të drejtën e individit për një gjykim të drejtë dhe në një afat të arsyeshëm.”*<sup>65</sup>

Në këtë mënyrë, në çdo shkallë të gjykimit që ndodhet çështja, gjykatat janë të detyruara që të marrin në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, administrativ apo të arbitrazhit. Në një rast të tillë gjykata shprehet me vendim. Lidhur me këtë vendim në funksion edhe të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 59, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, parashikon se kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë. Në këtë

---

<sup>65</sup> Vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, nr.686,dt.11.05.2000.

rast Gjykata e Lartë e shqyrton ankimin në dhomë këshillimi, në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë dhe shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se tridhjetë ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës.(neni 63/2 K.Pr.C)

Ndërsa, caktimi i gjykatës kompetente nënkupton vendosjen e ligjit të aplikueshëm. Gjykata kompetente përcaktohet, me anë të aplikimit të dy rregullave. Kompetenca materiale përcakton sferën e aktivitetit të gjykatave të ndryshme. Kompetenca materiale përcakton në linjë horizontale sferën e aktivitetit të gjykatave të të njëjtit nivel. Kompetenca në të drejtën ndërkombëtar private përcakton gjykatat e një shteti përball një tjetri, që thirren për të zgjidhur konfliktin me element të huaj. Pasi përcaktohet kjo kompetencë, ngrihet problemi i përcaktimit se cila gjykatë shtetërore thirret për të zgjidhur çështjen. Në këto kushte duket sikur kompetenca në të drejtën ndërkombëtare private, përcaktohet në bazë të kompetencave materiale, pra sipas natyrës së konfliktit, kurse konflikti me element ndërkombëtar dhe ai i brendshëm kanë të njëjtën natyrë, për pasojë janë konflikte civile dhe nuk i nënshtrohen normave të kompetencës territoriale.(Qoku,2016:438) Normat e kompetencës materiale janë në përgjithësi imperative, pasi kanë lidhje me mënyrën e organizimit të aktivitetit, të organeve gjyqësore, ndërsa normat e kompetencës territoriale janë në përgjithësi dispozitive. Shkelja e normave të kompetencës materiale sjell pavlefshmëri absolute, ndërsa shkelja e normave të kompetencës territoriale sjell pavlefshmëri relative. Kjo do të thotë se palët në një konflikt nuk mund të heqin dorë nga kompetenca materiale, por mund të heqin dorë nga kompetenca territoriale.

Ndërsa, kompetenca në të drejtën ndërkombëtare publike përcaktohet në rastin kur nuk ekziston një rregullore speciale në lidhje me kompetencën sipas normave të kompetencës territoriale, pasi vetëm kështu mund të përcaktohet, lidhja midis konfliktit

me element të huaj dhe gjykatës kompetente për të zgjidhur konfliktin.(Qoku,2016:438)

Këto norma iu përshtaten gjithësesi kushteve të krijuara, nga marrëdhëniet juridike me element ndërkombëtar. Si pasojë, në mungesë të disa dispozitave të shprehura, përcaktimi i juriksionit kompetent në të drejtën ndërkombëtare private bëhet në përputhje me normat e procedurës civile të brendshme, në rastin e Shqipërisë, të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit numër 10428,datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, që i përshtaten kushteve speciale në të cilat lindin dhe zhvillohen marrëdhëniet juridike me element të huaj.

#### **4.3 Juridiksioni ndërkombëtar i gjykatave shqiptare.**

Midis shtetasve shqiptar dhe të huajve ekzistojnë marrëdhënie juridike të cilat mund të jenë të karakterit personal ose ekonomik e tregtar. Gjykatat shqiptare janë kompetente të gjykojnë proceset civile midis një pale shqiptare dhe një pale të huaj, ose midis dy palësh të huaja, persona fizik ose persona juridik, në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar. Juridiksioni gjyqësor shqiptar ndaj të huajve rregullohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin nenin 16 parashikon:

*“Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptar vlejné njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë,me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.*

*Të drejtat dhe liritë themelore,si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejné edhe për personat juridikë,për aq sa përputhen me qëllimet e këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave,lirive dhe detyrimeve.”*



Gjithashtu, në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionohet: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*.

Nga këto norma kushtetuese del se duke përjashtuar liritë dhe të drejtat themelore si dhe detyrimet kushtetuese, ushtrimin e të cilave Kushtetuta e lidh shprehimisht me shtetësinë shqiptare, si e drejta e votës, e drejta për të marrë detyra shtetërore etj, shtetasve të huaj në territorin e shtetit shqiptar i janë njohur gëzimi i të gjitha të drejtave civile që i janë njohur edhe shtetasve shqiptar. Të njëjta kushte janë vendosur dhe për personat pa shtetësi dhe personat juridik. Kjo sjell si pasojë që shtetasi i huaj në pozitën procedurale të paditësit, në çdo rast mund të ngrej padi përpara organeve gjyqësore shqiptare në kushte të barabarta me shtetasin shqiptar. Shtetasi i huaj në pozitën procedurale të të paditurit, mund të jetë subjekt i juridiksionit shqiptar në rastet kur shtetasi i huaj sipas nenit 16 të Kushtetutës, ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë. (Brati, 2008:55)

Kuptimi i shtetasit të huaj në territorin e Shqipërisë nga përmbajtja e neneve 37 dhe 39 të Kodit të Procedurës Civile juridikisht do të thotë që ai të banojë ose qëndrojë në shtetin shqiptar, ose ndonjë prej elementëve objektiv të mosmarrëveshjes në të cilën ai është palë, t’i takojë jetës së përditshme shqiptare, çka nuk e lë indiferent shtetin shqiptar ndaj kësaj mosmarrëveshjeje.

Neni 37 i Kodit të Procedurës Civile sanksionon:

*“Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj. Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t’i kalohet me marrëveshje nje juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim dhe qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje*

*ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.*” Kështu, ky nen bën një përcaktim më të detajuar për ushtrimin e juridiksionit shqiptar ndaj shtetasve të huaj, duke vendosur që organet shtetërore shqiptare nuk do të kenë juridiksion ndaj të huajve apo personave pa banim e qëndrim në Shqipëri.

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë parashikon që juridiksioni gjyqësor shqiptar nuk mund t’i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, pra nuk mund të dergohet, përveç rasteve të shprehura në këtë nen, kur çështja ka të bëjë mes të huajve ose mes të huajve dhe shtetasve shqiptar pa banim e qëndrim në Shqipëri.

Ky parashikim është në kundërshtim me Rregulloren 1 bis të Brukselit nr.1215/2012 “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare” ku palët lejohen të lidhin një marrëveshje me vullnetin e tyre të lirë për të zgjedhur juridiksionin e duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që ka lindur apo do të lindi në të ardhmen.<sup>66</sup>

Ligjet e veçanta që rregullojnë pozitën e të huajve në Republikën e Shqipërisë janë: Ligji nr.9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt” dhe ligji nr.10428, dt.02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr.3920, datë 21.11.1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjës së huaj”, i cili ka qënë ligji që rregullonte drejtpërdrejtë gëzimin e të drejtave civile të të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në vitin 2011.

Ligji nr.9959, datë 17.07.2008 “Për të Huajt” rregullon kryesisht aspekte të së drejtës publike që kanë të bëjnë me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në territorin e Republikës

---

<sup>66</sup> Rregullorja e Këshillit Europian (EC) nr.1215/2012 “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.

së Shqipërisë. Që në nenin 1 të këtij ligji përcaktohet që: *“Shtetasit e huaj gëzojnë në Republikën e Shqipërisë po ato të drejta civile që u njihen shtetasve shqiptarë”*.

Ligji parashikon respektimin e parimit të reciprocitetit duke parashikuar mundësinë e vendosjes së kufizimeve të veçanta për shtetasit e atyre shteteve që kanë caktuar kufizime të posaçme në gëzimin e të drejtave civile për shtetasit shqiptarë. Në sistemin gjyqësor shqiptar, i huaji mund të veprojë në gjykim mbi bazën e reciprocitetit, d.m.th një shtetas i huaj mund të jetë i paditur në shtetin shqiptar për të njëjtat fakte që mund të jetë i paditur shtetasi shqiptar në autoritetet gjyqësore të shtetit të shtetësisë së të huajit. Ky parim i rëndësishëm procedural është i sanksionuar dhe në ligjin 10428, datë, 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, si një parim i përgjithshëm që i jep të drejtë gjykatës që të ketë juridiksion në shqyrtimin e një çështjeje, nëse ekziston reciprocitet midis shtetit shqiptar dhe shtetit të huaj, si dhe i jep të njëjta të drejta dhe detyrime shtetasit të huaj në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që ka shtetasi shqiptar në shtetin e huaj.

Në këtë ligj përcaktohen të drejtat dhe zotësia procedurale civile e shtetasve të huaj dhe personave juridikë të huaj. Sipas këtij neni: Shtetasit e huaj kanë të drejtë t’u drejtohen gjykatave të Republikës së Shqipërisë dhe gëzojnë të drejta procedurale civile të barabarta me shtetasit shqiptar. Zotësia procedurale e shtetasit të huaj rregullohet nga legjislacioni i shtetit, i të cilit është shtetas. Megjithatë mjafton që të ketë zotësinë procedurale sipas legjislacionit shqiptar.

Ligji përcakton gëzimin e të drejtave civile të të huajve në territorin shqiptar, shtetasit e huaj kanë të njëjtat të drejta civile dhe të drejta procedurale si edhe shtetasit shqiptar.

Ligji nr.10428, datë 02.06.2011, përcakton rregullat për ligjin që zbatohet në marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaja, juridiksionin dhe rregullat procedurale të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaja.<sup>67</sup>Ky ligj zbatohet për shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe me shumë shtetësi. Shtetasi i huaj mund të paditet para gjykatës shqiptare kur ka banim në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast objekti i kërkesë padisë mund të jetë i larmishëm, përveç rasteve kur padia ka të bëjë me sende të paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit.

Ligji nr.10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” përcakton rastet kur shtrihet juridiksioni i gjykatave shqiptare ndaj personave fizik e juridik të huaj.

Së pari, paditë që lidhen me sende të luajtshme ose të paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast juridiksioni i përket gjykatës shqiptare meqënëse sendi ndodhet në territorin shqiptar.

Së dyti, gjykata shqiptare ka juridiksion ndaj subjekteve të huaja kur detyrimi ka lindur ose do të ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë shkak gjykata shqiptare fiton juridiksion mbi një padi kundër personit të huaj që ngrihet mbi një detyrim që ka lindur në Republikën e Shqipërisë ose mbi një detyrim që ka lindur jashtë shteti, por që do të sjellë pasojat në Republikën e Shqipërisë.

Së treti, gjykata shqiptare ka juridiksion për të gjykuar një padi, ku i padituri është një subjekt i huaj, në rast se padia në fjalë ka lidhje me një tjetër padi që është duke u gjykuar nga gjykata shqiptare. Këtu bëhet fjalë për rastet e ndryshimeve të kompetencës për shkak të lidhjes së mosmarrëveshjeve.<sup>68</sup> Kështu, një padi do të konsiderohet se ka lidhje me një padi tjetër kur është në formën e kërkesës dytësore, kundërpadi ose ndërhyrje kryesore.

---

<sup>67</sup>Ligji nr.10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

<sup>68</sup> Neni 55 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, në ligj përcaktohen edhe raste të tjera kur gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe në rastet kur paditen njëkohësisht disa persona së bashku dhe njëri prej tyre ka vendqëndrimin e tij në Republikën e Shqipërisë, si dhe kur personi juridik i paditur ka selinë e tij në Republikën e Shqipërisë.

Nëse objekt i gjykimit janë pretendimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit dhe vendi, ku është kryer apo ka ndodhur veprimi që ka shkaktuar dëmin, është në Republikën e Shqipërisë; kur padia ka për objekt mosmarrëveshje, që rrjedhin nga veprimtaria e një dege ose filiali të një personi juridik, me seli në Republikën e Shqipërisë; kur padia rrjedh nga detyrimi për ushqim që ka një person kundrejt një personi, i cili ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë; paditë, që burojnë nga trashëgimia ligjore dhe ajo testamentare kur: i) trashëgimlënësi ka pasur vendqëndrimin e tij, në kohën e vdekjes, në Republikën e Shqipërisë; ii) pasuria trashëgimore ose pjesa më e madhe e saj ndodhet në Republikën e Shqipërisë.<sup>69</sup>

Ligji nr.10428 përcakton dhe kriteret të tjera për përcaktimin e kompetencës së gjykatave shqiptare ndaj marrëdhënieve me element të huaj, konkretisht:

- a) Proceset midis personave me vendbanim jashtë Shqipërisë, por që lidhen me akte apo fakte të gjendjes civile të regjistruara në Shqipëri, nëse të paktën njëra nga palët është shtetas shqiptar. Është e mundur që palët të kenë vendbanimin në një vend tjetër të huaj, ose në dy vende të ndryshme. P.sh gjykata shqiptare ka juridiksion në një çështje divorci midis bashkëshortëve që jetojnë jashtë Shqipërisë, kur të paktën njëri është shqiptar dhe e zgjedh vendbanimin procedural në lokalitetin ku ndodhet selia e gjykatës. Kërkohej plotësimi i

---

<sup>69</sup>Ligji nr.10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, neni 80

kushtit që procesi t'i referohet akteve dhe fakteve të gjendjes civile të regjistruar në Shqipëri, ku të paktën njëra nga palët është shtetas shqiptar.

- b) Deklarimi vdekjes së prezumuar të një shtetasi shqiptar edhe në rastet kur ai ndodhet jashtë shtetit në datën kur ka ndodhur zhdukja. Deri në marrjen e disa masave provizore nga gjykatat shqiptare, mbeten të vlefshme masat provizore të marra nga gjykata e huaj. Përcaktimi i shtetësisë bëhet edhe në këtë rast në përputhje me ligjin shqiptar.
- c) Proceset në lidhje me mbrojtjen e të miturit ose të një personi nën kujdestari, shtetas shqiptar me vendbanim jasht vendit. Shtetësia shqiptare përcaktohet në përputhje me ligjin shqiptar. Ligji aplikohet edhe në rastin në të cilin, i mituri ose personi nën kujdestari mund të ketë dy shtetësi, ku njëra nga shtetësitë është ajo shqiptare.
- d) Procese midis të huajve, nëse ata kanë rënë dakort me anë të një marrëveshjeje midis tyre në këtë mënyrë, ndërsa raporet juridike, lidhen me të drejta që ata mund të disponojnë, në lidhje me sende apo interesa të personave me shtetësi shqiptare. Pra, rastet kur procesi gjyqësorë zhvillohet midis të shtetasve të huaj, persona fizik apo juridik.
- e) Proceset në lidhje me mbrojtjen jashtë vendit të pronësisë intelektuale të një personi që ka vendbanimin e tij në Republikën e Shqipërisë. Ky mund të jetë shtetas shqiptar, i huaj ose person pa shtetësi. Nëse me anë të marrëveshjes së palëve nuk është përcaktuar një tjetër juridiksion, atëherë çështja do të zgjidhet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar.

Çështja do të jetë nën juridiksionin e gjykatës shqiptare nëse plotësohet kushtet ligjore si më poshtë vijon:

1. Ekzistenca e një marrëveshjeje mes palëve për t'ia nënshtuar çështjen e tyre juridiksionit gjyqësor shqiptar. Kështu, të huajt kanë rënë dakort shprehimisht për këtë gjë.
  2. Të jetë fjala për të drejta që palët i disponojnë.
  3. Të ketë lidhje me sende apo interesa të individëve me shtetësi shqiptare, gjë që nuk e bën indiferent shtetin shqiptar ndaj mosmarrëveshjes në fjalë.
- f) Proceset në lidhje me përkatësinë e anijeve apo avionëve, si dhe ato në lidhje me asistencën apo shpëtimin e disa personave, në një vend që nuk i nënshtrohet sovranitetit të ndonjë shteti nëse:
1. Avioni ose anija kanë flamuri shqiptar
  2. Vendi i destinacionit të aeroportit ose portit të parë, ku avioni apo anija ka mbërritur gjendet në territorin shqiptar.
  3. Avioni apo anija janë sekuestruar në Shqipëri.
  4. I padituri ka vendbanimin apo vendqëndrimin në Shqipëri.
- g) Cdo lloj procesi tjetër gjyqësor i parashikuar nga ligji do të bëjë pjesë në juridiksionin gjyqësor shqiptar.

#### **4.3.1 Juridiksioni ekskluziv i gjykatave shqiptare në çështje me element të huaj.**

Në disa raste të caktuara gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv duke qënë kështu të vetmet që mund të gjykojnë një çështje të caktuar. Ky lloj juridiksioni parashikohet nga neni 72 i ligjit nr.10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, por edhe në nene të tjera të këtij ligji si neni 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80.

Sipas këtij ligji gjykata shqiptare ka juridikion ekskluziv edhe në shqyrtimin e disa çështjeve me element të huaj. Në analizë të neneve të sipërpërmednura këto raste mund të përmbliken në mënyrë sintetike si më poshtë vijon:

- a) Dhënia e pëlqimit për birësim, nëse ai i cili do të birësohet ka vendbanimin në Shqipëri dhe është shtetas shqiptar ose i huaj apo pa shtetësi. Shtetasi i huaj edhe në rastet e vendbanimit në Shqipëri nuk i nënshtrohet këtyre dispozitave ligjore. Vendbanimi dhe shtetësia kualifikohen sipas ligjit shqiptar.
- b) Kujdestaria në lidhje me mbrojtjen e një personi me vendbanim në Shqipëri, shtetas shqiptar, i huaj apo person pa shtetësi. Në rastet kur personi i mbrojtur me anë të kujdestarisë ka vendbanim jashtë Shqipërisë, atëhere aplikohet neni 79 i ligjit 10428/2011. Kjo do të thotë që në këto raste nuk jemi përpara juridiksionit ekskluziv të gjykatave shqiptare.
- c) Aktet e gjendjes civile të plotësuara nga shteti shqiptar të cilat i referohen personave me vendbanim në Shqipëri, shtetas shqiptar, të huaj apo persona pa shtetësi. Ligji nuk aplikohet ndaj shtetasve të huaj edhe pse banojnë në Shqipëri. Akti i gjendjes civile kuptohet në kuptimin e instrumentit dhe duhet të ketë qënë i përpiluar në Shqipëri dhe t'i referohet një shtetasi shqiptar ose pa shtetësi me banim në Shqipëri. ( Qoku,2016:437)
- d) Sendet e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë. Të gjitha çështjet me objekt të drejtën e pronësisë dhe të drejtat reale mbi sendet e paluajtshme. Në analizë të neneve 45, 49 të K.Pr.C dhe nenit 72 pika a dhe 46 pika c, rezulton se ligji flet për “sendin e paluajtshëm për të cilin është ngritur padia, ndodhet në Republikën e Shqipërisë” dhe “paditë në lidhje me



sendet e paluajtshme të vendosura në Republikën e Shqipërisë”, është fjala për çdo proces në lidhje me sendet e paluajtshme (forum rei sitae). Në të drejtën e brendshme konsiderohet që parimi i forum rei sitae, i referohet vetëm padive reale edhe kur padia është poseduese apo kërkuuese. (Qoku,2016:438)

- e) Anulimi apo pavlefshëmria e martesës është një tjetër çështje që përfshihet në juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare, nëse në ditën e ngritjes së padisë të dy bashkëshortët ndodhen në Shqipëri dhe njëri prej tyre është shtetas shqiptar. Kështu, kërkohen plotësimi i disa kushteve:
- 1) Njëri nga bashkëshortët në momentin e lidhjes së martetsë është ose ka qënë shtetas shqiptar.
  - 2) Të dy bashkëshortët banojnë, në datën e ngritjes së kërkesës në Shqipëri, pa u interesuar nëse njëri apo të dy bashkëshortët vazhdojnë të banojnë apo jo në Shqipëri.
  - 3) Njëri nga bashkëshortët të jetë shqiptar ose person pa shtetësi dhe ka vendqëndrimin e tij në Shqipëri.
- f) Trashëgimia e lënë nga një person, i cili ka pasur vendbanimin e fundit në Shqipëri, që mund të jetë shtetas shqiptar, i huaj apo person pa shtetësi. Vendbanimi i fundit i personit të vdekur duhet të jetë në Shqipëri, ndërsa proceset gjyqësore të kenë lidhje me trashëgiminë. Kërkesat e trashëgimtarëve apo kreditorëve, të bëra pas kryerjes së ndarjes së pasurisë trashëgimore, i nënshtrohen rregullit actor sequitor forum rei, rregulli duke ju aplikuar edhe në rastin në të cilin ekziston një trashëgimtar i vetëm. Në të drejtën e brendshme padia për ndarje gjyqësore është reale, duke qënë e

mundur të marrë karakter miks, kur mbi të vendosen dhe kërkesa të tjera, incidente raporti ose zvoglimi apo kërkesa të tjera personale. Në të dyja rastet, aplikohen rregullat për kompetencën territoriale, të parashikuara për paditë reale. (Qoku,2016:428)

- g) Ekzekutimi me anë të përmbarimit i një titulli ekzekutiv në territorin e Shqipërisë është një tjetër rast i juridiksionit ekskluziv të gjykatave shqiptare.
- h) Ligji parashikon dhe juridiksionin për masat për sigurimin e padisë, duke parashikuar se: *“Gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit.”*<sup>70</sup>

#### 4.3.2 Imuniteti ndaj juridiksionit gjyqësor shqiptar.

Gjykimi i çështjeve gjyqësore me elemente të huaja para gjykatave shqiptare bëhet sipas ligjit procedural shqiptar, bazuar në respektimin e parimit të reciprocitetit dhe parimit të barazisë përpara ligjit, duke parashikuar të njëjta të drejta dhe garanci procedurale për subjektet e huaja, si dhe personat pa shtetësi, gjykimi i çështjeve të të cilëve zhvillohen para gjykatave shqiptare.

Anëtarët e përfaqësive diplomatike nuk janë nën juridiksionin gjyqësor shqiptar, vetëm nëse ata e pranojnë këtë me vullnetin e tyre. Ky përjashtim nga juridiksioni shqiptar është i parashikuar nënenin 39 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet juridiksioni ndaj përfaqësuesve diplomatik e konsullorë: *“Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur: a) pranon*

---

<sup>70</sup>Ligji nr.10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, neni 81

*vullnetarishtb)ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për Marrdhëniet Diplomatike.”*

Aktet ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, të tilla si Karta e OKB-së dhe Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Vjenës për Marrdhëniet Diplomatike (e vitit 1961, hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998), Konventa e Vjenës për Marrdhëniet Konsullore (1963), Konventa për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjensive të Specializuara dhe anekset e saj, si dhe marrëveshjet dy palëshe të ndryshme të lidhura me shtetin Shqiptar dhe shteteve të tjera, përcaktojnë rrethin e subjekteve që janë të përjashtuar nga juridiksioni territorial i brendshëm gjyqësor dhe administrativ dhe, si pasojë, nuk mund të jenë subjekte të padive, kërtimeve apo procedurave të ekzekutimit në vendin tonë. Përjashtimi nga juridiksioni territorial i vendit pritës, Shqipërisë, përfshin të gjitha funksionet zyrtare të këtyre subjekteve dhe është i paprekshëm, me përjashtim të rastit kur ata heqin dorë në mënyrë eksplicite.<sup>71</sup>

Në problematikën e imunitetit kemi dy koncepte: imunitetin absolut dhe imunitetin relativ. Teoria e imunitetit absolut parashikon imunitet të shtetit të huaj, sendeve të tij për çdo lloj aktiviteti që ushtron në territorin e shtetit tjetër, pavarësisht nga natyra e tij. Ndërsa teoria e imunitetit relativ mbron idenë e imunitetit vetëm për aktet që kanë të bëjnë me ushtrimin e fuqisë së tij, duke mënjeluar kështu aplikimin e këtij parimi edhe në rastet kur shteti i huaj kryen akte tregtie. Ky koncept është i parashikuar në disa konventa ndërkombëtare dhe gjendet edhe në disa projekte kodifikimi ndërkombëtar. (Qoku,2016:427) sipas teorisë së imunitetit funksional, ekzistojnë dy kategori aktesh që mund t'i kryej vet shteti:

---

<sup>71</sup> Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011

1. Acta jure imperii, pra aktet e kryera në emër të pushtetit të tij si shtet sovran.

2. Acta jure gestionis, pra akte me karakter ekonomik, ku shteti del si subjekt tregtar.

Sipas kësaj teorie, shteti gëzon imunitet në rastet kur vepron sipas jure imperii dhe nuk gëzon imunitet kur vepron në bazë të akteve jure gestionis. Kjo teori bazohet në një sërë konvetash ndërkombëtare, mund të përmend këtu Konventën e Brukselit e nënshkruar më 10 prill 1926, “Për unifikimin e disa rregullave në lidhje me imunitetet e anijeve shtetërore dhe pasagjerëve” si dhe Konventës së Montevideos nënshkruar më 19 mars 1940 në lidhje me të drejtën tregtare dhe ndërkombëtare, Marrëveshja e Brukselit lidhur më 10 maj 1952 “Për unifikimin e disa rregullave mbi aplikimin e sekuestros mbi anijet shtetërore”.

Bazuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, evidentojnë se e drejta e aksesit në gjykatën kombëtare i’u nënshtrohet rregullimeve kufizuese për aq sa këto kufizime nuk reduktojnë aksesin e individit në gjykatat kombëtare në një mënyrë të tillë, apo në atë masë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës. Dhënia e imunitetit palës së paditur në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe legjislacionit në fuqi nuk mund të thuhet se është tejkaluar marzhi i vlerësimit që shtetit shqiptar i lejohet në kufizimin e aksesit të individit në gjykatë.

Kjo bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, sipas së cilës “... *disa kufizime mbi aksesin (në gjykatë) duhet të konsiderohen si të qënësishme, si për shembull ato kufizime që*

*përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror*”.<sup>72</sup>

Bazuar në nenin 84 të ligjit nr.10 428,datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”: *“Prona dhe pasuritë e personave fizikë dhe juridikë, që gëzojnë imunitet diplomatik, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, sipas rregullave të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ose në rast se një gjë e tillë pranohet vullnetarisht.”*

Marrëveshjet ndërkombëtare sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 116), kanë një status superior ndaj ligjeve. Ligji shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë njohin dhe pranojnë se pavarësisht mungesës së juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkak të imunitetit që gëzon njëra prej palëve në mosmarrëveshje si subjekt i posaçëm parashikuar në një marrëveshje/ konvente dy ose shumëpalëshe, çështja mund të hyjë në juridiksionin e gjykatave shqiptare në rast se pala heq dorë nga imuniteti.

Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike parashikon nocionin e heqjes dorë nga imuniteti për agjentët diplomatikë, anëtarët e familjes së tyre që jetojnë bashkërisht me ta, si dhe personelin teknik dhe administrativ të misionit si dhe anëtarët e familjeve të tyre. Heqja dorë nga imuniteti, parashikuar në nenet 28 dhe 32 të Konventës në fjalë, i fut ata në juridiksionin e shtetit pritës. I njëjti parim dhe qëndrim konfirmohet edhe në nenin 39/a të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, neni 84 i ligjit nr.10 428,datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”:parashikon se të huajt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave të huaja kur e pranojnë vullnetarisht.

---

<sup>72</sup>MvElhinney kundër Irlandës [GC], nr.31253/96, § 37, ECHR 2001-XI; Manolescu dhe Dobrescu, (dec.), nr.60861/00,§ 80, ECHR 2005-VI; Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006; Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë nr.35720/04 dhe 42832/06, § 44-47 ECHR 2009

Pavarësisht se asnjë prej marrëveshjeve apo ligjeve të mësipërme nuk përcakton formalisht aktin e heqjes dorë, të gjitha konvergojnë në atë se vetëm akti ku vullneti i subjektit për të hequr dorë nga imuniteti është shprehur qartë e fut çështjen në juridiksionin e gjykatave shqiptare.

Pranimi vullnetar i juridiksionit të gjykatave shqiptare duhet të dalë nga shprehja e vullnetit të personit që pranon juridiksionin për gjykimin e çështjes konkrete. Pranimi mund të realizohet edhe pa e shprehur në formë të shkruar ose verbale, por duke u paraqitur nëgjyq dhe duke realizuar të drejtat dhe detyrimet e procesit gjyqësor.

Në një rast të ngjashëm, për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar të gjykata shqiptare, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njëhësues se kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, sipas Marrëveshjes Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.06.1992, janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pavarësisht nga ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga këto marrëdhënie, përveç rasteve kur është pranuar juridiksioni i gjykatave shqiptare vullnetarisht.<sup>73</sup> Gjithashtu, edhe përfaqësuesit e shteteve të tjera dhe për grupin e tyre të shoqërimit, kur ata qëndrojnë në Shqipëri me ftesë zyrtare të Republikës së Shqipërisë, gjykatat shqiptare nuk ushtrojnë juridiksion. Edhe në këtë rast qëndron përjashtimi në rastet kur pranohet në mënyrë vullnetare juridiksioni i gjykatave shqiptare

Në një vështrim krahasues me rregulloren 1215/2012, vëmë re se çështjet që lidhen me kontratat individuale të punësimit, kur si palë paraqiten punëdhënës që nuk kanë selinë

---

<sup>73</sup> Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011

qëndrore në një nga shtetet e B.E, por kanë një degë ose filial në to, kërkesë padia do të ngrihet në këtë shtet. Një punëdhënës resident në një shtet anëtar mund të paditet në shtetin anëtar ku ka vendbanimin ose në një tjetër shtet anëtar në të cilin punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij, ose në shtetin ku ka kryer punën për herë të fundit. Një nga rrishtë që parashikon rregullorja nr. 1215/2012 është e drejta për të ngritur padi dhe ndaj punëdhënësve që nuk janë rezidentë në B.E. Në këto raste, kërkesë padia mund të ngrihet nga punëmarrësi në shtetin ku punëmarrësi ka kryer zakonisht punën e tij, ose në shtetin ku punëmarrësi ka kryer së fundmi punën e tij. Ndërsa nga ana tjetër, një punëdhënës mund të padisë punëmarrësin vetëm në shtetin në të cilin ky i fundit ka vendbanimin. Ky juridiksion i veçantë, i cili është në mbrojtje të punëmarrësve edhe në rastet kur punëdhënësi nuk është rezidentë në B.E, dhe lejon kërkesë paditëkundër palëve që nuk janë rezidentë në B.E. Ky lloj juridiksioni mund të derogohet vetëm me marrëveshjen e palëve, me kusht që kjo marrëveshje të jetë lidhur pasi ka lindur konflikti dhe i lejon punëmarrësit të hapi proces në një gjykatë tjetër nga këto që parashikohon rregullorja.

#### **4.4 Marrëveshja e juridiksionit sipas legjislacionit shqiptar nën vështimin e rregullores 1 bis të Brukselit.**

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë në nenin 37/2 përcakton: *“Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t’i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim dhe qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”*

Gjithashtu, në nenin 38 të Kodit të Procedurës Civile parashikon: *“Gjykata Shqiptare nuk pushon as pezullon gjykimin kur e njëjta çështje ose një çështje e lidhur me të është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj”*.

Nga dy nenet e sipër përmendura kuptojmë konceptin e derogimit të juridiksionit shqiptar, ose thënë ndryshe kalimin e juridiksionit shqiptar një juridiksioni të huaj.

Nga formulimi i nenit 37/2 arrijmë kuptojmë se: dy persona fizik apo juridik shqiptar nuk kanë mundësi që të lidhin një marrëveshje për kalimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare një shteti të huaj. Por nga ky rregull, bëhet dhe përjashtim, në rastet e një gjykimi me objekt detyrimin ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji dhe një shtetasi shqiptar, i cili nuk ka banim e qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Kështu, rasti i dytë lejon që nëse ka një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, t’i kalohet një juridiksioni të huaj e drejta për gjykimin e një çështjeje të caktuar, por vetëm me kushtin që gjykimi të ketë lidhje me një detyrim mes të huajve ose mes një shtetasi të huaj dhe një shtetasi shqiptar me banim apo qëndrim jashtë territorit të shtetit shqiptar. Mosmarrëveshja në këtë rast ka lindur mes dy të huajve ose mes një të huaji dhe një shtetasi shqiptar pa banim e qëndrim në Shqipëri. Ky është rasti që lejohet derogimi i juridiksionit të gjykatave shqiptare një juridiksioni të huaj. Në të kundërt, në rast se bëhet fjalë për një mosmarrëveshje mes dy shtetasve shqiptar ose një të huaji dhe një shtetatsi shqiptar me banim në Republikën e Shqipërisë nuk mund të derogohet juridiksioni i gjykatave shqiptare.



Ky formulim është në kundërshtim me Rregulloren 1 bis të Brukselit nr.1215/2012 “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare” ku palët lejohen të lidhin një marrëveshje me vullnetin e tyre të lirë për të zgjedhur juridiksionin e duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që ka lindur apo do të lindi në të ardhmen.<sup>74</sup> Ky lloj juridiksioni, i gjykatës së zgjedhur nga palët është ekskluziv dhe prevalon mbi juridiksionin e gjykatës ku është ngritur së pari çështja.

Pra, evidentojmë një mospërputhje mes parashikimeve të Kodit të Procedureës Civile të Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores 1 bis të Brukselit, për çështjen e derogimit të juridiksionit me marrëveshjen e palëve.

Ligjit nr.10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” i cili, ndër të tjera, përmban norma të karakterit procedural. Neni 1/1/b) i ligjit nr.10428, datë 02.06.2011, parashikon edhe juridiksionin dhe rregullat procedurale të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaj.

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë (*parim i përgjithshëm*), por në të njëjtën kohë, gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar eskluziv dhe të veçantë edhe në rastet e parashikuara në Kreun IX, nenet 71-81, të ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

Ligji nr.10 428, datë 2.6.2011 është me i avancuar në respektimin e Parimit të autonomisë së vullnetit të palëve, sepse pranon juridiksionin e caktuar me marrëveshjen e palëve, kur përcaktohet juridiksioni i gjykatave shqiptare, por jo e kundërta, që dy

---

<sup>74</sup> Rregullorja e Këshillit European (EC) nr1215/2012 “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.

shtetas shqiptar ose një i huaj dhe një shtetas shqiptar me banim në Shqipëri të përcaktojnë me marrëveshje juridiksionin e një gjykate europiane. Pra, edhe ky ligj nuk e lejon derogimin e juridiksionit shqiptar dhe kalimin e tij gjykatave të huaja, por njeh dhe pranon Marrëveshjen e Juridiksionit që i kalon gjykatave shqiptare juridiksionin ndërkombëtar mbi një çështje të caktuar.

Ligji nr.10 428, datë 2.6.2011 pranon juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare kur palët me marrëveshje kanë zgjedhur që çështja të zgjidhet nga gjykatat shqiptare. Këto palë mund të jenë të huaj, ose mes të huajve dhe shtetasve shqiptar me banim ose pa banim në Republikën e Shqipërisë. Juridiksioni shqiptar i zgjedhur me marrëveshje është i vlefshëm kur marrëveshja është lidhur me shkrim, por pranohet si formë e marrëveshjes dhe forma verbale, por duke u vërtetuar me shkrim. Kjo marrëveshje që lidhet me vullnetin e lirë të palëve, për t'ia nënshtruar mosmarrëveshjen e tyre gjykatave shqiptare duhet të jetë në përputhje me zakonet ndërkombëtare. Po të krahasojmë formën e pranuar të marrëveshjes së juridiksionit nga ligji nr 10 428 dhe Rregullores 1 bis të Brukselit do të shohim që kanë ngjashmëri pasi rregullorja njeh formën e shkruar, ose verbale nëse provohet me shkrim ekzistenca e marrëveshjes dhe e vullnetit të palëve. Një tjetër opsion për sa i përket formës së saj është forma që përputhet me praktikën që palët kanë vendosur mes tyre apo standartet në fushën tregtare ndërkombëtare, ose në një formë e cila është e zakonshme dhe e njohur në këtë fushë. Gjithashtu, edhe çdo komunikim tjetër në rrugë elektronike që bën regjistrimin e marrëveshjes së derogimit të juridiksionit do të jetë ekuivalente me formën e shkruar të marrëveshjes dhe si pasojë kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për sa i përket një elementi të rëndësishëm të saj, formës së marrëveshjes juridike.

Në funksion të këtyre formulimeve është dhe koncepti i shprehur në nenin 38 të Kodit të Procedurës Civile, se gjykata shqiptare nuk pushon as pezullon gjykimin kur kjo çështje po shqyrtohet nga një gjykatë e huaj. Ndërsa në nenin 31 (2) të Rregullores 1215/2012, parashikohet se kur një gjykatë e një shteti anëtar në të cilën palët kanë transferuar juridiksionin ka filluar procedurat, çdo gjykatë tjetër duhet të pezulloj procesin dhe të vendosin në favor të gjykatës që kanë përzgjedhur palët edhe nëse nuk është ajo gjykata ku është filluar së pari çështja. Me fjalë të tjera, gjykata në të cilën palët me marrëveshje kanë transferuar juridiksionin edhe nëse nuk është gjykata e parë ku është depozituar kërkesë padia, është gjykata që ka juridiksion ekskluziv. Të gjitha gjykatat e tjera duhet të mohojnë juridiksionin e tyre dhe të vendosin në favor të juridiksionit të gjykatës së përzgjedhur nga palët.

Legjislacioni shqiptar, më konkretisht Kodi i Procedurës Civile nuk parashikon që gjykata shqiptare të pezullojë apo të pushojë gjykimin e një mosmarrëveshjeje kur kjo e fundit ose një çështje e lidhur me të është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Pra edhe në rastet kur faktet lidhëse me çështjen objekt gjykimi kanë lidhje me një tjetër çështje që i përket një mosmarrëveshjeje që i përket juridiksionit të huaj. Këtë nen e shoh si shprehje të sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, por që duhet ndryshuar për të qënë në koherencë me ndryshimet ekonomike e tregtare të viteve të fundit, nevojës për rritjen e investimeve të huaja, marrëveshjeve të shumta që lidhin shtetasit shqiptar, qofshin këta persona juridik apo fizik, me shtetasit e huaj, lehtësimin të qarkullimit civil të mallrave e shërbimeve, si dhe për t'i dhënë mundësi shtetasve shqiptar qofshin këta persona fizik apo juridik të hyjnë në marrdhënie tregtare apo civile me shtetasit e huaj të barabarte dhe për sa i përket çështjes së përzgjedhjes së juridiksionit të gjykatës së shtetit anëtar që u duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë

lindur apo që mund të lindin në të ardhmen mes palëve. Neni 38 i Kodit të Procedurës Civile është shprehje e sovranitetit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, organet gjyqësore të së cilës ushtrojnë sovranitetin brenda territorit të saj dhe formalisht e juridikisht, por as faktikisht, nuk ndikohen nga asnjë veprimtari e organeve gjyqësore të një shteti të huaj, pasi këto organe gjyqësore të huaja realizojnë të njëjtën gjë që bën edhe gjykata shqiptare, pra ushtrojnë funksione juridiksionale që nuk janë gjë tjetër veçse shprehje e sovranitetit shtetëror të shtetit të cilit ato i përkasin. (Tafaj, Vokshi, 2011:221) Këto dispozita mund të duken pak arkaike për kushtet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. (Tafaj, Vokshi, 2011:222)

Pra, siç vëmë re, ky është një formulim krejt i kundërt me nenin 38 të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, i cili nuk parashikon pezullimin e gjykimit nga ana e gjykatave shqiptare, kur një çështje e me të njëjtat palë, objekt dhe shkak është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Nuk parashikohet nga legjislacioni shqiptar që juridiksioni shqiptar t'i kalohet një juridiksioni të një shteti të huaj. Në analizë të kësaj dispozitë, vlerësohet se Gjykata Shqiptare nuk kanë detyrimin për të pezulluar ose pushuar një proces gjyqësor nëse është nisur të gjykohej pranë një gjykate të huaj.

Në funksion të përmirësimit të legjislacionit shqiptar, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar disa konventa ndërkombëtare, të cilat janë bërë tashmë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe krahas legjislacionit kombëtar, i cili parashikon rregulla mbi juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare, zbaton gjithashtu edhe të drejtën ndërkombëtare. Republika e Shqipërisë është shtet palë i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Në analizë të përmbajtjes së nenit 20, të Ligjit Nr. 10182, datë 29.10.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e

Konferencës së Hagës “Për procedurën civile”, rezulton se shtetet kontraktuese mund të refuzojnë një padi të paraqitur para tyre ose mund të shtyjnë në kohë shqyrtimin e kësaj padie kur procedime të tjera midis të njëjtave palë, bazuar në të njëjtat fakte dhe duke pasur të njëjtin qëllim, janë duke u shqyrtuar në një gjykatë të një shteti tjetër, *vetëm në rast se shtetet kontraktuese kanë lidhur një marrëveshje plotësuese për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të dhëna` në këto shtete kontraktuese.*<sup>75</sup>

Republika e Shqipërisë nëpërmjet Ligjit Nr.9590, datë 27.07.2006, ka ratifikuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare. Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 6 dhe 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Të gjitha fazat e procesit legjislativ, duke nisur me formulimin e politikave dhe përcaktimin e instrumentit rregullues (*ligj*) deri tek hartimi i tekstit të aktit dhe miratimit të tij në Kuvend janë pjesë e procesit të adresimit të kërkesave të *Acquis Communautaire* (EU) në legjislacionin shqiptar.

Në vendet e Bashkimit Evropian gjykatat janë të autorizuar të marrin masat e nevojshme, përfshirë këtu masat për shmangien e gjyqvarësisë për çështje të cilat do të gjykohen nga gjykata e një shteti tjetër anëtar.<sup>76</sup> Rregullorja 1 bis e Brukselit “Për

---

<sup>75</sup>Ligji Nr. 10182, datë 29.10.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Konferencës së Hagës “Për procedurën civile”, neni 20 dhe 21.

<sup>76</sup>Seksioni 9, gjyqëvarësia dhe faktet lidhëse (*lis pendens – related actions*) Rregullore e Këshillit Evropian (KE) nr. 1215/2012, “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare” (Brussels 1 bis Regulation, “On jurisdiction and on recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters”, (EC) nr. 1215/2012.

juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare” zbatohet drejtëpërdrejtë në të gjithë territorin e vendeve të shteteve anëtare dhe ka efekt të detyrueshëm.

Pavarësisht se Republika e Shqipërisë ende nuk është bërë anëtar i Bashkimit Evropian me të drejta të plota, rregulloret e miratuara prej tyre janë udhërrëfyese në praktikën tonë ligjore.<sup>77</sup>

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të ndryshme me Kodin e Procedurës Civile dhe me ligjin nr.10 428, datë 2.6.2011”Për të drejtën ndërkombëtare private”, por me pranimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zgjidhja për mospërputhjen do të jepet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 122/3 parashikohet se: “Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtëpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj.”

Rregullorja 1 bis e Brukselit nr 1215/2012 nuk ka efekt detyrues për Shqipërinë, por njohja e saj i shërben përafrimit të legjislacionit dhe përshtatjes së tij me kushtet aktuale të zhvillimit të ekonomisë dhe shoqërisë, investimeve të huaja në Shqipëri, si dhe praktikantëve të së drejtës për t’u përgatitur për një zbatim sa më të mirë të këtyre normave dhe të tjerave që do të miratohen kur Shqipëria të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian.

---

<sup>77</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë nr.94, datë 23.3.2016

#### **4.5 Parimi i autonomisë së vullnetit në këndvështrim krahasues me rregulloren 1 bis të Brukselit nr. 1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve civile dhe tregtare”**

Ligji nr.10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” neni 73, pika 1 parashikon:

*“Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare.”*

Ky ligj është më i përparuar se Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë përse i përket pranimi të parimit të autonomisë së vullnetit të palëve në aspektin e përcaktimit të juridiksionit me marrëveshjen e palëve, sepse pranon juridiksionin e caktuar me marrëveshjen e palëve, kur përcaktohet juridiksioni i gjykatave shqiptare, por jo e kundërta, që dy shtetas shqiptar ose një i huaj dhe një shtetas shqiptar me banim në Shqipëri të përcaktojnë me marrëveshje juridiksionin e një gjykate europiane. Pra, edhe ky ligj nuk e lejon derogimin e juridiksionit shqiptar dhe kalimin e tij gjykatave të huaja, por njeh dhe pranon “Marrëveshjen e Juridiksionit” që i kalon gjykatave shqiptare juridiksionin ndërkombëtar mbi një çështje të caktuar.

Legjislacioni shqiptar pranon juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare kur palët me marrëveshje kanë zgjedhur që çështja të zgjidhet nga gjykatat shqiptare. Kjo marrëveshje është e njëjtë me marrëveshjen që parashikohet nga Rregullorja e Brukselit nr.1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e cila i lejon subjekteve të zgjedhin atë juridiksion që i duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e konflikteve që kanë lindur ose do të lindin në të ardhmen.

Marrëveshja e juridiksionit e njohur nga legjislacioni shqiptar ka ngjashmëri me atë të parashikuar nga rregullorja përsa i përket formës së marrëveshjes, por ndryshon objekti dhe subjektet që lejohen të lidhin këtë lloj marrëveshjeje. Subjektet që mund të lidhin marrëveshjen e juridiksionit janë çdo person fizik apo juridik rezident ose jo i Bashkimit European. Objekti i Marrëveshjes së Juridiksionit sipas rregullores është kalimi i juridiksionit me marrëveshje një shteti anëtar të Bashkimit European për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme. Ndërsa subjektet që mund të lidhin një marrëveshje juridiksioni sipas legjislacionit shqiptar, ligjit nr.10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” neni 73 dhe nenit 37 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë janë persona fizik apo juridik të huaj, ose mes të huajve dhe shtetasve shqiptar me banim ose pa banim në Republikën e Shqipërisë.

Juridiksioni shqiptar i zgjedhur me marrëveshje është i vlefshëm kur marrëveshja është lidhur me shkrim, por pranohet si formë e marrëveshjes dhe forma verbale, por duke u vërtetuar me shkrim. Kjo marrëveshje që lidhet me vullnetin e lirë të palëve, për t’ia nënshtruar mosmarrëveshjen e tyre gjykatave shqiptare duhet të jetë në përputhje me zakonet ndërkombëtare. Po të krahasojmë formën e pranuar të marrëveshjes së juridiksionit nga ligji nr 10 428 dhe Rregullores 1 bis të Brukselit do të shohim që kanë ngjashmëri pasi rregullorja njih formën e shkruar, ose verbale nëse provohet me shkrim ekzistenca e marrëveshjes dhe e vullnetit të palëve. Palët mund të vendosin klauzola në kuadër të lirisë kontraktuale. Për aspektet e parregulluara ose të rregulluara jo në mënyrë të plotë klauzolat kontraktuale aplikohen me lex contractus, i cili mund të jetë sipas rastit lex voluntaris, lex loci contratus, ose një normë konflikti ndihmëse. Në raste të tjera kur është e nevojshme, aplikohet lex venditoris, pasi ai nuk mund të zënvendësohet me një kriter tjetër të zgjedhur nga palët, në bazë të parimit të



autonomisë së vullnetit, për shkak të karakterit imperativ. Gjykata shqiptare ka juridiksion ndërkombëtar nëse i padituri e pranon vullnetarisht juridiksonin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare. Pranim vullnetar kuptojmë paraqitjen në seancë gjyqësore pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit të gjykatave shqiptare.<sup>78</sup> Pranimi vullnetar i juridiksionit të gjykatave shqiptare duhet të dalë nga shprehja e vullnetit të personit që pranon juridiksonin për gjykimin e çështjes konkrete. Pranimi mund të realizohet edhe pa e shprehur në formë të shkruar ose verbale, por duke u paraqitur nëgjyq dhe duke realizuar të drejtat dhe detyrimet e procesit gjyqësor.<sup>79</sup>

Parimi i autonomisë së vullnetit ka një kufizim, i cili pavarësisht nga modalitetet apo shkallët e ndryshme të tij, qëndron në të gjitha sistemet e së drejtës pozitive të botës, pra ekziston në çdo rend juridik, përfshirë edhe rendin tonë që është klauzola e rendit publik. (Kalia,2010:147)

Në përgjithësi, pranohet se në nocionin e rendit publik përfshihen parimet themelore për sistemin e së drejtës së gjykatës (lex fori), që përjashtojnë aplikimin e rregullave të huaja edhe pse këto të fundit janë thirrur për tu zbatuar nga normat e konfliktit të gjykatës, duke mbrojtur interesat e shtetit respektiv. Rendi publik në të drejtën e brendshme tregon limitet e hapësirës së lënë iniciativës së lirë juridike të palëve, ndërsa rendi juridik në të drejtën ndërkombëtare private tregon, pikërisht limitet apo hapësirën e aplikimit të ligjit të huaj, duke u konsideruar si një “korrektim” në aplikimin e ligjit të huaj, të deklaruar kompetent nga normat e konfliktit. Ai mund të ndërhyjë si në rastin e konfliktit të ligjeve në kohë dhe në rastet e konflikteve të ligjeve në hapësirë në intensitete të ndryshme.

---

<sup>78</sup>Neni 73,pika 3 e ligjit nr.10428,dt.2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

<sup>79</sup>Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011

Rendi publik në të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare private bazohet në të drejtën e brendshme, pasi bazohet në mënyrën si konceptohen interesat themelore të shtetit, nga të cilat nuk mund të derogohet, në marrëdhëniet juridike të brendshme dhe në ato që kanë elementë të huaj. (Qoku,2016:149)

Në disa burime ndërkombëtare përmendet shprehimisht rendi publik. Kështu, në Konventën e Neë Yorkut të vitit 1958 parashikon se mund të përdoret rendi publik për të refuzuar njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit. Neni 5 pika b parashikon: *“Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi konstaton se:*

- a) Objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi,ose*
- b) Njohja dhe ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi.<sup>80</sup>*

Ndërsa Konventa Europiane e Arbitrazhit Ndërkombëtar e Gjenevës e vitit 1961 nuk e parashikon shprehimisht rendin publik mes shkaqeve ligjore të refuzimit të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja të arbitrazhit.

Klauzola e rendit publik është sanksionuar si parim i përgjithshëm përjashtimor edhe në legjislacionin tonë ndërkombëtar privat. Konkretisht në nenin 7 të ligjit nr.10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” parashikohet se: *“Ligji i huaj nuk zbatohet kur efektet e tij janë dukshëm në kundërshtim me rendin publik apo mund të*

---

<sup>80</sup> Konventa e Nju Jorkut, “Për njohjen dhe zbatimin e arbitrazhit të huaj”, 1958,

*sjellin pasoja, të cilat janë haptazi të papajtueshme me parimet themelore, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin shqiptar. Në rast papajtueshmërie, zbatohet një dispozitë tjetër e përshtatshme, që i përket së drejtës së shtetit të huaj dhe, kur kjo mungon zbatohet ligji shqiptar.”*

Në përputhje me këtë nen, aplikimi i ligjit të huaj mënjanohet nëse çënohet rendi publik në të drejtën ndërkombëtare private

Klauzola e rendit publik si kufizim parashikohet dhe në nenin 220 të K.Pr.Civile, me shprehjen: “...përpjekje të pasuksesshme të gjykatës...” nënkuptohet jo vetëm pamundësia efektive e moszbatimit të së drejtës së huaj, por dhe pamundësia e aplikimit të saj për shkak të përplasjes me norma imperative të së drejtës së brendshme.<sup>81</sup>

Gjithashtu edhe nenet 513, 514 të Kodit të Procedurës Penale parashkojnë dispozitat civile në një vendim penal të huaj, do të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë vetëm nëse nuk janë në kundërshtim me rendin publik në të drejtën ndërkombëtare private. Përmbajtjen e normave të rendit publik e përcaktojnë parimet e sistemit shqiptar të së drejtës. Përcaktimi i çështjeve konkrete kur ndërhyrë rendi publik mbetet në diskrecionin e gjykatës. Nëse është rasti, rendi publik në marrëdhëniet juridike me elementë të huaj nuk do të ngrihet kundër ligjit të huaj, por kundër aplikimit të ligjit të huaj. Neni 7 i ligjit nr.10428/2011 parashikon dhe mundësinë e anashkalimit të dispozitës së ligjit të huaj, që është përzgjedhur për tu zbatuar, e cila bie ndesh me rendin publik të Republikës së Shqipërisë, dhe tendencën për të gjetur një dispozitë tjetër të zbatueshme të ligjit të huaj dhe në pamundësi ta arritjes së këtij qëllimi do të zbatohet ligji shqiptar.

---

<sup>81</sup>Neni 220 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

#### 4.5.1 Karakteri i rendit publik si kufizim ndaj autonomisë së vullnetit.

Rendi publik shfaqet si “rregullator” në aplikimin e ligjit të huaj në kuptimin që i krijon gjyqtarit mundësinë e vlerësimit nëse një ligj apo normë juridike bie ndesh me interesat e shtetit të cilit i përket. Ai ka një karakter të papërcaktuar, është në diskrecion të gjykatës që të përcaktojë nëse ligji i huaj që do të zbatohet në çështjen konkrete bie ndesh me rendin publik. Përmbajtja përcaktohet çdo herë që një çështje vjen për zgjidhje përpara gjykatave kompetente. Kështu, rendi publik na shfaqet si një mjet kufizimi apo përcaktimi në lidhje me masën që do të aplikohet ligji i huaj.

Rendi publik është i ndryshëm në shtete të ndryshme nga ana përmbajtësore. P.sh ka shtete që nuk e pranojnë divorcin dhe për këtë rast është shprehur neni 25 pika 2 e ligjit nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombetare private”: *“1. Zgjidhja e martesës rregullohet nga ligji i shtetësisë së bashkëshortëve në kohën e paraqitjes së padisë. Kur bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme, zgjidhja e martesës rregullohet nga ligji i shtetit, në territorin e të cilit bashkëshortët kanë vendqëndrimin e zakonshëm të tyre ose vendqëndrimin e fundit të përbashkët në kohën e paraqitjes së padisë.*

*2. Kur ligji i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, nuk lejon zgjidhjen e martesës, ajo bëhet në përputhje me ligjin shqiptar, nëse kërkuese është një shtetas shqiptar ose ka qënë shtetas shqiptar në kohën e lidhjes së martesës”*

Kjo do të thotë që edhe në rastet kur duhet të aplikohet ligji i huaj, sipas të drejtës ndërkombëtare private, në rast se ligji i huaj nuk e pranon divorcin do të aplikohet ligji shqiptar në rastet kur njëri nga bashkëshortët është shtetas shqiptar, ose ka qënë i tillë në datën e lidhjes së martesës. Rendi publik është i ndryshëm jo vetëm në shtete të ndryshme, pra sipas kriterit të shtetësisë, por dhe në hapësira kohore të ndryshme.

Përmbajtja e rendit publik mund të ndryshojë nëse modifikohet një nga ligjet aktuale. Kjo do të thotë që ligji i huaj edhe pse deri në atë moment mund të mos binte në kundërshtim me rendin publik, me ndryshimet që mund të pësojë ligji, bie ndesh me rendin publik. Rendi publik përfaqëson pra një karakter (natyrë) lëvizës, jo vetëm nga shteti në shtetin tjetër, por edhe në kohë në rastin e të njëjtin shtet. (Qoku,2016:426)

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme e rendit publik është aktualiteti i tij. Kjo do të thotë që rendi publik është aktual, pra do të merret parasysh rendi publik në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes, jo në momentin e krijimit të marrëdhënies juridike. Kështu, veprimi juridik që kryhet jashtë shtetit nuk do të konsiderohet që bie ndesh me rendin juridik nëse ndryshohet ligji i forit duke u bërë i ngashëm me ligjin e huaj. Kjo do të thotë që nëse nga momenti i lindjes së marrëdhënies juridike deri në momentin e lindjes së konfliktit mes palëve, është ndryshuar përmbajtja e rendit publik, nuk merret parasysh përmbajtja e tij që nga momenti i lindjes së raportit juridik, por momenti deciziv është ai i lindjes së konfliktit. Përkundrazi, nëse ndërkohë ka pësuar ndryshime norma e konfliktit, në mungesë të dispozitave ligjore të kundërta, merret në konsideratë norma e konfliktit në fuqi në datën e lidhjes së aktit juridik, për të cilin flitet. (Qoku,2016:435)

Një karakteristikë tjetër e rendit publik është që ka një fushë veprimi të zgjeruar. Kështu, ai përdoret në të gjitha fushat e të drejtës ndërkombëtare, pra nuk mund të flasim për një kategori ligjesh, të cilat i përkasin rendit publik, me përjashtim të ligjeve që kanë pikërisht këtë karakter. Praktika juridike ndërkombëtare ka treguar se, rendi publik është përdorur më shumë në fushën e statusit personal dhe të marrëdhënieve familjare. Zbatimi i rendit publik nënëkupton, dallime esenciale midis ligjit të huaj kompetent në mënyrë normale dhe ligjit të forit, në mënyrë që ky i fundit të mos

pranojë rezultatin në të cilin arrihet, me aplikimin e ligjit të parë. (Qoku,2016:436)

Përmbajtja e rendit publik nuk është e përcaktuar në dispozita ligjore, por përcaktohet nga juridiksioni gjyqësorë rast pas rasti. Pra përcaktimi i rendit publik është lënë në diskrecion të gjykatës për të vlerësuar nëse ligji i aplikueshëm është apo jo në kundërshtim me rendin publik. Karakteristikë e rendit publik është që zbatohet në fushën e lindjes së marrëdhënies juridike, në kuadrin e krijimit të të drejtave. Në këtë kuptim, konsiderohet se rendi publik ka efekt negativ, sepse shmang aplikimin e ligjit të huaj, dhe duke shmangur këtë të fundit, ai shmang dhe raportin juridik, i cili në këtë rast nuk mund të lind. Për shëmbull, dy të rinjë ligji i të cilëve nuk e pranon martesën për shkaqe diskriminuese, do të mund të martohen në një shtet tjetër, i cili nuk pranon diskriminimin si pengesë ligjore. Në këtë rast, nëse sipas ligjit të tyre nacional ata nuk mund të martohen, sipas ligjit të shtetit të huaj ata mund të kryejnë martesë sepse rendi publik i atij shteti e lejon dhe do të aplikohet ligji i forit. Kështu, në vend të ligjit të huaj të shmangur, do të aplikohet ligji i forit. Aplikimi i ligjit të forit në vend të ligjit normal kompetent bëhet, pasi dallimi midis efektit negativ dhe pozitiv është më shumë sipërfaqësorë se sa objektiv, duke marrë parasysh se në çdo konflikt duhet dhënë një zgjidhje nga ana e gjykatës, dhe në rastet kur ligji i huaj konsiderohet nga gjykata se është në kundërshtim me rendin publik, për zgjidhjen e çështjes do të zbatohet ligji i forit, për shkak të efektit pozitiv që ka në mbrojtjen e të drejtave të palëve dhe pasojave që sjell. Kjo është e sanksionuar në nenin 7 të ligjit nr. 10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare”: *“Ligji i huaj nuk zbatohet kur efektet e zbatimit të tij janë dukshëm në kundërshtim me rendin publik apo mund të sjellin pasoja, të cilat janë haptazi të papajtueshme me parimet themelore, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin shqiptar. Në rast papajtueshmërie, zbatohet një dispozitë tjetër e përshtatshme, që*

*i përket të drejtës së shtetit të huaj dhe, kur kjo mungon, zbatohet ligji shqiptar.*” Në interpretim të nenit të sipërcituar, aplikimi i ligjit të huaj shmanget, nëse shkelet rendi publik, përmbajtja e të cilit do të përcaktohet rast pas rasti nga gjykata në zgjedhjen e çështjeve konkrete. Në rastet e mos aplikimi të ligjit të huaj do të zbatohet ligji shqiptar. Zbatimi i rendit publik ka karakter përjashtimor, do të thotë që edhe zëvendësimi i ligjit të forit me ligjin e huaj duhet të jetë i limituar, pra vetëm për ato dispozita të ligjit të huaj të cilat bien ndesh me rendin publik. Rezultati në të cilin arrihet, duhet të ketë një karakter unitar, pra të mos jetë fjala për një kundërshtim apo keqkuptim midis dispozitave ligjore të aplikueshme: të forit nga një anë dhe ato të huaja nga ana tjetër për të njëjtën çështje. Përcaktimi i shtrirjes dhe zëvendësimi i ligjit të forit me atë të huaj duke respektuar kufizimet e treguara më lart, do të përcaktohet rast pas rasti nga ana e gjykatës kompetente. Kështu, roli i gjykatës është shumë i rëndësishëm sepse vendos jo vetëm nëse përmbajtja e ligjit të huaj bie apo jo në kundërshtim me rendin publik, në çështjen konkrete, por shërben edhe si një rast afirmues, në lidhje me faktin, se cilat janë efektet ligjore të zbatimit të rendit publik në çështjen në fjalë. Efektet e zbatimit të rendit publik janë më të theksuara në aspektin e zbatimit të tij në fushën e të drejtave të fituara. Të drejtat që kanë lindur në një shtet të huaj do të njihihen edhe sipas ligjit të forit. Për shëmbull, një martesë e lidhur midis dy personave sipas ligjit të huaj, do të meret parasysh edhe sipas ligjit të forit, në kushtet kur ky i fundit nuk e lejon poligaminë dhe e konsideron pengesë ligjore martesën e mëparshme. Efektet e të drejtave të fituara tashmë jashtë vendit bazuar në ligjin e huaj, nuk bëhet automatikisht ipso jure. Është gjykata që përcakton në secilin rast konkret, nëse të drejtat e fituara jashtë vendit, do të sjellin pasoja juridike edhe në shtetin e forit, dhe në secilin rast duhet parë masa në të cilin ato këto pasoja do të prodhohen. Kështu, rezulton se një e

drejtë e fituar jashtë vendit do të sjellë pasoja edhe në shtetin e forit nëse gjykata vendos për efektin zbutës të rendit publik në rastin në fjalë. Në një tjetër rast hipotetik, ku marrëdhënia juridike lind në vendin e forit, por efektet i jep jashtë vendit, është në diskrecion të organeve gjyqësore të huaja të përcaktojnë aplikimin apo jo të klauzolës së rendit publik, efektet e aplikimit të rendit publik, si dhe njohjen apo jo të pasojave juridike që rrjedhin nga marrëdhënia juridike konkrete. Për ta konkretizuar me një shëmbull, dy shtetas lidhin martesë sipas ligjit të huaj, dhe në rast se ngrihet çështja e vlefshmërisë së martesës së tyre, për shëmbull në Republikën e Shqipërisë, vendimi nuk do të jepet duke u aplikuar ligji shqiptar, por do të merret parasysh ligji i vendit ku është lidhur martesë. Por në rastin hipotetik se, ligji personal i bashkëshortëve njihet diskriminimin për shkaqe fetare, ky i fundit bie ndesh me parimet e të drejtës shqiptare, të përcaktuara në Kushtetutë dhe akte ligjore të tjera, të cilat nuk njohin në asnjë rast diskriminimin për shkaqe fetare dhe as për shkaqe të tjera, nuk do të merret parasysh ligji i huaj, por ligji shqiptar, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Zbatimi i klauzolës së rendit publik në të drejtën shqiptare shmang ligjin e huaj kur bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës shqiptare. Por, kjo nuk do të thotë që gjithmonë në këto raste automatikisht do të zbatohet ligji shqiptar, sepse mund të zbatohet, sipas rastit, një dispozitë tjetër e përshtatshme që i përket të drejtës së shtetit të huaj, ose të shmanget ligji personal dhe në vend të tij të zbatohet ligji i vendit të lidhjes, pra të zbatohet një tjetër kriter lidhjeje. Efektet e zbatimit të rendit publik do të merren parasysh, nëse rendi publik i këtij shtetit nuk i kundërvihet njohjes së efekteve dhe pasojave juridike, dhe e kundërta, efektet dhe pasojat juridike që vijnë si pasojë e krijimit të marrëdhënies juridike jashtë shtetit, bazuar në lex nationalis, nuk do të njihen në shtetin e forit, nëse rendi publik i këtij të



fundit i kundërvihet njohjes së efekteve të përmendura. Efektet e zbatimit të rendit publik në një shtet, nuk prodhohen për shkak të autoritetit të tij në një shtet tjetër, por vetëm sepse rendi publik i shtetit të fundit, lejon në kushtet e treguara, ruajtjen e efekteve të prodhuara. Gjithçka varet nga rendi publik i vendit ku do të njihen efektet e rendit publik të ngritura në Shqipëri, zgjidhja është në përputhje me karakterin nacional të rendit publik. (Qoku,2016:439)

#### **4.5.2 Dallimet e rendit publik nga institutet e tjera.**

Klauzola e rendit publik duhet të dallohet nga instituti i shmangies së ligjit. Si shmangia e ligjit dhe klauzola e rendit publik çojnë në pushim të veprimit të normës së konfliktit, por dallohen nga njëra tjetra për arsye se klauzola e rendit publik është e lidhur ngushtë me motive objektive, d.m.th me përmbajtjen e ligjit të huaj, e cila pushon së qëni e aplikueshme në ato raste kur ligji i huaj prodhon efekte të kundërta me konceptet themelore të së drejtës së brendshme.(Kalia,2010:157) Shmangia e ligjit nga personat e interesuar bëhet me vullnetin e tyre të lirë, ku për motive subjektive këto subjekte shmangin zbatimin e një ligji që duhet të aplikohet dhe në vend të tij kërkojnë aplikimin e një ligji tjetër. Pra, këto dy institute dallojnë nga njëri tjetri nga motivet dhe pasojat që sjellin. Shmangia e ligjit në të drejtën ndërkombëtare, mund të përcaktohet si “vënie në lojë” me vullnetin e palëve, e një kriteri lidhjeje që përcakton aplikimin e ligjit të ndryshëm nga ai që duhet të aplikohet në të vërtetë. Ngjashëm me këtë parashikim, ishte situata sipas Rregullores së Brukselit nr.44/ 2001 me konceptin e të ashtquajturit “italian torpedo”, në rastet kur palët me marrëveshje vendosnin juridiksionin e një shteti të caktuar dhe më pas kërkesë padinë e dorëzonin në një tjetër shtet anëtarë të Bashkimit Europian. Kjo bëhej sepse bazuar në Rregulloren 44/2001, i jepej përparësi

gjykatës ku është filluar së pari çështja, në krahasim me gjykatën e përzgjedhur me marrëveshjen e palëve. Në këto raste hasej një konflikt juridiksional dhe përplasje të neneve 23 dhe 27 të Rregullores së Këshillit Europian nr. 44/2001 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” ku neni 23 i saj lejonte zgjedhjen e juridiksionit me marrëveshjen e palëve dhe lejonte që çështja të gjykohej nga gjykata e cila është zgjedhur nga vete palët në klauzolën e marrëveshjes, ndërsa neni 27 juridiksonin ia kalonte gjykatës në të cilën është depozituar më parë dhe ka filluar të gjykohej çështja. Ky mekanizëm çoi në krijimin e një klauzole juridiksionale të papërcaktuar, ku palët “vraponin” për të dërguar çështjen e tyre në gjykatën e preferuar, në mënyrë që të kishin përfitime. Ky lloj abuzimi me rregullat e juridiksionit është i njohur ndryshe si “Italian torpedo”.<sup>82</sup> Me miratimin e rregullores 1 bis të Brukselit nuk është më e mundur shmangia e ligjit, pasi i jep përparsi gjykatës të zgjedhur nga palët, mbi çdo gjykatë tjetër pavarësisht se ku kanë filluar së pari procedurat, në ndryshim nga rregullorja 44/2001 e cila i jepte përparësi gjykatës ku është filluar së pari çështja në krahasim me gjykatën e përzgjedhur nga vetë palët.<sup>83</sup> Kjo procedurë është e ngjashme me konceptin e shmangies së ligjit. Shmangia qëndron në qëllimin e palëve të një marrëdhënieje për t’i shpëtuar zbatimit të dispozitave të ligjit që duhet të aplikohet në fakt, duke bërë kështu të mundur rregullimin e marrëdhënies juridike në bazë të një ligji tjetër, të cilin këto palë e vlerësojnë si më të favorshëm. (Kalia,2010:147) Kështu, palët me vullnetin e tyre shmangin zbatimin e një ligji që duhet të aplikohet dhe në vënd të tij kërkojnë aplikimin e një ligji tjetër.

---

<sup>82</sup> [http://www.lexology.com/library/detail,](http://www.lexology.com/library/detail/?title=Gómez-Acebo & Pombo Abogados - Miguel Troncoso Ferrer) Gómez-Acebo & Pombo Abogados - Miguel Troncoso Ferrer

<sup>83</sup> Neni 27, pika 1 e rregullores nr.1215/2012, “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.

Gjithashtu, rendi publik dallohet dhe nga instituti i referimit dhe rireferimit. Referimi përcaktohet në nenin 3 të ligjit nr.10428/2011: *“Kur ligji referon në ligjin e një shteti tjetër, zbatohen edhe rregullat e së drejtës private ndërkombëtare të atij shteti. Kur rregullat e atij shteti referojnë në ligjin shqiptar, zbatohen rregullat e këtij të fundit, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Kur ligji i një shteti të huaj referon në ligjin e një shteti të tretë, zbatohet ligji i këtij të fundit.”*

Rasti i referimit është atëherë kur kërkohet nga normat e konfliktit aplikimi i një rendi të huaj juridik. Do të ndodhemi në kushtet e referimit sa herë të kemi të bëjmë me thirrjen për aplikim të së drejtës së një shteti të huaj, për të përcaktuar saktë se cili është rendi juridik që mund të deklarohet i aplikueshëm për të zgjidhur një rast të dhënë. Për shëmbull, neni 11 i ligjit nr.10428/2012 “Për të drejtën ndërkombëtare private” parashikon: *“Zotësia për të vepruar e personit fizik dhe kufizimi apo heqja e zotësisë për të vepruar rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ai ka.”* Kështu, shohim që ky nen referon të ligji i shtetësisë së personit fizik të huaj.

Gjithashtu, rendi publik dallon dhe nga rireferimi, sepse rireferimi presupozon një moskoordinim midis normave të konfliktit të forit dhe normave të konfliktit të huaja, të cilat përcaktojnë konfliktin negativ të ligjeve, ndërkohë që rendi publik presupozon jo vetëm një moskoordinim, por dhe dallime esenciale, parimore, midis ligjit material të forit dhe ligjit të huaj. Kështu, dallimi i referohet në rradhë të parë, normave midis të cilave nuk ekziston koordinimi dhe në rradhë të dytë, në masën apo intensitetin e moskoordinimit midis këtyre dy situatave.(Qoku,2016:432)

Për ta ilustruar, rireferim kemi atëherë kur normat e së drejtës ndërkombëtare të shtetit A, kërkojnë aplikimin e së drejtës së shtetit B, përfshirë dhe normat e së drejtës

ndërkombëtare private të këtij të fundit. Këto të fundit nga ana e tyre, kërkojnë aplikimin e të drejtës së shtetit A.

#### **4.6 Kërkesat për masat e sigurimit të padisë dhe ngjashmëritë me legjislacionin shqiptar.**

Qëllimi i marrjes së masës për sigurimin e padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe rregullores 1215/2012 është jo vetëm siguri i së drejtës, e cila përbën dhe tërësinë e kërkimeve që do të parashtrojë paditësi në padinë e tij, por në të njëjtën kohë dhe ajo që është më e rëndësishmja, është që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor, i cili do të realizohet mes palëve në të ardhmen. Në mënyrë që kjo e drejtë të cilën paditësi kërkon të realizojë dhe të njohë nëpërmjet një procesi gjyqësor, të mos jetë e kërcënuar nga një dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, dhe që vendimi përfundimtar të mos mbetet i paekzekutueshëm.

Në këtë rast shtrohet çështja se Cili shtet ka juridiksion për marrjen e masave të sigurimit të objektit të padisë, kur palët me marrëveshje kanë përcaktuar një tjetër juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes?

Per këtë çështje është shprehur dhe Gjykata e Lartë me Vendimin nr. 22 të Datës 19.01.2011, në të cilin sanksionohet se: ky lloj kërkimi, pavarësisht se është në funksion të padisë së themelit është një kërkim i një lloji të veçantë, i cili ndryshon nga kërkimet që paraqiten në padinë e themelit pasi: qëllimi i vetëm i kërkuesit kur kërkon marrjen e masës për sigurimin e padisë është të sigurojë faktin që vendimi përfundimtar të jetë i ekzekutueshëm dhe që procesi gjyqësor të jetë i efektshëm dhe i dobishëm, kurse me

padinë e themelit paditësi kërkon rivendosjen e të drejtave të tij të pretenduara të cënuara apo të shkelura.

Gjykimi i kërkesës për marrjen e masës për sigurimin e padisë mund të zhvillohet edhe pa pjesëmarrjen e debitorit, për efekt të shpejtësisë që paraqet ky gjykim dhe efektshmërisë që duhet të ketë marrja e kësaj mase, parashikuar kjo dhe në nenin 205 të Kodit të Proçedurës Civile, kurse gjykimi i kërtimeve të themelit që paraqet paditësi me anë të kërkesë padisë nuk mund të zhvillohet pa praninë e debitorit, i cili mban pozicionin proçedural të të paditurit, zhvillimi i proçesit pa praninë e palës së paditur do ta bënte proçesin të cënueshëm dhe jo të rregullt nga pikëpamja ligjore, pasi do të vinte në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 14, 18, 19, 20, 24 etj. të Kodit të Proçedurës Civile. Prandaj, dhe nga pikëpamja formale në rastin e parë kemi paraqitjen e një kërkesë, kurse në rastin e dytë të një kërkesë padie.

Gjykimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë është një proces i shpejtë, ku gjykata nuk shqyrton dhe vlerëson të gjitha provat në mënyrë të hollësishme për të parë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuar, nëse qëndron apo jo e drejta. Në gjykime të këtij lloji, gjykata vetëm heton nëse plotësohen këto kushte: (a) ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në proçesin e gjyimit të padisë, dhe (b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë. E kundërta ndodh në gjykimin e themelit të padisë gjatë të cilës gjykata duke respektuar të gjitha normat proçeduriale shqyrton në themel nëse ekziston apo jo e drejta e pretenduar nga paditësi, nëse kërkimet e tij janë të mbështetura apo jo në prova dhe në ligj.

Ligji nr.10 428, datë02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” në nenin 81 parashikon juridiksionin për masat e sigurimit të padisë: *“Gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat e sigurimit të padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit.”*

Në analizë të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë dhe të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë vihet re se edhe nëse do të ekzistojë një juridiksion gjyqësor i një gjykate të huaj për zgjidhjen e konflikteve midis dy palëve dhe ky juridiksion do të jetë i vlefshëm, juridiksioni i gjykatës së huaj do të jetë vetëm për shqyrtimin e kërtimeve të cilat do të kenë lidhje me zgjidhjen në themel të konflikteve që mund të kenë palët si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve që ata kanë marrë përsipër.

Kërkimet të llojit siç është sigurimi i padisë, mund të bëhen kudo ku i padituri ka pasuritë/asetet e tij.<sup>84</sup>

Vendimi i Gjykatës së Lartë, legjislacioni shqiptar është në përputhje të plotë me nenin 35 të Rregullores së Këshillit European (KE) nr.1215/2012,në të cilin parashikohet se: *"Një kërkesë në gjykatat e shteteve anëtare mund të bëhet për masa të tilla të përkohëshme, përfshirë masa mbrojtëse, siç mund të jenë të disponueshme sipas ligjit të atij shteti, edhe në qoftë se, sipas rregullores, gjykata e një shteti tjetër anëtar kanë juridiksion në lidhje me thelbin e çështjes".*

---

<sup>84</sup>Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 22 të Datës 19.01.2011,

Një personi fizik apo juridik i huaj mund t'i drejtohet gjykatës shqiptare me kërkimin për sigurimin e padisë, në rast se pasuria/asetet e të paditurit (debitorit) ndodhet në Republikën e Shqipërisë, edhe pse kompetente për të shqyrtuar çështjen e themelit mund të jetë një gjykatë tjetër e huaj apo arbitrazhi. Pra në të dyja rastet e sipër përmendura kemi një përputhje të plotë për sa i përket raportit mes kërkesës për sigurimin e padisë dhe gjykimit të çështjes, çka do të thotë që edhe nëse për zgjidhjen në themel të çështjes kemi një marrëveshje të vlefshme për përcaktimin e një juridiksioni të huaj ose arbitrazhi, për kërkesat e sigurimit të objektit të padisë ka juridiksion shteti në të cilin ndodhen asetet apo pasuritë e debitorit.

#### **4.7 Bashkëveprimi mes Rregullores dhe juridiksionit të arbitrazhit.**

##### **Vështrim krahasues me legjislacionin shqiptar.**

Arbitrazhi është një metodë alternative e zgjidhjes së problemeve kombëtare dhe ndërkombëtare, e cila konsiderohet si teknikë ligjore që ka si qëllim zgjidhjen e çështjeve mes dy apo më shumë palëve, nga një palëe tretë e pavaruar, një arbitër ose trup arbitrazhi, të cilët ushtrojnë juridiksion bazuar në një marrëveshje pa qënë të detyruar nga shteti për këtë mision. (David,1982:82)

Nëse i referohemi ligjit shqiptar, në Kodin e Procedurës Civile arbitrazhi është përkufizuar si një marrëveshje, një kontratë, nëpërmjet së cilës palët bien dakort me njëra-tjetrën që t'iu lënë arbitrave zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre. Kjo marrëveshje e parashikuar duhet t'i nënshtrohet kushteve të përmbajtjes dhe të formës.<sup>85</sup>

Juridiksioni i arbitrazhit është tërësia e të drejtave dhe detyrimeve të gjykatës së arbitrazhit për të shqyrtuar vetëm mosmarrëveshje me karakter pasuror ose kërkesa që

---

<sup>85</sup>Neni 403 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

rrjedhin nga marrdhënie pasurore dhe vetëm n.q.s ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës pranojnë t'ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.<sup>86</sup>

Kufiri ndarës mes juridiksionit të arbitrazhit dhe çdo juridiksioni tjetër, pra juridiksionit gjyqësor dhe juridiksionit administrativ është i përcaktuar në nenin 414 të Kodit të Procedurës Civile ku thuhet se: *“Kur nje mosmarrëveshje që është duke u shqyrtuar nga një gjykatë arbitrazhi, i dërgohet për gjykim një juridiksioni tjetër, ky i fundit duhet të deklarojë moskompetencën. Kur procedura e arbitrazhit për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ende nuk ka filluar, juridiksioni tjetër duhet gjithashtu të deklarojë moskompetencën, përveç kur marrëveshja e arbitrazhit është haptazi e pavlefshme.*

Ndërsa në nenin 417 parashikohet se: *“Gjykata e arbitrazhit, kryesisht ose me kërkesën e palëve vendos për kompetencën e vet, duke përfshirë edhe vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit...”*

Mjafton një marrëveshje e vlefshme mes palëve për t'ia nënshtroar arbitrazhit zgjidhjen e themelit të mosmarrëveshjes me karakter pasuror dhe themi se çështja i takon juridiksionit të arbitrazhit dhe jo një juridiksioni tjetër. (Tafaj, Vokshi, 2011:205)

Në rastet kur kemi të bëjmë me një marrëveshje të vlefshme mes palëve që e transferon juridiksionin në arbitrazh, gjykata shqiptare duhet të pezulloj gjykimin deri sa të përcaktohet juridiksioni i arbitrazhit.

Ky parashikim që bën Kodi i Procedurës Civile Shqiptare është i ngjashëm me parashikimin që bën rregullorja në nenin 31 për sa i përket pezullimit të procedurave në gjykatat e tjera dhe përcaktimit të juridiksionit të gjykatës së fillimit, ndërsa gjykatat e

---

<sup>86</sup>Neni 403 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.



tjera i pezullojnë procedurat. Rregullorja bën këtë parashikim jo vetëm për juridiksionin gjyqësor, por përfshinë dhe juridiksionin e arbitrazhit.

Që një çështje të mund t'i takojë juridiksionit të arbitrazhit do të thotë që palët të bëjnë një marrëveshje para ose pas lindjes së mosmarrëveshjes mes tyre, ku qartazi të përcaktohet zgjidhja e mosmarrëveshjes nëpërmjet arbitrazhit. Ekzistenca ose jo e klauzolës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes me arbitrazh është përcaktuese për juridiksionin e arbitrazhit, sepse mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm n.q.s ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të cilës ato pranojnë t'ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose do të lindin, ndërsa objekti i marrëveshjes është përcaktues për kompetencën lëndore të arbitrazhit, sepse jo çdo mosmarrëveshje e lindur mund të zgjidhjet me procedurë arbitrazhi. (Tafaj, Vokshi, 2011:213)

Neni 402 i Kodit të Procedurës Civile përcakton kompetencën lëndore të gjykatës së arbitrazhit si çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore. Ky është objekti i një gjykimi të arbitrazhit. Kjo do të thotë që çështje të tjera që nuk kanë karakter pasuror nuk mund të zgjidhen me arbitrazh, p.sh. nuk mund të zgjidhen me procedurë arbitrazhi konfliktet familjare apo penale, edhe nëse palët me marrëveshje parashikojnë ndryshe, kjo marrëveshje do të jetë e pavlefshme. Ligji në këtë mënyrë ka kufizuar autonominë e vullnetit të palëve, duke përcaktuar se çështjet që kanë rëndësi për rendin publik mund t'i nënshtrohen vetëm gjykimit në gjykatat shtetërore.

Kjo dispozitë e K.Pr.C., është në përputhje edhe me nenin 1 (3) të Konventës së Neë York-ut, sipas të cilës “....Mund të deklarojë gjithashtu se do të zbatohet Konventa vetëm për mosmarrëveshjet e lindura nga marrëdhëniet juridike, kontraktore ose

*jokontraktore,të cilat konsiderohen si marrëdhënie tregtare nga legjislacioni kombetar i shetit që bën këtë deklaratë.”*

Kështu,që një gjykatë arbitrazhi të jetë kompetentë për zgjidhjen e një konflikti sipas ligjit shqiptar,është e nevojshme që mosmarrëveshja të ketë karakter pasuror dhe padia e ngritur të ketë si objekt kërkimi një të drejtë pasurore.Nga ky kufizim mund të konkludojmë se një gjykatë arbitrazhi nuk mund të gjykojë padi njohjeje apo padi të tjera që nuk përmbajnë detyrime apo kërkime të karakterit pasuror.Si rrjedhojë,çdo marrëveshje e palëve,që i jep jurdiksion gjykatës së arbitrazhit për zgjidhjen e një konflikti të ndryshëm nga ai pasuror është e pavlefshme dhe marrëveshja e arbitrazhit që i jep jurdiksion gjykatës sëArbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrveshjeve me karakter të ndërthurur,pra jo vetëm pasuror,do të jetë vetëm pjesërisht e vlefshme,vetëm përse i përket karakterit pasuror dhe jo për parashikimet për pjesën tjetër.

Neni 36\2 i Kodit të Procedurës Civile të Repubikës së Shqipërisë përcakton se:Asnjë institucon tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.Është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë.

Në këtë dispozitë bëhet fjalë për çështje të cilat, që në fillim i kanë takuar jurdiksionit gjyqësor dhe nuk ka patur me parë një marrëveshje të palëve për t’ia nënshtruar zgjidhjen e mosmarrëveshjes juridiksionit të arbitrazhit.

Po çfarë ndodh në rastet kur të dyja gjykatat,qoftë ajo e arbitrazhit dhe ajo e shkallës së parë pranojnë njëkohësisht jurdiksionin e tyre?

Do të shqyrtoj dy raste hipotetike, rastin kur Gjykata e Arbitrazhit e ka filluar procedurën e arbitrazhit dhe rasti i dytë kur gjykata e Arbitrazhit nuk ka filluar procedurën e arbitrazhit.

Gjykata e Arbitrazhit ka të drejtë të vendosi vetë për juriksionin e saj lidhur me vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e marrëveshjes që do të thotë se ajo nuk ka pengesë ligjore në këtë lloj vendimmarrjeje. Në rastin e parë gjykata e arbitrazhit ka vendosur tashmë dhe e ka pranuar çështjen për gjykim dhe procedura e arbitrazhit ka filluar. Kësaj çështjeje i jep përgjigje neni 414/1 i K.Pr.C, i cili parashikon: *“Kur një mosmarrëveshje që është duke u shqyrtuar nga një gjykatë arbitrazhi, mbi bazën e një marrëveshjeje arbitrazhi, i dërgohet për gjykim një juridiksioni tjetër, ky i fundit duhet të deklarojë moskompetencë”*.. Sipas kësaj dispozite, çdo juridiksion tjetër, përfshirë dhe juriksionin gjyqësor, duhet të deklarojë moskompetencën dhe çështja do të gjykohet nga gjykata e arbitrazhit.

Në rastin e dytë, nëse çështja paraqitet në gjykatën e shkallës së parë dhe ajo deklaron kompetencën e saj për shkak se marrëveshja është haptazi e pavlefshme, ajo fillon gjykimin e çështjes, në bazë të nenit 414 të K.Pr.C.

Në kushtet e ekzistencës së një marrëveshjeje, që palët e pretendojnë si të vlefshme, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës së arbitrazhit. Gjykata e Arbitrazhit nuk ka asnjë pengesë ligjore të vendosë për kompetencën ose moskompetencën e juriksionit të saj. Nëse gjykata e arbitrazhit pranon me vendim se çështja është jashtë juridiksionit të saj për shkak se marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme, çështja do të zgjidhet nga juridiksioni gjyqësor. Nëse gjykata e arbitrazhit vendos të pranojë çështjen në juridiksionin e saj, fillon procedura e arbitrazhit dhe jemi në rastin 1 dhe gjykata e

shkallës së parë me kërkesë të personit të interesuar duhet të deklaroj moskompetencën. Këto parashikime ligjore janë në përputhje të plotë me parashikimet e rregullores 1215/2012 për juridiksionin e arbitrazhit.

#### **4.7.1 Marrja e masave të sigurimit të padisë në rastet kur themeli i çështjes i përket juridiksionit të arbitrazhit.**

Nëse do të shtrojmë çështjen: A ka juridiksion gjykata e shkallës së parë për shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masave të sigurimit të padisë, nëse themeli i mosmarrëveshjes i përket juridiksionit të arbitrazhit?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje do t'i referohemi Konventës Europiane të Arbitrazhit (Gjenevë 21 Prill 1961), e miratuar me Ligjin 8687, datë 9.11.2000. Në nenin 6 pika 4 e kësaj konvente përcaktohet se: *“Një kërkesë për masa të përkohshme ose masa sigurimi, që i është drejtuar një autoriteti gjyqësor, nuk mund të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit, as edhe si një shtrim i thelbit të çështjes në gjykatë. “*

Siç e shohim, kjo dispozitë përcakton se kërkesa për masa sigurimi e drejtuar në gjykatë nuk konsiderohet si kërkesë padia për thelbin e çështjes, pasi në këtë rast mosmarrëveshja do t'i nënshtrohej juridiksionit të arbitrazhit. Gjithashtu, nuk mund të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit. Qëllimi i marrjes së masës së sigurimit të padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe legjislacionit ndërkombëtar është jo vetëm sigurimi i së drejtës, e cila përbën dhe tërësinë e kërimeve që do të parashtrojë paditësi në padinë e tij, por në të njëjtën kohë dhe tësigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor.

Neni 60/2 i Kodit të Procedurës Civile shqiptare është në përputhje me nenin 6/4 të Konventës Europiane të Arbitrazhit dhe me nenin 71 të Rregullores 1 bis të Brukselit, ku parashikohet se gjykata ka juriksion për sa i përket kërkesës për marrjen e masave të sigurimit të padisë, edhe në rastet kur për thelbin e çështjes ka juridiksion Gjykata e Arbitrazhit.

#### **4.8. Njohja e vendimeve të gjykatave të shteteve të huaja.**

Parimi i ekonomisë gjyqësore dhe i bashkëpunimit ndërkombëtarë kanë bërë që shumica e shteteve të pranojnë mundësinë që gjyqtarët e tyre të mbajnë parasysh vendimet dhe veprimet juridiksionale të huaja. Vetëm pak legjislacione sot në botë, mohojnë çdo vlerë të gjykimeve të huaja dhe kërkojnë në raste të tilla një proces të ri gjyqësor, sikur vendimi gjyqësor i huaj për çështjen në fjalë të mos ishte dhënë asnjëherë. (Kalia, 2010:423)

Vendet e Bashkimit European kanë hequr tashmë procedurën e ekzekutimit të vendimeve të shteteve brenda B.E –së. Rregullorja 1215/2012 bën të mundur që një vendim i dhënë në një shtet anëtar, i cili është në fuqi dhe i ekzekutueshëm në atë shtet anëtar, të jetë i ekzekutueshëm në të gjitha shtetet anëtare, pa qënë nevoja për nxjerrjen e një deklarate ekzekutueshmërie.<sup>87</sup> Me rregulloren 1215/2012, neni 39, deklarata e ekzekutueshmërisë nuk është më e nevojshme. Kjo për faktin se një vendim gjykate i dhënë në një shtet anëtar dhe i zbatueshëm në atë shtet anëtar duhet të jetë i

---

<sup>87</sup>Neni 39 i Rregullores 1215/2012 parashikon: “*një vendimi dhënë në një gjykatë të një shteti anëtar, i cili është i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm dhe në shtetet e tjera anëtare pa qënë nevoja e nxjerrjes së ndonjë deklarate ekzekutueshmërie*”.

ekzekutueshëm dhe në shtetet e tjera anëtare pa tërhequr deklaratën e zbatueshmërisë. Kjo do të thotë që çdo vendim i dhënë nga një gjykatë e një shteti anëtar të Bashkimit European do të njihet dhe zbatohet automatikisht në çdo shtet anëtar. Vendimi i gjykatës do të trajtohet njësoj sikur të jetë dhënë nga gjykata e shtetit anëtar ku kërkohet të ekzekutohet. Po në rastet kur një mosmarrëveshje është zgjidhur me vendim të formës së prerë të një gjykate europiane, a njihet mundësia ligjore e palës për ta bërë të zbatueshëm këtë vendim në Republikën e Shqipërisë? Në lidhje me këtë pyetje përgjigjen e gjejmë në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, kreu IX ku janë parashikuar në mënyrë të detajuar rregullat specifike në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave të huaja, nenet 393 – 399 dhe neni 72 pika dh e ligjit nr.10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Sipas nenit 510 pika c e Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, njëvendim i huaj nuk mund të ekzekutohet në territorin e Republikës së Shqipërisë nëse pala e interesuar nuk e kërkon një gjë të tillë, përpara gjykatës kompetente.

Në Republikën e Shqipërisë një vendim i një gjykate të huaj mund të njihet vetem duke vlerësuar në këtë proces disa elementë proceduralë dhe pa e shqyrtuar në themel çështjen për të cilën është dhënë vendimi i huaj. Në kuptimin e nenit 393 të K.Pr.C rezulton e parashikuar shprehimisht se, vendimet civile të gjykatave të huaja mund të njihen dhe të zbatohen në Republikën e Shqipërisë. Po në këtë dispozitë parashikohet epërisa që ka një marrëveshje ndërkombëtareme objekt njohjen e një vendimi gjyqësor, kundrejt të drejtës tonë të brendshme. Kjo epërsi parashikohet shprehimisht si parim i rëndësishëm edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenin 122, pika 2: *“Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”* Po ashtu me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare, mund

të përcaktohen edhe kushte të tjera, në të cilat një vendim gjyqësor i huaj prodhon efekte për shtetet e tjera. Gjithashtu, me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare mund të parashikohen dhe efekte të tjera që mund të prodhojë njohja.

Vendimi gjyqësor i huaj prodhon efekte në vend tjetër, nëse përmbushen kërkesat e përcaktuara nga ligji i shtetit ku ngrihen këto efekte. Këto kërkesa ligjore, konsistojnë në njohjen e vendimit gjyqësor të huaj ose me anë të sigurimit të procedurës së exekutorit. Procedura e parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile Shqiptare është një procedurë rigoroze. Exequator është një procedurë juridike në kuadrin e të cilës, në vazhdim të kontrollit të ushtruar mbi vendimin gjyqësor të huaj, nga gjykatat e shtetit në territorin e të cilit kërkohet ekzekutimi, vendimi gjyqësor i huaj është deklaruar i ekzekutueshëm. (Qoku:2016,441)

Në ligj parashtrihen pengesat ligjore për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja. Neni 394 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se:

*“Vendimit të një gjykate të një shteti të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:*

- a) Sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;*
- b) Kërkesë padia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësinë që të mbrohet;*
- c) Midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;*

*ç) është duke u shqytuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;*

*d) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;*

*dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.”*

Neni i sipërcituar nuk ka parashikuar kushtet që duhet të përmbushë një vendim gjyqësor për t’u njohur dhe ekzekutuar në Republikën e Shqipërisë, por në fakt ka parashikuar pengesat ligjore apo elementët që duhet t’i mungojnë vendimit të gjykatës së huaj që të njihet nga ana e gjykatave shqiptare. Në rast se verifikohet një nga rastet e mësipërme, nuk mund t’i jepet fuqi vepruese një vendimi të gjykatës së huaj. Vendimi gjyqësor i huaj fiton në përgjithësi forcë ekzekutuese njëëlloj si një vendim i gjykatave vendase, vetëm nëse arrihet të sigurohet exequator – i (njohja e tij). (Qoku:2016,437)

Gërma “a” e nenit 394 të K.Pr.C parashikon që një vendim i një gjykatë të huaj të njihet duhet që gjykata e huaj që ka dhënë vendimin të ketë patur sipas ligjit të shtetit të saj, kompetencën që të gjykojë dhe të konkludojë me vendim gjyqësor përfundimtarë. Bëhet fjalë për kompetencë ndërkombëtare private të gjykatës respektive për të dhënë një vendim në çështjen në fjalë. Vlerësimi i juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës në fjalë bëhet në lidhje me dispozitat që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Një rast ku gjykata e huaj nuk ka juridiksion ndërkombëtar për çështjen, mund të përmend rastin kur gjykata ka disponuar me vendim për një send të paluajtshëm që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, ku sipas ligjit shqiptar, është në juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare.



Parashikimi i gërmes “b” të nenit 394 të K.Pr.C -së lidhet me komponentët e procesit të rregullt ligjor. Nëse vihet re se i padituri në mungesë nuk ka pasur dijeni për kërkesë padinë apo për letërthirrjen, atëhere jemi përpara shkeljes së parimit kushtetutes të procesit të rregullt ligjor, si pasojë vendimi i gjykatës së huaj nuk njihet në Repubikën e Shqipërisë. Duhet të provohot që palës, i është dërguar në kohën e duhur thirrja për njoftimin e gjykimit, si dhe akti për vendosjen në lëvizje të gjykatës, duke mos anashkaluar kështu mundësinë për tu mbrojtur dhe për të ushtruar rrugën e ankimit kundër vendimit.(Qoku:2016,439)

Rasati i parashikuar nga gërma “c” e nenit 394 të K.Pr.C –së ka lidhje me parimin e gjësë së gjykuar.(res judicata). Ky i fundit konsiston në faktin se si rregull asnjë palë nuk mund të kërkojë rigjykimin e një çështje që është zgjidhur me vendim të formës së prerë. Neni 451, pika 1 i K.Pr.C parashikon:

*“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera...”*

Lidhur me këtë parim GJEDNJ shprehet se: parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një vendim përfundimtar është një element thelbësor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i KEDNJ në çështjet civile. Kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, ajo duhet të vendoset njëherë e përgjithmonë.<sup>88</sup> Nëse për të njëjtën çështje, pra me objekt, palë e për të njëjtin shkak është dhënë një vendim nga gjykata shqiptare që është i ndryshëm nga

---

<sup>88</sup>Kehaya and others v. Bulgaria,12.01.2016

vendimi i dhënë nga gjykata e huaj, do të zbatohet vendimi i gjykatës shqiptare dhe si rrjedhojë nuk do të njihet vendimi i gjykatës së huaj për të njëjtën çështje.

Parashikimi i gërmës “ç” të nenit 394 të K.Pr.C-së lidhet me konceptin e litispendencës (gjyqëvarësisë). Nëse kërkohet të njihet një vendim i një gjykate të huaj për një çështje e cila është duke u gjykuar nga gjykata shqiptare ose ende vendimi i gjykatës shqiptare nuk ka marrë formë të prerë, nuk do të zbatohet vendimi i gjykatës së huaj.

Parashikimi i gërmës “d” të nenit 394 të K.Pr.C-së referon të ligji i shtetit të gjykatës që kërkon të njoh vendimin. N.q.s sipas ligjit të këtij shteti vendimi i gjykatës nuk ka marrë formë të prerë nuk mund të njihet nga gjykata shqiptare. Ky nen lidhet me nenin 220 të K.PR.C-së për zbatimin e ligjit të huaj. Neni 220 parashikon:

*“Në rast se për gjykimin e një çështjeje është e nevojshme të zbatohen ligjet e një shteti tjetër, gjykata duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t’i gjetur dhe zbatuar ato sipas përmbajtjes së tyre. Kur çdo përpjekje e gjykatës sipas paragrafit të parë të këtij neni është e pasuksesshme dhe asnjë nga palët nuk kanë mundur t’ia sigurojnë gjykatës dispozitat e kërkuara, të vërtetuara nga organet kompetente të shtetit tjetër, gjykata vendos sipas legjislacionit shqiptar.”*

Parashikimi i gërmës “dh” të nenit 394 të K.Pr.C-së ka lidhje me klauzolën e rendit publik. Në rast se vendimi i huaj shkel rendin publik të së drejtës ndërkombëtare private shqiptare nuk zbatohet.(Qoku:2016,439) Në këtë rast gjykata shqiptare që shqyrton kërkesën do të shqyrtojë dispozitivin e vendimit gjyqësor të huaj për të parë nëse cënohen apo jo parimet bazë të legjislacionit shqiptar. P.sh nuk zbatohet

një vendim i një gjykate të huaj i cili diskriminon njërën nga palët për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, gjuha, etnia, bindjet politike, gjendja ekonomike, arsimore etj. Vendimi gjyqësor nuk duhet të cënoj rendin publik në të drejtën ndërkombëtare private shqiptare, as me anë të dispozitave të tij, ose me anë të ekzekutimit të tij. Kjo është parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

Në bazë të nenit 395 të K.Pr.C-së kërkesa për t’i dhënë fuqi juridike një vendimi të një gjykate të huaj i paraqitet Gjykatës së Apelit. Kërkesa mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe në bazën e parimi të së drejtës ndërkombëtare publike, atij të reciprocitetit, pra në rastet kur midis Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj ku gjendet gjykata që ka dhënë vendimin ekziston reciprocitet vendimesh. Nëkëto raste, nëqoftëse pala e interesuar nuk ka përcaktuar përfaqësues ligjor, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën. Gjykata e Apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i gjykatës së huaj i paraqitur për njohje dhe ekzekutim nuk përmban pengesat ligjore të përcaktuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile dhe konkludon me vendim gjyqësor. Gjykimi i kërkesës për njohje bëhet pa palë kundërshtare, por bazuar në nenin 193 të K.Pr.C –së, gjykata ka të drejtë të thërrasë persona të tretë në gjykim ose të kërkojë informacion nga gjykata e huaj që ka dhënë vendimin.

Dokumentacioni që duhet t’i bashkëngjitet vendimit të gjykatës së huaj që kërkohet të ekzekutohet përcaktohet në nenin 396 të K.Pr.C –së. Sipas këtij neni:

“Kërkesës për t’i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t’i bashkëngjiten:

- a) Kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;
- b) Vërtetim nga gjykata që e ka nxjerr vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë;
- c) Prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri.

Siç konstatohet nga ky nen kërkohen një sërë dokumentash të legalizuara dhe të përkthyer. N.q.s do të krahasojmë dokumentat dhe procedurën përpara gjykatave shqiptare me atë përpara gjykatave europiane për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja, do të shohim që ka ndryshime thelbësore. Vlen për t'u theksuar se kjo procedurë është e ngjashme me procedurën që është ndjekur në Europën deri në vitin 2015. Me miratimin e rregullores 1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” është hequr procedura exequator në gjykatat e shteteve anëtare. Aktualisht, është e mundur që një vendim i dhënë në një shtet anëtar, i cili është në fuqi dhe i ekzekutueshëm në atë shtet anëtar, të jetë i ekzekutueshëm në të gjitha shtetet anëtare, pa qënë nevoja për nxjerrjen e një deklarate ekzekutueshmërie.

Neni 39 i Rregullores 1215/2012 parashikon: *“një vendimi dhënë në një gjykatë të një shteti anëtar, i cili është i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm dhe në*

*shtetet e tjera anëtare pa qënë nevoja e nxjerrjes së ndonjë deklarate ekzekutueshmërie*”.<sup>89</sup>

Mendoj që në Republikën e Shqipërisë të ndiqet e njëjta praktikë ligjore që parashikohet në rregulloren 1215/2012, pra të shkrihet procedura exequator për vendimet e dhëna nga gjykatat europiane. Si bazë ligjore të përdoret neni 393 i K.Pr.C –së ku parashikohet mundësia që me marrëveshje ndërkombëtare mes Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të huaja mund të përcaktohet kushte të tjera për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave.

Po në këtë dispozitë parashikohet epërisa që ka një marrëveshje ndërkombëtare me objekt njohjen e një vendimi gjyqësor, kundrejt të drejtës tonë të brendshme. Kjo epërsi parashikohet shprehimisht si parim i rëndësishëm edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenin 122, pika 2: *“Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”* Po ashtu me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare, mund të përcaktohen edhe kushte të tjera, në të cilat një vendim gjyqësor i huaj prodhon efekte për shtetet e tjera. Gjithashtu, me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare mund të parashikohen dhe efekte të tjera që mund të prodhojë njohja.

Heqja e procedurës së ekzekutimit do të çonte në lehtësimin e burokracisë, në shmangien e kostove të larta, në lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore civile, si dhe në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian.

---

<sup>89</sup> Rregullorja e Këshillit Eurpian nr.1215/2012, “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, neni 39.

Për sa i përket pengesave ligjore që çojnë në mosnjohjen e një vendimi të gjykatës së huaj vë re se parashikimet e nenit 394 të K.Pr.C –së dhe nenet 7, 20, 72, ligjit nr.10428, datë 2.6.2011 janë të njëjta me ato të parashikuara në nenet 34, 35 të rregullores 1215/2012. Pengesa ligjore kryesisht ka lidhje me klauzolën e rendit publik, e cila më shumë se kudo aplikohet në fushën e njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore. (Kalia, 2010:425)

Do të refuzohet njohja e vendimit të gjykatës së huaj n.q.s vendimi është haptazi në kundërshtim me rendin publik të shtetit ku kërkohet të njihet apo ekzekutohet. Gjithashtu, do të refuzohet njohja e vendimit nëse vendimi është dhënë në mungesë të palës së paditur duke mos e njoftuar rregullisht, apo në rastet kur nuk i janë vënë në dispozicion dokumentat gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë kështu që i padituri mos të ketë mundësi të realizojë mbrojtjen ligjore para gjykatës për çështjen në fjalë. Nëse vendimi është në kundërshtim me një vendim të mëparshëm mes të njëjtave palë, dhënë në shtetin anëtar ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tij, si dhe n.q.s vendimi është në kundërshtim me rregullat e juridiksionit të veçantë për çështjeve që kanë si palë të paditur të siguarit, konsumatorët dhe punëmarrësit, bazuar në nenin 10-16, neni 17-19, neni 22-23 si dhe bazuar në rregullat e juridiksionit ekskluziv të parashikuara në nenin 24.

Atributet e gjykatës shqiptare në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja qëndrojnë vetëm në nxjerrjen e vendimit për zbatueshmërinë e vendimit, bën verifikimet e nevojshme për përmbushjen e kushteve të njohjes dhe të refuzimit të vendimit të huaj. Gjykata shqiptare nuk mund të procedojë në shqyrtimin e themelit të vendimit të gjykatës së huaj dhe as ta ndryshojë atë. Gjykata në përputhje me lex fori,

pra me kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar ka mundësinë e njohjes ose jo të vendimit të huaj. Ky lloj gjykimi nuk është një gjykim themeli, ku gjykata shqyrton faktet dhe provat, por shqyrton dispozitivin e vendimit për pengesat ligjore. Ky parashikim është në përputhje të plotë me interpretimin që Gjykata Europiane e Drejtësisë ka bërë nenit 31 të Rregullores së Brukselit. Sipas saj në asnjë rrethanë nuk parashikohet që në procesin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të dhënë nga një gjykatë e një tjetër shteti anëtar të gjykohet thelbi i çështjes. Kjo për të shmangur vendime të ndryshme për të njëjtën çështje mes gjykatave të shteteve anëtare.

Ligji procedural i aplikueshëm në të dyja rastet, pra edhe kur kërkohet njohja e një vendimi të huaj përpara gjykatave shqiptare, ashtu edhe përpara gjykatave europian është ai i lex fori. Procedura e ekzekutimit rregullohet nga ligji i atij shteti anëtar ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit. Kërkesat e njohjes së vendimit të huaj plotësohet në përputhje me kërkesat e ligjit të atij shteti ku kërkohet ekzekutimi. Në Republikën e Shqipërisë aktet duhet të shoqërohen me përkthime dhe duhet të legalizohen dhe të vërtetohen nga Ministria e Punëve të Jashtme të shtetit përkatës apo siç përdoret zakonisht vula apostile. Si rregull, nuk kërkohet mbilegalizim, në rastin kur palët janë dakort, për të vendosur kopje të certifikuara për konformitet. (Qoku, 2016:441)

#### **4.8.1 Llojet e njohjes së vendimeve të huaja gjyqësore.**

Me njohje vendimi gjyqësor të huaj kuptojmë që një vendim i gjykate të huaj përfiton në Republikën e Shqipërisë të njëjtat efekte si një vendim i gjykatave shqiptare. Ky vendim i gjykatës së huaj përfiton statusin e gjësë së gjykuar (res judicata), njësoj si çdo vendim i lëshuar nga autoritetet gjyqësore shqiptare. Vendimi i njohjes i dhënë nga gjykata, nuk është gjë tjetër veçse një mjet teknik për të garantuar aplikimin e vendimit

gjyqësor të huaj apo për t'i dhënë fuqi vepruese në rendin tonë të brendshëm ose është “një shprehje themeluese e efekteve plotësisht procedurale”.(Kalia,2010:426)

Vendimi i njohjes përbën në vetvete një veprim juridiksional shqiptar, i cili duhet t'i përgjigjet kërkesave të vendosura nga e drejta shqiptare për veprime të tilla. Kjo do të thotë që tërëveprimtaria procedurale civile për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor duhet të zhvillohet në bazë të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit 10428/2011.

Njohja e vendimeve të gjykatave të huaja mund të ndodhi menjëherë në raste të caktuara, ka njohje me anë të një vendimi gjyqësor dhe njohja incidentale. Vendimi i njohjes së dhënë nga gjykata e apelit për një vendim të një gjykate të huaj, si rregull nuk i nënshtrohet asnjë asnjë procedure ankimore. Gjykimi i njohjes incidentale ose të rastësishme mund të bëhet përpara një gjyqtari të ndryshëm nga ai që merret me njohjen e vendimeve gjyqësore të huaja, pra nga gjyqtari i apelit. Një gjyqtar i tillë duhet të vlerësojë nëse i përgjigjet vendimi i huaj gjyqësor kërkesave të ligjit shqiptar. Dallimi qëndron në faktin se, në një rast të tillë, vendimi gjyqësor do të prodhojë efekte kufizues në procesin për të cilin bëhet fjalë. Kështu, ky vendim do të ketë vlerën e gjësë së gjykuar.

Njohja e menjëhershme e vendimeve të gjykatave të huaja ndodh kur vendimi i referohet statusit civil të shtetasve të huaj ose vendimet gjyqësore të huaja, në lidhje me statusin civil të shtetësisë së shtetasit të huaj, që janë dhënë në një shtet të tretë, janë njohur më parë nga shtetet, shtetësinë e të cilit mbajnë palët e përfshira. Në rastin kur vendimi gjyqësor i huaj i referohet gjendjes civile të personit me vendbanim në shtetin që e dha vendimin, me anë të aplikimit të ligjit të vendbanimit, ky person përfiton nga



njohja e menjëhershme e vendimit, nëse ky i fundit është njohur më parë nga shteti shtetësinë e të cilit mban ai individ. (Qoku,2016,438)

Nje tjetër lloj njohje, e cila në fakt është më e përhapura, është njohja me anë të një vendimi gjyqësor shqiptar. Kjo lloj njohje ndodh në rast se plotësohen kushtet e përcaktuara nga neni 394 i K.Pr.C – së. Ligji përcakton se njohja nuk mund të refuzohet për arsye se gjykata ka aplikuar një ligj tjetër, përveç se atij të treguar në të drejtën ndërkombëtare private shqiptare, përveç se procesi ka të bëjë me gjendjen civile dhe aftësinë e një shtetasi shqiptar, ndërësa zgjidhja e adoptuar ndryshon nga ajo, e cila do të arrihej nëse aplikohet ligji shqiptar. Kjo përcaktohet në nenin 72, pika ç e ligjit 10428/2011. Vendimi që kërkohet të njihet duhet të ketë marrë formë të prerë në përputhje me ligjin e shtetit ku është dhënë. Pra, një akt i tillë duhet të konsiderohet akt gjyqësor jo vetëm nga rendi i huaj juridik, ku ai vendim është marrë, por edhe nga rendi juridik shqiptar, ku kërkohet të njihet vendimi. Si vendime gjyqësore mund të kualifikohen të gjitha ato vendime ose ato akte në të cilat, organet e pajisura me pushtet juridiksional, shprehin në mënyrë imperative vullnetin e ligjit, duke ndikuar në këtë mënyrë në situatat e ndryshme të së drejtës subjektive, me një vendim të tillë, të përshtatshëm për të fituar autoritetësinë e gjësë së gjykuar. (Kalia,2010:427)

Vendime gjyqësore të huaja janë ato vendime të cilat prodhojnë efekte juridike dhe janë të formës së prerë. Këtu nuk mund të përfshihen vendimet e ndërmjetme apo ato përgatitore të seancave gjyqësore, të cilat japin efekt në kuadrin e rendit në të cilin janë nxjerr. Në kategorinë e vendimeve që nuk mund të njihen sipas rendit juridik të Republikës së Shqipërisë janë dhe vendimet fetare që janë dhënë në shtetet e huaja nga insitucionet fetare. Këto vendime fetare i përkasin një tjetër fushë gjykimi. Ato janë

pjesë e një sistemi të caktuar organesh gjyqësore fetare, jo gjyqësore civile, dhe pavarësisht vlerën juridike që mund të kenë në shtetin ku janë nxjerrë nuk mund të njihen nga organet gjyqësore shqiptare si vendime gjyqësore të huaja.

Ligjërisht, që një vendim gjyqësor i huaj të bëhet efikas në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë me efekt edhe në rendin e tij juridik. Ligji rregullues i procesit gjyqësor të njohjes së një vendimi të huaj do të jetë ligji i gjykatë, lex fori i shteti ku do të bëhet procesi i njohjes. Bazuar në nenin 82 të ligjit nr.10428/2011: *“Gjykimi i çështjeve gjyqësore me elementë të huaj para gjykatave shqiptare bëhet sipas ligjit procedural shqiptar”*

Një tjetër kërkesë është që vendimi gjyqësor i huaj të mos jetë në kundërshtim me një vendim gjyqësor me të njëjtin objekt dhe me natyrë të njëjtë, të dhënë nga gjykata shqiptare. Kjo për të ndaluar mundësinë e përplasjes së vendimeve analoge, që janë dhënë nga jurisprudenca shqiptare, për të ruajtur koherencën në rendin e brendshëm juridik për vendime me natyrë të njëjtë.

Gjykata e cila ka dhënë vendimin, ka pasur sipas ligjit të shtetit të saj kompetencën që të gjykojë dhe të japë vendim për çështjen në fjalë. Gjithashtu, një tjetër kusht që duhet të plotësohet është respektimi i parimit të reciprocitetit. Në të drejtën ndërkombëtare private, reciprociteti ka efekt mbikqyrës mbi veprimin e normës së konfliktit në kuptimin që, e drejta e huaj që aplikohet në bazë të kërkesës së normës së konfliktit, nga ana e saj duhet të aplikojë në raste analoge, të drejtën e shtetit të cilit i përket norma e konfliktit. (Kalia,2010:158)

Ligjvënësi i një shteti, duke nxjerrë norma konflikti të mbikyqrrura nga kushtet e reciprocitetit, u kërkon legjislatorëve të shteteve të tjera të njohin në njëfarë mase të drejtën e tij me qëllim që mos të jetë inferiore ndaj të drejtës së shteteve të tjera. Cdo ligjvënës së pari, ia nënshtron ligjet e tij parimit të reciprocitetit për të mbrojtur të drejtat e shtetasve të tij që ndodhen në një shtet të caktuar. Tjetër motiv në respektimin e reciprocitetit është ruajta e “prestigjit” të shtetit, duke bërë që shteti shqiptar të mos aplikojë ndaj shtetsve të një shteti tjetër të drejta apo detyrime që shteti i huaj nuk ia njeh shtetasve shqiptar.

Opinion i përgjithshëm në doktrinën e sotme të së drejtës ndërkombëtare është që normat e konfliktit, të bazuara në parimin e reciprocitetit, duhet të interpretohen si norma të cilat veprojnë në lidhje me marrëdhënie më të kufizuara, të formuara nga të dhëna të faktit ndër të cilat janë dhe ato të formuara nga identifikimi i ligjit të huaj me ligjin e brendshëm.(Kalia,2010:159)

Vendimi i huaj do të njihet nëse ekziston reciprociteti përse i përket efekteve të vendimit të huaj midis Shqipërisë dhe shtetit, gjykata e të cilit ka dhënë vendimin. Në rastet kur vendimi që kërkohet të njihet është marrë në mungesë së palës që ka humbur procesin gjyqësor, duhet të provohet që palës, i është dërguar në kohën e duhur thirrja për njoftimin e gjykimit, si dhe akti për vendosjen në lëvizje të gjykatës, duke mos anashkaluar kështu mundësinë për tu mbrojtur dhe për të ushtruar rrugën e ankimit kundër këtij vendimi. Pra, duhet të vërtetohet që janë plotësuar kërkesat për një proces të rregullt ligjor dhe parimi i barazisë së armëve në një proces gjyqësor, ku palëve i jepen të njëjtat mundësi dhe garanci procedurale në proces.Karakteri jo përfundimtar i vendimit të gjykatës së huaj rrjedh nga anashkalimi i thirrjes së personit, i cili nuk mori

pjesë në proces përball gjykatës së huaj dhe është pikërisht ky person që mund ta ngrejë një pretendim të tillë.

Neni 394 i K.Pr.C –së përcakton rastet në të cilën njohja duhet të refuzohet nga ana e gjykatave shqiptare. Vendimi do të refuzohet nëse shkel rendin publik apo shkel dispozitat ligjore në lidhje me kompetencën ekskluzive të juridiksionit shqiptar. Pra në rastet kur çështja përfshihet në juridiksionin ekskluziv sipas nenit 72 të ligjit 10428, datë 2.6.2011. Vendimi do të refuzohet të njihet kur ky i fundit është rezultat i një mashtrimi të kryer në procedurën e ndjekur nga gjykata që e ka dhënë, për këtë arsye nuk rezulton që vendimi të ketë marrë formë të prerë ose ka marrë formë të prerë në kundërshtim me legjislacionin e atij shteti ku ka dal vendimi. Kjo është e përcaktuar në nenin 7 të ligjit 10428/2011. Padia e njohjes së vendimit të huaj i nënshtrohet një afati të caktuar parashkrimi, i cili është i përcaktuar në bazë të normave shqiptare mbi parshkrimin e padive të tilla. Në mënyrë që të njihet vendimi i huaj duhet që e drejta për të kërkuar ekzekutimin të mos jetë parashkruar sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit 10428/2011. Afati i parashkrimit fillon nga dita në të cilën vendimi i dhënë në shtetin e huaj nga ana e një gjykate të tillë ka marrë formën e prerë dhe ndërpritet me paraqitjen e tij në gjykatën shqiptare që do të bëjë njohjen.

Doktrina e së drejtës ndërkombëtare private është e vetëdijshme se vendimi i gjykatës së huaj edhe pse mund të mos njihet në një rend juridik ku paraqitet për njohje, mund të prodhojë disa efekte juridike. Duhet të quhet tashme e kapërcyer teoria e mungesës absolute të rëndësisë së akteve dhe vendimeve gjyqësore të huaja.(Kalia,2010:431)

Studime të shumta kanë vlerësuar shumë aspektin normativ të vendimit gjyqësor, duke hedhur dritë mbi faktin se një vendim i huaj përveç se fiton efikasitet me anë të njohjes

së tij, mund të jetë më pas objekt i një aplikimi të mundshëm në fushën ndërkombëtare private. (Kalia,2010:432)

#### **4.8.2 Efektet e vendimeve gjyqësore të huaja të cilat nuk kanë marrë “exequaturin”**

Nga interpretimi i ligit nr. 10428, datë 2.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”objekti i procedurës së exequarit sipas kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisëështë t’i japësh forcë detyruese të barabartë me vendimin shqiptar, një vendimi të gjykatës së huaj. Efekti kryesor është që me anë të kësaj procedure vendimi i huaj merr autoritetin e gjësë së gjykuar në Republikën e Shqipërisë. Në të drejtën ndërkombëtare private bëhet dallimi midis efikasitetit të vendimit të huaj, të kushtëzuar nga exequatur – i, ose njohja dhe efikasiteti i vendimit të huaj, pavarësisht nga ky formalitet. (Qoku,2016:445)

Vendimi gjyqësor i huaj është një realitet që nuk mund të injorohet dhe që prodhon efekte pavarësisht procedurës së ekzekutimit apo njohjes së vendimit të huaj nga gjykatat shqiptare. Ai merr vlerë në vetvete pavarësisht procedurës së ekzekutimit apo pavarësisht njohjes. Një shëmbull i tillëështë vendimi i huaj deklarues i falimentit. Një vendim i një gjykate të huaj në të cilën deklarohet falimenti i një subjekti juridik, edhe në rastet kur nuk është njohur ende vendimi me procedurën exequator, prodhon efekte në masën në të cilën nuk sjell akte, që do të ndjekin sendet apo të shtrëngojë vullnetin e personave.

Një tjetër pasojëe vendimit të huaj, pavarësisht procedurës së ekzekutimit është forca e tij provuese. Kjo do të thotë që edhe pse vendimi i huaj nuk është njohur nga gjykatat

shqiptare, ai është një akt i lëshuar nga një autoritet i huaj dhe ka fuqi provuese të dhënë nga ligji, nën dominimin e të cilit është shpallur, sipas rregullit *locus regit actum*. Në këtë kuptim kreu IX, neni 398 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se vendimi i huaj i lëshuar nga një gjykatë kompetente, ka fuqi provuese përballë gjykatave shqiptare, në lidhje me situatat e faktit që konstatohen.

Vendimi i huaj konsiderohet si një shkak i ligjshëm. Në disa raste vendimi gjyqësor i dhënë në një shtet, pa çuar në ekzultimin me forcë të vendimit në një shtet tjetër, sjell si pasojë, ndryshimin e njëraporti juridik, i cili nëse nuk do të ishte vendimi i huaj, do të zgjidhej ndryshe. P.sh një person i rimartuar në një shtet tjetër, mund të mbrohet në një proces bigamie, duke ngritur vendimin e divorcit të lëshuar jashtë shtetit edhe pse ky vendim nuk është njohur ende, ose nuk është pajisur me procedurën *exequatur* nga gjykatat shqiptare.

Edhe nëse vendimi i huaj prodhon disa efekte, pa marrë akoma *exequaturin* apo njohjen e tij, kjo nuk do të thotë që nuk kontrollohet juridikisht. Ky kontroll mund të ushtrohet në rrugë incidentale nga gjyqtari i çështjes që e shqyrton, ose në rrugë të drejtpërdrejtë.

Në rrugë incidentale: investohet gjykata shqiptare nëpërmjet një kërkesë padie ku kërkohet deklarimi nul i një martese për shkak të një martese të mëparshme, pra rasti i bigamisë. Në këtë rast, i padituri mund të mbrohet me paraqitjen e vendimit të huaj për divorc, me anë të së cilës është zgjidhur martesa e mëparshme. Kështu pra, në rrugë incidentale mund të verifikohet edhe vendimi gjyqësor i divorcit, që është lëshuar jashtë vendit. Në këtë rast ky vendim ka forcë provuese përballë gjykatës shqiptare, në lidhje me situatën faktike që konstatohet.

Kontrolli i drejtpërdrejtë: marrim rastin e një personi të divorcuar me vendim gjykate të huaj dhe kërkon të rimartohet. Nënpunësi i gjendjes civile refuzon lidhjen e martesës me argumentin se nuk është njohur vendimi i divorcit. Në këtë rast, në lidhje me konfliktin duhet të vendosë gjykata. Objekti i konfliktit do të ndërthuret në aspektin praktik me verifikimin e vendimit të huaj. Në këtë rast, vlefshëmria e vendimit të huaj do të verifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për pasojë, lind pyetja se cili është dallimi midis këtij kontrolli të vendimit gjyqësor të huaj dhe exequaturit të mirëfilltë apo njohjes së vendimit gjyqësor të huaj nga gjykata shqiptare? Dallimi qëndron në lehtësimin e aspektit praktik, që i jepet të interesuarit kontrolli i gjykatës. Në këtë rast, kontrolli i gjykatës shqiptare do të bëhet vetëm në rast kur kundërshtohet zbatimi i vendimit të gjykatave të huaja. Në mungesë të një kundërshtimi të tillë, i interesuari do të vlerësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat që lindin nga vendimi i huaj. Pra njihet dallimi mes efikasitetit të njohjes së vendimit të huaj sipas procedurës exequatur dhe efikasiteti i vendimit të huaj pa u kryer procedura e ekzekutimit të vendimit. Në rastin e diskutuar më sipër, pra të vendimit të zgjidhjes së martesës nga një gjykatë e huaj, që të ketë efikasitet në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet që ky vendim të njihet nga ana e gjykatave shqiptare nëpërmjet procedurës së exequaturit, pra njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të gjykatës së huaj.

## Kapitulli V Konkluzione dhe rekomandime

Duke pranuar punën dhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni shqiptar në përafrimin e tij me legjislacionin europian, që rrjedh dhe nga detyrimet e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim – Asocimit, në fushën e autonomisë së vullnetit, juridiksionit dhe njohjes së vendimeve të huaja, ky punim nxorri në pah edhe disa mangësi dhe problematika të dispozitave në këtë fushë, të cilat do të pasqyrohen në kuadër të përfundimeve si vijon.

### 5.1 KONKLUZIONE

Rregullorja e Brukselit nr.1210/2012 datë 12 dhjetor 2012 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, ka krijuar formën dhe strukturën e duhur të bashkëpunimit juridiksional në fushën civile dhe tregtare. Pas aplikimit për 15 vite të Rregullores së Këshillit Europian nr.44\2001 e 22 dhjetorit 2000, “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, u pa e nevojshme miratimi i një rregulloreje të re, të ndryshuar që të rregullonte çështje të tilla si litispendenca, faktet lidhëse, të zgjerohej juridiksioni edhe mbi personat jo rezident në B.E, rregullimi i njohjes së klauzolës së arbitrazhit, dhe heqja e procedurës së gjatë e të kushtueshme të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave në gjykatat e shteteve të tjera anëtare, e njohur si procedura “exequatur”. Paqartësitë dhe pakënaqësitë që shkaktoi aplikimi në praktik i Rregullores 44\2001 u pasyruan në Raportin e Komisionit Europian të vitit 2009 mbi aplikim e rregullores 44\2001, duke bërë dhe rekomandimet përkatëse në lidhje me hartimin e një rregulloreje të re për të përmirësuar situatën e krijuar nga rregullorja 44\2001.

Pasqyrimi më i mirë i ndryshimeve dhe i përshtatjes me praktikën për harmonizimin e legjislacionit, përmirësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve të gjykatave në fushën



civile dhe tregtare është Rregullorja 1bis e Brukselit, që pasqyron realitetin e sotëm të Bashkimit Europian, ndërveprimin dhe bashkëveprimin e shumë fushave, subjekteve me origjinë të ndryshme, dinamikës së levizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve.

Rregullorja 1bis e Brukselit konsiderohet si guri i themelit në ligjin Europian të procedurës ndërkombëtare civile dhe procedurale civile. Kjo mund të konstatohet lehtësisht nga çdo praktikues i së drejtës që përballet në punën e tij me çështje të juridiksionit, apo çështje civile dhe tregtare ndër kufitare në Europë. Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe gjykatat anëtare të Bashkimit Europian kanë dhënë shumë vendime, si një thesar të çmuar në punën e secilit, duke interpretuar Konventën e Brukselit dhe Rregulloren e parë të Brukselit. Në këtë kuadër, Rregullorja 1 bis e Brukselit promovon sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e vendimeve duke vendosur rregulla uniforme dhe plotësohet nga një numër i konsiderueshëm çështjesh. Vlerësohet si një instrument shumë i rëndësishëm për të shmangur procedurat paralele dhe shërben si një referencë dhe mjet për instrumenta të tjera, ka për qëllim lehtësimin e vendimeve gjyqësore dhe aksesin në drejtësi duke sjellë risi pasi aplikohet tashmë edhe ndaj shtetasve jo rezidentë në Bashkimin Europian.

Rregullorja 1bis e Brukselit solli një sërë risish të cilat mund të përmbliidhen në: Përmirësimin e efektivitetit të marrëveshjes së zgjedhjes së gjykatës apo e quajtur ndryshe “Marrëveshjes së juridiksionit”, duke i dhënë përparësi marrëveshjes së palëve për zgjedhjen e gjykatës që ka juridiksion, në raport me gjykatën ku është filluar së pari çështja, në ndryshim nga rregullorja 44/2001 e cila i jepte përparësi gjykatës ku është filluar së pari çështja në krahasim me gjykatën e përzgjedhur nga vetë palët. Rregullorja e re e ruan parimin e përgjithshëm se gjykatat e tjera duhet të pezullojnë gjykimin në

favor të gjykatës ku është filluar së pari çështja, nëni 29 (1), megjithatë ka përfshirë një përjashtim të rëndësishëm nga rregulli i përgjithshëm. Bazuar në nenin 31 (2) të Rregullores 1215/2012, kur një gjykatë e një shteti anëtar në të cilën palët kanë transferuar juridiksionin ka filluar procedurat, çdo gjykatë tjetër duhet të pezullojë procesin dhe të vendosin në favor të gjykatës që kanë përzgjedhur palët edhe nëse nuk është ajo gjykata ku është filluar së pari çështja. Me fjalë të tjera, gjykata në të cilën palët me marrëveshje kanë transferuar juridiksionin edhe nëse nuk është gjykata e parë ku është depozituar kërkesë padia, është gjykata që ka juridiksion ekskluziv. Të gjitha gjykatat e tjera duhet të mohojnë juridiksionin e tyre dhe të vendosin në favor të juridiksionit të gjykatës së përzgjedhur nga palët. Pra, janë parashikuar ndryshime në lidhje me zbatimin e klauzolës juridiksionale. Rregullorja “Bruksel 1bis” modifikon regjimin ligjor të litispendencës mes gjykatave të shteteve anëtare. Neni 33 i rregullores 1215/2012 përfshin litispendencën mes gjykatave të shteteve anëtare ashtu edhe gjykatave të shteteve të treta, të cilat kanë dëgjuar çështjen më parë. Gjkata e zgjedhur nga palët do të ketë prevalencë mbi prioritetin të bazuar në kohë, pavarësisht vendbanimit të palëve. Për më tepër, Rregullorja nr.1215/2012 e Brukselit prezantoi tre ndryshime themelore për rregullat që lidhen me klauzolën juridiksionale. Së pari, për të qënë efektive, një klauzolë juridiksionale nuk duhet të jetë nul apo të ketë asnjë lloj pavlefshmërie, qoftë absolute ose relative, sipas ligjit të atij shteti gjyktës të së cilës i jep juridiksion. Pra, duhet të ketë një marrëveshje të vlefshme mes palëve që të tranferojë juridiksionin, Së dyti, klauzola e juridiksionit do të jetë e vlefshme pavarësisht vendbanimit të palëve.

Heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shtetet anëtare, procedura “*exequatur*”, solli lehtësimin e qarkullimit të vendimeve mes shteteve anëtare duke ulur

kostot dhe shkurtuar kohën që kërkonte një vendim për të hyrë në fuqi. Zgjerimi i rregullave të juridiksionit edhe për personat që nuk banojnë në vendet anëtare të Bashkimit European, parashikimi i rregullave të detajuara kur ndodhemi para rasteve të përjashtimit të arbitrazhit. Pavarësisht përjashtimit që i bën rregullorja juridiksionit të arbitrazhit, duke u fokusuar vetëm në juridiksionin gjyqësor, në raste specifike gjykatat kanë bërë interpretim të zgjeruar duke shërbyer si bazë për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatës së arbitrazhit. Rregullorja në shumë raste rregullon jo vetëm juridiksionin gjyqësor, por edhe juridiksionin e arbitrazhit. Në raste konflikti procedural mes dy akteve ligjore, që ndikojnë në përzgjedhjen e gjykatës që ka juridiksion, prevalon Konventa e Nju Jorkut.

Lidhur me këtë studim konkludoj se: Legjislacioni shqiptar është i paplotë dhe i pa harmonizuar me normat më të reja të Bashkimit European në lidhje me juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, të cilat marrin rëndësi të dorës së parë duke patur parasysh prespektivën e Shqipërisë për integrim në Bashkimin European. Republika e Shqipërisë nëpërmjet Ligjit Nr.9590, datë 27.07.2006, ka ratifikuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European. Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit European buron nga nenet 6 dhe 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Të gjitha fazat e procesit legjislativ, duke nisur me formulimin e politikave dhe përcaktimin e instrumentit rregullues (*ligj*) deri tek hartimi i tekstit të aktit dhe miratimit të tij në Kuvend janë pjesë e procesit të adresimit të kërkesave të *Acquis Communautaire* (EU) në legjislacionin shqiptar.

Legjislacioni shqiptar në ndryshim nga Rregullorja 1bis e Brukselit nuk e njeh marrëveshjen e palëve për zgjedhjen e juridiksionit për mosmarrëveshjet që kanë lindur apo do të lindin, si dhe nuk pezullon gjykimin kur e njëjta çështje është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj.

## 5.2 REKOMANDIME

Për sa më sipër, rekomandoj që Kodi i Procedurës Civile dhe ligji nr.10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” të njohë Marrëveshjet e Juridiksionit për zgjedhjen e gjykatës dhe derogimin e juridiksionit, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me juridiksion ekskluziv të gjykatës shqiptare.

1. Në mënyrë që të harmonizohet me legjislacionin europian, veçanërisht me Rregulloren nr.1215/2012 të Brukselit, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë duhet të ndryshohet për çështje të tilla si juridiksioni ekskluziv, derogimi i juridiksionit dhe pezullimit të gjykimit, me qëllim lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore civile, aksesit në drejtësi, rritjen e investimeve të huaja, e për t’iu përshtatur më mirë me kushtet aktuale të tregut e qarkullimin civil.
2. Në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë duhet të hiqet procedura e ekzekutimit për vendimet e gjykatave të shteteve anëtare të B.E dhe të ndiqet e njëjta praktikë ligjore që parashikohet në rregulloren 1215/2012, e cila ka shkrirë procedurën “*exequator*”.
3. Rekomandoj që si bazë ligjore të përdoret neni 393 i K.Pr.C –së ku parashikohet mundësia që me marrëveshje ndërkombëtare mes Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të huaja mund të përcaktohen kushte të tjera për njohjen dhe

ekzekutimin e vendimeve të gjykatave. Po në këtë dispozitë parashikohet epërisa që ka një marrëveshje ndërkombëtare me objekt njohjen e një vendimi gjyqësor, kundrejt të drejtës tonë të brendshme. Kjo epërsi parashikohet shprehimisht si parim i rëndësishëm edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenin 122, pika 2 ku parashikohet se: *“Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”* Po ashtu me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare, mund të përcaktohen edhe kushte të tjera, në të cilat një vendim gjyqësor i huaj prodhon efekte për shtetet e tjera. Gjithashtu, me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare mund të parashikohen dhe efekte të tjera që mund të prodhojë njohja.

4. Konkretisht, neni 396 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Kërkesës për t’i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t’i bashkëngjiten:
  - a) Kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;
  - b) Vërtetim nga gjykata që e ka nxjerr vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë;
  - c) Prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri.

Siç konstatohet nga ky nen, kërkohen një sërë dokumentash të legalizuara dhe të përkthyer. Vlen për t’u theksuar se kjo procedurë është e ngjashme me procedurën që është ndjekur në Europën deri në vitin 2015. Me miratimin e rregullores 1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”

është hequr procedura exequator në gjykatat e shteteve anëtare. Aktualisht, është e mundur që një vendim i dhënë në një shtet anëtar, i cili është në fuqi dhe i ekzekutueshëm në atë shtet anëtar, të jetë i ekzekutueshëm në të gjitha shtetet anëtare, pa qënë nevoja për nxjerrjen e një deklarate ekzekutueshmërie. Neni 39 i Rregullores 1215/2012 parashikon: *“një vendim i dhënë në një gjykatë të një shteti anëtar, i cili është i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm dhe në shtetet e tjera anëtare pa qënë nevoja e nxjerrjes së ndonjë deklarate ekzekutueshmërie”*.

Për sa më sipër rekomandoj, të shfuqizohet pika b dhe pika c, e nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile dhe të zëvendësohet me: *“një vendim i dhënë nga një gjykatë e një shteti anëtar të Bashkimit Europian, i cili është i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm dhe në Republikën e Shqipërisë pa qënë nevoja e nxjerrjes së ndonjë deklarate ekzekutueshmërie”*

5. Konkretisht, heqja e procedurës së ekzekutimit do të çonte në lehtësimin e burokracisë, në shmangien e kostove të larta, në lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore civile, si dhe në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian.
6. Ndryshimet dhe përmirësimet e parashikimeve më të fundit europiane në lidhje me juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, duhet të pasqyrohen edhe në legjislacionin shqiptar për tu përshtatur më mirë me atë europian, duke marrë parasysh kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik, të nevojës për sigurinë e tregtisë dhe rritjen e investimeve të huaja, e bëjnë të domosdoshme konsolidimin e organeve vendimarrëse, konsolidimin e një kuadri ligjor bashkëkohorë, drejt krijimit dhe organizmit të një juridiksioni

gjyqësor më fleksibël drejt të drejtës europiane, për një respektim dhe liri vullneti nga ana e subjekteve si palë në një marrëdhënie juridike private.

## BIBLIOGRAFIA

### BURIME PARËSORE

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
3. Konventa Europiane të Arbitrazhit (Gjenevë 21 Prill 1961)
4. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr.121/2013
5. Ligji nr.8116, datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.
6. Ligjit Nr. 10182, datë 29.10.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Konferencës së Hagës “Për procedurën civile”.
7. Ligjit Nr.9590, datë 27.07.2006, për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare.
8. Ligji nr.10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”.
9. Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.
10. Ligji nr.9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt”.
11. Ligji nr.3920, datë 21.11.1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjës se huaj”.
12. Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”,
13. Ligji nr.152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014.



14. Konventa e Brukselit për juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare 1968.
15. Konventa për juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare 41988A0592, 88/592/EEC, lidhur në Lugano, më 16 shtator 1988, fletore zyrtare L, 25/11/1988 P. 0009 – 0048
16. Rregullorja e Këshillit European nr. 44/2001, e 22 Dhjetorit 2000, “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.
17. Rregullorja e Këshillit European nr 1215/2012 e 12 Dhjetorit 2012, mbi “Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”,
18. Rregullorja e Këshillit European (EC) nr. 1206/2001 e 28 Maj 2001 “Për bashkëpunimin mes gjykatave të shtetëve anëtare për marrjen e provës në çështjet tregtare dhe civile”
19. Rregullorja e Këshillit European (EC) nr. 4/2009 e 18 Dhjetorit 2008 Mbi Juridiksionin, ligjin e aplikueshëm, njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet e detyrimeve”
20. Konventa e Nju Jorkut, Konveta për njohjen dhe zbatimin e arbitrazhit të huaj, 1958,
21. Rregullore (EC) nr.593/2008 e Parlamentit European dhe e Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore";
22. Rregullore (EC) nr.864/2007 e Parlamentit European dhe e Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jashtëkontraktore".
23. Rregullorja (EC) no.805/2004 e 21 Prillit 2004 për krijimin e një urdhëri european për pretendimet e pakontestueshme.

### **Burime dytësore:**

1. Anastasi A., E drejta Kushtetuese,Tiranë 2004
2. Brati A.,Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë,Tiranë 2008.
3. Canaj E, Bana S, “E drejta e Bashkimit Evropian”, Onufri,Tiranë, 2014.
4. Chiovenda G,Principi di Diritto processuale Civile. jovene editore.
5. Como. Jani, E drejta administrative, botim i vitit 1983
6. Craig P. & De Burga G, E Drejta e Bashkimit European,Oxford.
7. Dickinson A. & Lein E., The Brussels 1 Regulation Recast,Oxford 2016.
8. Dickinson M., e drejta ndërkombëtare, 2011
9. Dr. Kola Tafaj F, LL.M Vokshi,A. Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë,Tiranë 2013.
10. Dr. Kola Tafaj F, LL.M Vokshi,A. Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë 2,Tiranë 2014.
11. Galgano. F., Diritto private,Cedam,1990
12. Guilherme.S, Arbitration and International Trade Field, 2006.
13. Hare, Christopher, Restraint of foreign proceeding Turner v.Grovit(2004),Cambridge laë Journal
14. Hofmann M., “The Right to Establishment for Nationals of the European Union Associated Countries in the Recent Jurisprudence of the European Court of Justice – E Drejta për Themelim e Vendeve për Asocim në Bashkimin Evropian nën Jurisprudencën e Fundit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë” 2001, “German Yearbook of International Law - Libri vjetor gjerman mbi të Drejtën Ndërkombëtare”.

15. Kalia A., e drejta ndërkombëtare private, 2010.
16. Koji Takahashi, Damages for breach of a choice-of-court agreement, Yearbook of Private international law, vol 10.(2008),65.
17. Lamani A., Docent i Shkencave Juridike, Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1962.
18. Lengeling. D, Common law and civil law, differences, reciprocal influences and point of intersection, Toronto 2008, faqe 6.
19. Lukasz Dyrda, Jurisdiction in civil and commercial matters under the regulation 1215/2012, between common ground of jurisdiction and divergent national rules.
20. Malcolm .N.Shaw, *International Law, Cambridge 2008*.
21. Mandrioli C, Corso di Diritto Processuale Civile (I)
22. Mandro A, Walker G, Kalia A, "Private International Law". Tirana 2005.
23. Marta Requejo Isidro, Recognition and Enforcement in the new Brussels I Regulation no. 1215/2012, Brussels I recast, Barcelona, 2014.
24. Mazzarella.G., Gli elementi irriducibili dei sistemi giuridici, Vol2, Giannnetta, Itali, 1920
25. Merryman J. H., The civil law tradition, an introduction to the legal systems of western europe, Stanford University Press California, 1985.
26. Omari L. Parime dhe institucione të së drejtës publike, Elena Gjika, Tiranë 2002.
27. Omari L. Shteti i së drejtës, Tiranë, 2004.
28. Omari L.& Anastasi A. E drejta kushtetuese, ABC Tiranë 2010
29. Omari L., Parime dhe institucione të së drejtës publike, Tiranë 2007

30. Prof.Dr. Breskoveci F., E drejta Proceduarale Civile, Prishtine 2004.
31. Propozim për rregullore të Parlamentit European dhe të Këshillit për promovimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe bizneseve duke lehtësuar pranimin e disa dokumentave publike në Bashkimin European dhe amendimin e rregullores no.1024/2012 Brussels,24.4.2013,2013/0119(COD)
32. Puto A., E drejta ndërkombëtare publike, Tiranë 2010.
33. Qoku M., E drejta ndërkombëtare private. Tiranë 2016.
34. Raporti i Komisionit European i dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.
35. Raporti: Administrative Justice in Europe – Report for Germany, George Hebert, Judge at the Federal Administrative Court, Leipzig, Questionnaire, related the administration control list and typology in the 25 Member States of the European Union.
36. Redenti ,Intorno al concetto di giurisdizione,in studi per simoncelli,Napoli 1917  
Redenti, Diritto processuale civile,Milano 1980
37. Reka B., E drejta e Unionit European, Instituti i Kosovës për integritet euroatlantike, KIEAL, Prishtinë 2000.
38. Rene David,L arbitrage dans le comers international,Economica,1982.
39. Sadushi.S, Drejtësia Kushtetuese në Zhvillim, Tiranë 2012.
40. Salerno.F., Giurisdizione ed efficacia delle decisioni straniere nel regolamento (CE) n.44/2001, la revision della Convencione di Bruxelles del 1968,Cedam 2003.
41. Satta S, Diritto processuale civile, Padova 1992.

42. Singh. Mahendra, German Administrative law in common law perspective, Springer,2001
43. Tetley W, Mixed Jurisdiction, part I, Montreal,Canada,1999
44. Trisorio Liuzzi,Brevi notte in tema di sospensione per ricasazione e per regolamento di giurisdizione,1981.
45. Vasili J.,Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë,Tiranë 2005.

#### **Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë:**

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.14,dt.22.05.2006,
2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.11,dt.12.14.2008
3. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.11,dt.27.05.2004
4. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.10/2007.
5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të nr. 14/ 2009.
6. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.7/2008
7. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.22/2006
8. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.36/2010
9. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 23.04.2010
10. Vendimi i Gjykatës Kushtetutuese nr.25/2007
11. Vendimi nr.10/2007 i Gjykatës Kushtetuese
12. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.32.dt.24.11.2003.

#### **Vendime të Gjykatës së Lartë:**

1. Vendimi i Gjykatës së Lartë nr.16/2010
2. Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë,nr.1,dt.26.11.2010.

3. Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë,nr.686,dt.11.05.2000.
4. Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë,nr 2,date:06.01.2009.
5. Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë nr 3,date.24.01.2007.
6. Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë,nr.3.dt.12.02.2008
7. Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë,nr 1.date.26.10.2010.
8. Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë,nr8.date 14.02.2001
9. Vendimi nr.1071,datë 7.11.2000 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë
10. Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë. nr 22,dt 19.01.2011
11. Vendim nr.94,datë 23.3.2016

#### **Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut:**

1. Beaumartin kundër Republikës së Francës,Seria A,nr 296-B,dt 24.09.1994.
2. Monxkx kunder. Belgium, 13 June 1979, Series A no.31
3. Pla and Puncernau kunder.Andorra Puncernau v. Andorra No. 69498/01, ECHR 2004VIII
4. Camp and Bourimi kunder. Hollandës, no. 28369/95, ECHR 2000-X
5. Rasti 34/73, Variola kundër Ministrisë së Financave të Italisë
6. MvElhinney kundër Irlandës [GC], nr.31253/96, § 37, ECHR 2001-XI;
7. Manoilescu dhe Dobrescu, (dec.), nr.60861/00,§ 80, ECHR 2005-VI;
8. Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006;
9. Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë nr.35720/04 dhe 42832/06, § 44-47 ECHR 2009

#### **Vendime të Gjykatës Europiane të Drejtësisë:**

1. C 412/98 Vendim 412/98 Group Josi Reinsurance Company SA v Universal General Insurance Company (UGIC)
2. C-97/91 ECR 1992 The Borelli Case
3. Case C-281/02 ( Oëusu )
4. Case C-125/92 [1993] ECR I-4075, Muloxvs.Geels
5. Case C-116/02 ( Gasser )
6. Case C-159/02 ( Turner )
7. Rasti C-185/07 ( West Tankers )
8. Wolf v. Cox,42\76 ECR 01759
9. C-125/79 ( Denilauler)
10. C -104/03 (St. Paul Dairy)
11. C-391/95 ( Van Uden )
12. C-99/96 ( Mietz ),
13. Case Hoffmann v. Krieg
14. C 412/98 Vendim 412/98 Josi v, UGIC
15. C-281/02 ( Oëusu )
16. C39/72,rec 101 Commission C Italie
17. Kehaya and others v. Bulgaria,12.01.2016
18. Union Discount v. Zoller, Queen bench division Court,2001

**Burime internet:**

1. [www.hcch.net/](http://www.hcch.net/)

hudoc.echr.coe.int

2. <https://www.unidroit.org/english/principles/contracts/principles2004/blackletter.pdf>.  
wold English Dictionary.com
3. [http://eur-lex.europa.eu/legal\\_content](http://eur-lex.europa.eu/legal_content)

Opinion 1/03 of the European Court of Justice.

[http://eur-lex.europa.eu/legal\\_content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001R0](http://eur-lex.europa.eu/legal_content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001R0)

4. Raportit i Komisionit Europian mbi zbatimin e rregullores, parë në [http://eur-lex.europa.eu/legal\\_content](http://eur-lex.europa.eu/legal_content)
5. <http://www.otto-schmidt.de/brussels-regulation-commentary.html>
6. <http://www.otto-schmidt.de/brussels-ibis-regulation-commentary.html>
7. [https:// Europe.eu/rapid-release\\_IP15-3080-en.htm](https://Europe.eu/rapid-release_IP15-3080-en.htm)
8. [www.oecd.org](http://www.oecd.org)
9. [http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-\(RECAST\)-ARE-YOU-READY.aspx](http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-(RECAST)-ARE-YOU-READY.aspx)
10. [http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-\(RECAST\)-ARE-YOU-READY.aspx](http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-(RECAST)-ARE-YOU-READY.aspx)
11. <http://www.lexology.com/library/detail,Gómez-Acebo & Pombo Abogados - Miguel Troncoso Ferrer>
12. [http://www.elderecho.com/actualidad/anteproyecto\\_de\\_Ley\\_de\\_Cooperacion\\_Juridica\\_Internacional\\_en\\_materia\\_civil\\_0\\_697125092.html](http://www.elderecho.com/actualidad/anteproyecto_de_Ley_de_Cooperacion_Juridica_Internacional_en_materia_civil_0_697125092.html)



13. [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-3080\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-3080_en.htm).
14. [www.jonesday.com/commentary](http://www.jonesday.com/commentary)
15. [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-3080\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-3080_en.htm).
16. [www.blplaw.com/arbitration](http://www.blplaw.com/arbitration) exception
17. [http://www.elderecho.com/actualidad/anteproyecto de Ley de Cooperacion Juridica Internacional en materia civil 0 697125092.html](http://www.elderecho.com/actualidad/anteproyecto_de_Ley_de_Cooperacion_Juridica_Internacional_en_materia_civil_0_697125092.html)
18. [www.Deguestia.com](http://www.deguestia.com)
19. <http://www.peeters-law.be/documents/analyse-items/80-brussel-i-bis-verordening.xml>